



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 72

Tiranë – E enjte, 24 prill 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 231, datë 17.4.2025	Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2025..... 7975
Udhëzim i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 1, datë 17.4.2025	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 4, datë 31.12.2020, “Mbi kriteret dhe procedurën për certifikimin e operatorëve të turizmit detar”, i ndryshuar..... 8032
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 69, datë 10.4.2025	Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm për fitimin, heqjen dorë dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare, formën dhe mënyrën e plotësimit të kërkesës, të procedurës për kryerjen e verifikimeve pranë institucioneve përgjegjëse, si dhe të dokumentacionit për shtyrjen e afatit për kryerjen e betimit..... 8032
Urdhër i përbashkët i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 248, datë 24.2.2025	Për ngritjen dhe përbërjen e Komitetit Sektorial të Energjisë..... 8041
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 13, datë 25.3.2025	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-5683, datë 5.12.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konstatimin e shkeljes/cenimit të së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të shqyrtimit të çështjes me përparësi. Konstatimin e shkeljes të së drejtës së aksesit dhe sigurisë juridike në një gjykatë të caktuar me ligj. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit për shqyrtimin e çështjes me përparësi..... 8042
Udhëzim i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës nr. 553, datë 14.4.2025	Për miratimin e rregullave të monitorimit dhe mbikëqyrjes së sjelljes së punonjësve të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës gjatë periudhës zgjedhore në zgjedhjet e përgjithshme për vitin 2025..... 8050

Vendim i Gjykatës së Shkallës së Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë nr. 82, datë 12.2.2025	Për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ksandros Imeraj.....	8051
---	--	------



VENDIM
Nr. 231, datë 17.4.2025

PËR MIRATIMIN E REKOMANDIMEVE
PRIORITARE NË LUFTËN KUNDËR
KRIMINALITETIT, PËR VITIN 2025

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 103, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 32, të nenit 6, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2025, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet ministri i Drejtësisë t'i bëjë të njohura rekomandimet, në përputhje me parashikimet e pikës 3, të nenit 103, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Ngarkohet ministri i Drejtësisë të hartojë metodologjinë për mënyrën e vlerësimit të këtyre rekomandimeve dhe të ndjekë në vazhdimësi mënyrën e zbatimit të tyre, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

MINISTRIA E DREJTËSISË
REKOMANDIME PRIORITARE
NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT,
PËR VITIN 2025

Tiranë, mars 2025

1. HYRJA

Mbështetur në nenin 103, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, janë ka

përgatitur rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave për Prokurorin e Përgjithshëm në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2025.

Pavarësia e sistemit të drejtësisë ka qenë një nga problematikat kryesore të sistemit dhe një prej objektivave kryesorë të reformës në drejtësi. Gjatë viteve të fundit, kjo reformë ka sjellë një sërë ndryshimesh të rëndësishme, duke përfshirë: riorganizimin e sistemit gjyqësor (përfshirë edhe prokurorinë), forcimin e institucioneve të pavarura të reja, përmirësimin e standardeve për emërimin dhe promovimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe rritjen e transparencës në administrimin e drejtësisë.

Roli i prokurorisë në procesin e rregullt ligjor është thelbësor për sigurimin e drejtësisë dhe për mbrojtjen e interesit publik. Forcimi i këtij sistemi është një hap i domosdoshëm për të garantuar që proceset gjyqësore të jenë të drejta, transparente dhe të bazuara në ligj. Prokuroria ka përgjegjësinë të hetojë dhe ndjekë penalisht krimet, duke siguruar që ata që shkelin ligjin të përballen me pasojat e veprimeve të tyre.

Nëpërmjet forcimit të sistemit të prokurorisë, rritet kapaciteti për të hetuar dhe për të ndjekur penalisht çështje komplekse e të ndjeshme të kriminalitetit, duke kontribuar kështu në një shoqëri më të drejtë dhe të barabartë. Për më tepër, prokuroria luan një rol kyç në sigurimin e mbrojtjes së të drejtave të viktimave dhe të të akuzuarve, duke siguruar që proceset të zhvillohen në mënyrë të balancuar dhe të drejtë. Kjo është e domosdoshme për ruajtjen e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë dhe për forcimin e sundimit të ligjit.

Në mbështetje të kuadrit ligjor në fuqi, si dhe në vijim të praktikës ligjore, administrative dhe institucionale, të konsoliduar tashmë prej rreth 20 vjetësh, Ministria e Drejtësisë ka mbështetur veprimtarinë dhe organizimin e organit të prokurorisë.

Për këtë vit, rekomandimet fokusohen në 8 fusha kryesore, si më poshtë vijon:

1. Sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut në qendër të punës së prokurorisë;
2. Forcimi i luftës kundër kriminalitetit;
3. Integriteti, përgjegjshmëria dhe transparenca e veprimtarisë së prokurorëve dhe zyrtarëve të prokurorisë;
4. Sigurimi i eficiencës dhe ngritja e kapaciteteve institucionale;



5. Përdorimi i metodave bashkëkohore të hetimit;

6. Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë;

7. Bashkëpunimi ndërinstitucional;

8. Bashkëpunimi ndërkombëtar.

Në këtë kuadër, rekomandimet për vitin 2025, në luftën kundër kriminalitetit janë të mbështetura në një gamë dokumentesh strategjike, si dhe në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë funksionimin e secilës hallkë të sistemit të drejtësisë. Këto dokumente synojnë koordinimin dhe bashkërendimin e masave për të arritur rezultate konkrete që të ndihen si përmirësime të prekshme për sistemin, por edhe për qytetarët.

Po kështu, Ministria e Drejtësisë ka vazhduar të ndjekë zbatimin e rekomandimeve të vitit 2024, duke i analizuar dhe vlerësuar ato, ndërkohë që problematikën e dala nga ky proces kanë shërbyer si bazë për hartimin e rekomandimeve konkrete, për vitin 2025.

2. METODOLOGJIA PËR HARTIMIN E REKOMANDIMEVE

Për të siguruar një qasje të strukturuar, të arsyetuar dhe të zbatueshme në hartimin e rekomandimeve prioritare për sistemin e drejtësisë penale, metodologjia e përdorur për përgatitjen e rekomandimeve prioritare 2025, u mbështet në disa shtylla themelore: analizën e kontekstit ligjor dhe institucional, përdorimin e burimeve të shumfishta të të dhënave, përfshirjen e aktorëve institucionalë, si dhe mbështetjen në standarde ndërkombëtare.

1. Analiza juridike dhe institucionale

Procesi metodologjik nisi me një analizë të thelluar të kuadrit ligjor në fuqi, përfshirë Kushtetutën, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, ligjet për funksionimin e prokurorisë dhe institucionet e posaçme antikorupsion dhe kundër krimit të organizuar, si dhe ligjin për funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë. Analiza pasqyron, gjithashtu, praktikën e zbatimit të ligjit dhe identifikon problematikën në zbatimin e normës ligjore.

2. Mbështetja në burime të ndryshme informacioni dhe evidencë të matshme

Hartimi i rekomandimeve bazohet në të dhëna statistikore të dërguara nga Prokuroria e Përgjithshme dhe SPAK-u, sipas aneksit 1, të këtij dokumenti “Analizë krahasuese 2023–2024”, aneksit 2 “Ashpërsimi i dënimit”, aneksit 3, “Analiza mbi të cilën janë bazuar rekomandimet 2025”.

Gjithashtu, për hartimin e rekomandimeve janë marrë në konsideratë raportet ndërkombëtare dhe legjislacioni i vendeve të huaja. Kjo përfshin tregues, si: numri i procedimeve të reja, hetimet e përfunduara, masat e sigurimit të aplikuara, sekuestrimet e realizuara dhe numrin e dërgimeve për gjykim. Gjithashtu, gjatë hartimit të këtij dokumenti janë mbajtur në konsideratë dhe janë përdorur raportet e BE-së, SHBA-së, GRECO-s, MONEYVAL-it, aktorëve të shoqërisë civile, si dhe analiza e bërë nga një ekspert i fushës penale me eksperiencë shumëvjeçare në këtë drejtim.

3. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe shkëmbimi i informacionit

Një komponent thelbësor është përfshirja e aktorëve institucionalë në procesin e hartimit përmes shkëmbimit të informacionit, si: Prokurorisë së Përgjithshme, SPAK-ut, Ministrisë së Drejtësisë, ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera, të cilat kanë dërguar të dhëna e rekomandime për analizën e situatës aktuale, në të cilat janë mbështetur dhe hartuar këto rekomandime.

4. Qasje me fokus në të drejtat e njeriut dhe efikasitetin institucional

Rekomandimet prioritare janë konceptuar në funksion të një qasjeje gjithëpërfshirëse që vendos në qendër respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës si parim udhëheqës në punën e organeve të ndjekjes penale. Çdo rekomandim synon të fuqizojë sundimin e ligjit nëpërmjet: forcimit të luftës kundër kriminalitetit; rritjes së integritetit, përgjegjshmërisë dhe transparencës në veprimtarinë e prokurorëve dhe strukturave përkatëse; sigurimit të efikasitetit dhe ngritjes së kapaciteteve institucionale; si dhe përdorimit të metodave bashkëkohore të hetimit penal.

Këto rekomandime theksojnë rëndësinë e zhvillimit të hetimeve dhe procedurave të tjera, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe mbrojtjes efektive të të drejtave themelore. Ato përforcojnë nevojën për bashkëpunim të qëndrueshëm me Ministrinë e Drejtësisë, me aktorët institucionalë brenda vendit dhe partnerët ndërkombëtarë, si elemente kyçe për garantimin e një sistemi të drejtësisë funksional, transparent dhe të drejtë.

5. Struktura e formulimit të rekomandimeve

Rekomandimet janë të hartuara duke u bazuar në 8 fusha kryesore rekomandimesh, të cilat



zbërthehen në nënkomponentë për të siguruar që ato të jenë të zbatueshme, të monitorueshme dhe të vlerësueshme.

3. DOKUMENTET DHE LEGJISLACIONI I PËRDORUR PËR HARTIMIN E REKOMANDIMEVE

3.1 Raportet

Komisioni i BE-së, raporti i Shqipërisë 2024, Bruksel, 30.10.2024, SWD(2024) 690 përfundimtar;

Komisioni i BE-së, 2024 raporti i sundimit të ligjit: kapitulli i shtetit mbi situatën e shtetit të së drejtës në Shqipëri, Bruksel, 24.7.2024, SWD(2024) 828 përfundimtar;

Programi i qeverisë 2021–2025;

Raporti i shqyrtimit të Shqipërisë 2023, *Cluster 1*, Bazat;

Komisioni Evropian, raport i Shqipërisë për 2023-shin, Bruksel, 8.11.2023 SWD (2023) 690 përfundimtar;

Zbatimi i Konventës kundër Ryshfetit të OECD, faza 4 e ndjekjes së raportit 2-vjeçar: Itali 2024;

Raportet e shteteve për mbi praktikën e të drejtave të njeriut, 2023: Shqipëri, Departamenti i Shtetit i SHBA-së;

Vlerësim i performancës: Matja e efektshmërisë, monitorimi i progresit, shtimi i llogaridhënies së Prokurorisë së Posaçme (SPAK) dhe Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (2020–2023), Raporti i katërt i vlerësimit, Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG);

Projekti Drejtësia Botërore 2023;

Projekti Drejtësia Botërore 2022;

Gjetjet e ekspertit nëpërmjet raportit për hartimin e rekomandimeve prioritare, për vitin 2025–2026, mbi luftën kundër krimit dhe metodologjia për vlerësimin, dhe monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të rekomandimeve prioritare, bazuar mbi kritere të përcaktuara qartë dhe të matshme.

3.2 Rekomandimet dhe Politikat

Rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave 2024;

Rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave 2023;

Urdhri nr. 818, datë 3.9.2024, për miratimin e dokumentit “Plani strategjik 2024–2027 për Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”.

3.3 Legjislacioni i Shqipërisë

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, i ndryshuar;

Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë;

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për luftën ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar”, i ndryshuar;

Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, i ndryshuar;

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024–2030 dhe plani i saj i veprimit;

Plani i veprimit 2024–2026, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024–2030;

Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025;

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur dhe plani i veprimit 2022–2026.

3.4 Rezoluta

Vendim i Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme gjatë vitit 2023, datë 25.7.2024.

Vendim i Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme gjatë vitit 2022, datë 6.7.2023.

Rezolutë e Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për vitin 2023, datë 25.7.2024.

Vendim i Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2022, datë 6.7.2023.

3.5 Legjislacioni dhe politikat e huaja

Ligji i Mbretërisë së Bashkuar për të ardhurat nga krimi 2002;

Akti i ryshfetit të MB-së 2010;

Akti i Drejtësisë Penale 1987;

Ligji për praktikën e huaja korruptive të SHBA-së;



Zyra e Brendshme e Mbretërisë së Bashkuar dhe Ministria e Drejtësisë, shkëmbimi i të dhënave për udhëzimet e sistemit të Drejtësisë Penale, tetor 2023;

Shërbimi i Prokurorisë së Kurorës, Zyra e Pavarur e Udhëzuesit të Prokurorisë për Sjelljen e Policisë;

Mbrojtja për sinjalizuesit: Kuadri ligjor dhe i politikave për mbrojtjen e personave që raportojnë shkelje të ligjit të Unionit.

3.6 Traktate dhe udhëzime ndërkombëtare

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut 1950;

Konventa Evropiane për ndihmën e ndërsjellë në çështjet penale 1959;

Rregullorja e punës së Komisionit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara – shtojca;

Udhëzime për kornizat e pavarura të monitorimit dhe pjesëmarrjen e tyre në punën e Komisioni për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, 10 tetor 2016, CRPD/C/1/Rev. 1;

Treguesit e të drejtave të njeriut: Një udhëzues për matjen dhe zbatimin, Nju Jork dhe Gjenevë, 2012;

Rekomandim për punën sistematike për zbatimin e të drejtave të njeriut në nivel kombëtar, Strasburg, 18 shkurt 2009, Comm DH (2009).

REKOMANDIMET PRIORITARE PËR 2025-n

4. FUSHAT KRYESORE TË REKOMANDIMEVE

4.1 Sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut në qendër të punës së prokurorisë

4.1.1 Presumimi i pafajësisë, i garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe nga legjislacioni procedural penal në fuqi, përbën një nga shtyllat themelore të procesit të rregullt ligjor dhe sundimit të ligjit. Në këtë kuadër, prokuroria ka detyrimin që, në çdo fazë të procedimit penal, të respektojë dhe të garantojë këtë të drejtë themelore. Respektimi i presumimit të pafajësisë kërkon jo vetëm shmangien e deklarimeve publike që cenojnë integritetin e të dyshuarit/akuzuarit, por edhe ushtrimin me përmbajtje të kërkesës për masa sigurie personale. Në këtë drejtim, përdorimi i masave ekstreme të sigurimit, si arresti në burg ose në shtëpi, duhet të mbetet masë e jashtëzakonshme dhe e fundit, e rezervuar vetëm për rrethana që justifikohen nga rrezikshmëria reale e të hetuarit dhe

nga pamundësia për të garantuar në mënyrë tjetër vijimin e procesit penal. Prokuroria, në përmbushje të këtij detyrimi, rekomandohet të sigurojë që çdo kërkesë për vendosjen e një mase sigurie të jetë e bazuar në mënyrë të qartë, të argumentuar dhe proporcionale, në përputhje me rrethanat konkrete të çështjes. Fokusi nuk qëndron vetëm në ekzistencën formale të garancive ligjore, por në masën se si ato zbatohen në praktikë dhe nëse prokuroria reagon ndaj çdo devijimi apo shkeljeje të tyre.

4.1.2 Njëkohësisht, është e domosdoshme që prokuroria të shmangë çdo vonesë të pajustificuar në fazën e hetimeve, pasi këto vonesa ndikojnë drejtpërdrejt në zgjatjen e periudhave të pasigurisë për të pandehurin, në veçanti, kur ndaj tij është vendosur një masë kufizuese e lirisë. Zgjatja pa arsye objektive e hetimeve, cenon jo vetëm të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, por në thelb minon vetë parimin e prezumimit të pafajësisë. Në këtë drejtim, rekomandohet forcimi i mekanizmave të brendshëm të kontrollit dhe monitorimit të ecurisë së çështjeve penale në hetim, si dhe përcaktimi i standardeve të qarta për arsyetimin e afateve hetimore dhe për reagimin në rast të zvarritjes së tyre.

4.1.3 Po aq i rëndësishëm është edhe garantimi i plotë i të drejtës për përfaqësim dhe mbrojtje të drejtë ligjore gjatë të gjithë procedurës penale. Prokuroria ka detyrimin të sigurojë që i pandehuri të njoftohet menjëherë për të drejtën për të pasur një avokat dhe që kjo e drejtë të ushtrohet në mënyrë efektive dhe pa pengesa. Për këtë arsye rekomandohet respektimi i së drejtës për konsultim konfidencial me mbrojtësin, praninë e tij gjatë veprimeve procedurale, si dhe vendosjen në dispozicion menjëherë të kartës së të drejtave të tij.

4.1.4 Rekomandohet që prokuroria të rrisë përdorimin e masave alternative të parashikuara nga legjislacioni penal, duke pasur në fokus edhe të miturit, në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe me qëllimin e rehabilitimit dhe parandalimit të recidivizmit. Masat alternative, sipas legjislacionit penal, duhet të konsiderohen si instrumente të vlefshme që ruajnë balancën ndërmjet interesit të drejtësisë dhe mbrojtjes së të drejtave të individit. Zbatimi më i gjerë dhe më i standardizuar i këtyre masave ndihmon jo vetëm në shmangien e mbipopullimit të sistemit penal dhe paraburgimeve të panevojshme, por edhe në promovimin e një



drejtësie më sociale dhe më efektive. Rekomandohet që prokuroria të zhvillojë udhëzime të brendshme dhe trajnime të posaçme për zbatimin e këtyre formave alternative, si dhe të monitorojë praktikën për të siguruar konsistencë dhe qasje të barabartë në të gjithë sistemin.

4.1.5 Rekomandohet rritja e zbatimit të parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale për bashkëpunëtorët e drejtësisë, gjykimin e drejtpërdrejtë, gjykimet e posaçme, urdhrin penal, marrëveshjet e pranimit të dënimit, si mjete për të rritur efektivitetin e procesit penal dhe për të ulur ngarkesën e sistemit gjyqësor (*backlog-un*), në funksion të përfundimit të çështjeve brenda afateve të arsyeshme.

4.1.6 Rekomandohet që prokuroria të ndërmarë masa të fuqishme për të garantuar respektimin e të drejtave procedurale të personave në hetim dhe të të pandehurve, përfshirë shmangien e ndalimeve arbitrare dhe të pajustificuara, si dhe kontrollet dhe sekuestrimet që nuk janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Prokuroria duhet të sigurohet që çdo masë kufizuese e lirisë, përfshirë ndalimin dhe arrestimin, të bazohet në prova të mjaftueshme dhe të jetë masë e drejtpërdrejtë dhe e nevojshme për zhvillimin e hetimeve. Ndërsa sekuestrimet dhe kontrollet duhet të kryhen vetëm kur janë të justifikuara, proporcionale dhe në respektim të procedurave ligjore dhe standardeve të të drejtave të njeriut. Rekomandohet që prokuroria të ngrejë kapacitetet për të siguruar që të gjitha veprimet procedurale të jenë të dokumentuara dhe të mbikëqyrura, duke garantuar transparencën dhe llogaridhënien e proceseve. Përdorimi i masave të tilla duhet të jetë gjithmonë i kontrolluar nga organet gjyqësore dhe të mbështetet në një arsyetim të plotë dhe të argumentuar përpara se të ndërmerren. Po ashtu, rekomandohet të forcohen mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe jashtëm, për të parandaluar çdo abuzim dhe për të siguruar që çdo masë kufizuese e lirisë të respektojë të drejtat e individëve dhe të përmbushë kriteret e ligjshmërisë.

4.1.7 Rekomandohet përditësimi i materialeve informuese për publikun dhe palët e përfshira mbi procedurën penale, me qëllim rritjen e transparencës, kuptueshmërisë dhe aksesit efektiv në drejtësi.

Materialet informuese duhet të jenë të qarta, të përditësuara dhe të përshtatura për kategoritë e ndryshme të qytetarëve, përfshirë personat në hetim,

të pandehurit, viktimat e veprave penale dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë. Përmirësimi i aksesit në informacion ndihmon në garantimin e të drejtave procedurale, zvogëlon pasigurinë juridike dhe rrit besimin e publikut në sistemin e drejtësisë penale. Rekomandohet, gjithashtu, që materialet të jenë të disponueshme në formate të ndryshme, përfshirë digjitalisht dhe në gjuhë të thjeshtuar, kur është e nevojshme.

4.2 Forcimi i luftës kundër kriminalitetit

4.2.1 Rekomandohet rritja e numrit të hetimeve të çështjeve të filluara kryesisht, rekomandim i përsëritur ndër vite (numri i të cilave vijon minimal), me qëllim rritjen e rolit aktiv të prokurorit, dhe jo thjesht të vihet në lëvizje nëpërmjet referimeve të kryera nga institucione të ndryshme.

4.2.2 Të përmirësohet cilësia e hetimeve kundër korrupsionit, veçanërisht nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, si dhe të mbahet në vëmendje rritja e numrit të çështjeve të dërguara për gjykim. Rekomandohet të forcohet hetimi, ndjekja penale dhe dërgimi për gjykim i rasteve të korrupsionit, veçanërisht në nivele të larta.

4.2.3 Të rritet numri i hetimeve financiare për veprat penale që krijojnë të ardhura ose pasuri, duke nisur hetimin financiar që në momentin e regjistrimit të procedimit penal dhe duke rritur kërkesat për masa të përkohshme ndaj pasurive, duke përfshirë ato që janë përdorur ose janë në pronësi të personave të tretë. Rekomandohet të rritet numri i rasteve të konfiskimit përfundimtar të aseteve kriminale, që rrjedhin nga veprat penale të lidhura me korrupsionin.

4.2.4 Të mbahen në konsideratë, në mënyrë të veçantë, krimet në fushën e sigurisë kibernetike. Rekomandohet ngritja e njërive të specializuara brenda prokurorisë për luftën kundër krimit kibernetik, duke përdorur teknologji të avancuara.

4.2.5 Rekomandohet forcimi i luftës kundër krimit të organizuar përmes bashkëpunimit të qëndrueshëm me shtetet anëtare të BE-së dhe shtete të tjera, si dhe ndëshkimi brenda vendit me masa të efektshme, me qëllim reduktimin e tij.

4.2.6 Të rriten rastet e procedimeve të regjistruara dhe të dërguara për gjykim në lidhje me veprat penale në fushën e narkotikëve, duke diferencuar veprat penale që lidhen me sasi minimale të narkotikëve dhe duke ndërmarë veprime të ashpra, brenda kompetencave të prokurorisë, për vendosjen e masave të sigurimit



personal dhe dënimin për rastet e kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike.

4.2.7 Të rriten rastet e hetimeve për veprat penale në fushën e trafikeve, përfshirë trafikimin e të miturve, si kategori vulnerabël. Gjithashtu, të vijohet nga SPAK-u rritja e numrit të hetimeve për çështjet e krimit të organizuar dhe ashpërsimit të politikës penale për këto vepra.

4.2.8 Të shtohet vigilenca dhe rastet e hetimit për format e reja të krimeve të kryera nga krimi i organizuar, si: krimi kibernetik i organizuar, hakerimi i sistemeve të institucioneve publike dhe bankave, vjedhja e të dhënave personale dhe financiare, mashtrimi *online*, përfshirë mashtrimin me kriptovaluta, skemat “*phishing*”, *ransomware* etj., trafikimi i qenieve njerëzore në forma të reja, pastrimi i parave përmes formave të reja, tregtia e paligjshme *online*, përdorimi i rrjeteve sociale për shitjen e armëve, drogës, dokumenteve të falsifikuara, apo akses në llogari bankare të vjedhura, krimi mjedisor i organizuar, manipulimi i tregjeve financiare etj.

4.2.9 Të mbahen në vëmendje hetimet për veprat penale të mundshme në fushën e terrorizmit, duke mbajtur në konsideratë situatën globale dhe duke bashkëpunuar me institucionet që veprojnë në këtë fushë.

4.2.10 Të rriten rastet e hetimeve financiare për veprat penale të pastrimit të parave dhe produkteve të veprës penal, numri i çështjeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim, si dhe numri i sekuestrimeve/konfiskimeve, rekomandim i përsëritur, që kërkon vëmendje të veçantë dhe njohjen e zhvillimin e kapaciteteve në lidhje me format e reja të këtyre veprave penale. Rekomandohet të përmirësohen teknikat e hetimit të prokurorisë, si hetimi i krimit financiar, si dhe të përmirësohen sistemet dhe metodologjitë e analizës penale për zgjidhjen e çështjeve komplekse penale. Të rritet përdorimi i masave të posaçme hetimore për të siguruar konsistencën ndërmjet sekuestrimit paraprak të aseteve dhe konfiskimeve përfundimtare.

4.2.11 Të shtohet vëmendja në lidhje me masat e sigurimit personal dhe masën e dënimit për veprat me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese, si dhe për rastet e keqtrajtimit/abuzimit/ shfrytëzimit e trafikimit të fëmijëve dhe grave.

4.2.12 Të shtohet vëmendja për dhunën ndaj grave në caktimin e masave të sigurimit personal dhe

dënimin e autorëve të veprës penale, veçanërisht atyre recidivistë, si dhe në rastet kur kjo vepër ka ndodhur në prezencë të të miturve.

4.2.13 Të shtohet vëmendja ndaj veprave penale që lidhen me zgjedhjet, me qëllim hetimin e shpejtë dhe efikas të këtyre veprave penale.

4.2.14 Rekomandohet intensifikimi i hetimeve penale për veprat që prekin drejtpërdrejt jetën dhe shëndetin e qytetarëve, me fokus të veçantë ndaj shkeljeve në fushën e sigurisë ushqimore, në përgjigje të rasteve të fundit të ekspozimit të konsumatorëve ndaj produkteve të pasigurta dhe jashtë standardeve. Zhvillimet e fundit në vend, përfshirë denoncimet publike për shkelje të sigurisë ushqimore apo krimeve mjedisore, kanë rritur ndjeshëm shqetësimin shoqëror, lidhur me mungesën e kontroleve efektive dhe ndëshkimin penal për shkelësit. Në këtë kontekst, prokuroria duhet të forcojë rolin e saj aktiv në hetimin dhe ndjekjen penale të këtyre veprave, duke bashkëpunuar ngushtësisht me institucionet kompetente. Për më tepër, ndjekja e rasteve të tilla duhet të trajtohet me përparësi, si për shkak të rrezikut të lartë për shëndetin publik, ashtu edhe për të forcuar parandalimin dhe duke rritur besimin e qytetarëve në integritetin e zinxhirit të furnizimit ushqimor.

4.3 Integriteti, përgjegjshmëria dhe transparencja e veprimtarisë së prokurorisë dhe zyrave të prokurorisë

4.3.1 Rekomandohet që prokuroria të zhvillojë metoda më të mira për verifikimin e integritetit dhe profesionalizmit të kandidatëve për t'u punësuar në prokurori, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Nevoja për zhvillimin e metodave të mira për kontrollin e vazhdueshëm të integritetit dhe profesionalizmit të kandidatëve dhe të punësuarve nuk duhet të mjaftohet vetëm me përfundimin e procesit të *vetting*-ut të bërë në kuadër të reformës së ndërmarrë në sistemin e drejtësisë.

4.3.2 Rekomandohet rishikimi i akteve të brendshme që rregullojnë punën e prokurorisë në mënyrë që të sigurojnë një sistem transparence dhe përgjegjshmërie. Kjo duhet shoqëruar me udhëzime dhe standarde të mira, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe kriteret më të mira ndërkombëtare, që zbatohen për organet e akuzës, të cilat duhet të jenë të disponueshme për publikun.

4.3.3 Të rishikohet mundësia për miratimin e modeleve standarde të dokumenteve të punës së



përditshme të prokurorëve dhe zyrave të prokurorisë, duke garantuar më së miri respektimin e detyrimeve në raport me zbatimin e të drejtave të njeriut dhe njohjen e tyre nga publiku.

4.3.4 Rekomandohet ndërmarrja e veprimeve konkrete për shqyrtimin e plotë të ankesave apo nisjen e hetimeve, kryesisht në ato raste kur vërehet se mund të ketë baza dhe indicie të mjaftueshme për nisjen e hetimit disiplinor ndaj prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, dhe referimin e rasteve pranë organeve kompetente. Marrja e masave të tilla duhet t'i shërbejë parandalimit të kryerjes së veprimeve, në kundërshtim me ligjin, dhe si rezultat, të kontribuojë në zëvendësimin e qasjes neglizhente, duke ulur tolerancën ndaj praktikave korruptive.

4.3.5 Llogaridhënia e brendshme krijon një proces pavarësie dhe perceptim publik të një sistemi ankimesh që është lehtësisht i aksesueshëm për publikun dhe shoqërinë civile. Procedurat për hetimin e shkeljeve dhe rezultatet e këtyre hetimeve duhet të përshtaten në mënyrë eficiente dhe të jenë transparente për publikun. Pavarësisht rezultateve të hetimeve për shkelje të ligjit, edhe dyshimi për kryerjen e saj mund të jetë i mjaftueshëm e të shërbejë si indicie për rishikimin e akteve dhe procedurave të brendshme.

4.3.6 Ndërkohë që legjislacioni konsiderohet i plotë, duke përmbajtur rregullat që i përshtaten standardeve ndërkombëtare dhe janë ngritur institucionet në përputhje me këto standarde, zbatimi praktik i tij në drejtëm të transparencës dhe përgjegjësisë mbetet një sfidë. Në këtë kuptim rekomandohet rritja e kapacitetit në përdorimin e të gjithë mekanizmave të parashikuara nga legjislacioni, me qëllim garantimin e objektivitetit dhe transparencës së veprimtarisë së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

4.3.7 Rishikimi i rregullave të etikës për prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe administratën e prokurorisë, si dhe i planeve institucionale të integritetit në raport me standardet e BE-së dhe kërkesat e vazhdueshme nga partnerët ndërkombëtarë për rritjen e përgjegjshmërisë dhe transparencës në sjelljen etike dhe profesionale. Ky rishikimin duhet të sigurojë përshtatjen me këto standarde dhe që rregullat të jenë të aplikueshme për të gjitha zyrat e prokurorisë. Gjithashtu, duhet të sigurohet edhe publikimi dhe aksesimi i plotë dhe i thjeshtë i këtyre rregullave për njohje nga publiku.

Zhvillimi i aktiviteteve për njohjen dhe zbatimin praktik të tyre është një tjetër rekomandim për të dy institucionet.

4.3.8 Rekomandohet marrja e masave për funksionimin e plotë dhe në mënyrë eficiente të sistemit të ndarjes së çështjeve, për të siguruar përmirësimin e mbarëvajtjes së hetimeve për çështjet, si dhe nxitjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë së prokurorisë në procedurat përkatëse. Ky sistem duhet që, gjithashtu, të sigurojë aksesueshmërinë në të dhëna, si dhe të garantojë paanësinë dhe konfidencialitetin.

4.3.9 Prokuroria të përcaktojë qartë vijën ndarëse midis detyrimit për ruajtjen e sekretit hetimor, respektimit të së drejtës së informimit dhe aksesit në dosje, si dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Për këtë qëllim, rekomandohet që të hartohet një metodologji e qartë e përdorimit të informacionit që përbën sekret hetimor, duke respektuar detyrimet ligjore për secilën nga këto fusha.

4.3.10 Në përputhje me legjislacionin e ri për mbrojtjen e të dhënave personale, prokuroria të përcaktojë rregulla të qarta për mbrojtjen dhe respektimin e të dhënave të subjekteve të hetimit nga punonjësit që disponojnë këto të dhëna për shkak të detyrës.

4.4 Sigurimi i eficiencës dhe ngritja e kapaciteteve institucionale

4.4.1 Me qëllim uljen e *backlog*-ut, vonesave të krijuara për shkak të numrit të madh të çështjeve, si dhe rritjen e cilësisë së hetimeve dhe thellimit në to, rekomandohet të krijohen seksione apo task-forca për të trajtuar në mënyrë të specializuar veprat penale që janë komplekse për t'u hetuar dhe kërkojnë njohuri të specializuara për hetimin e tyre. Kjo, me qëllim reduktimin e kohës që nevojitet për përfundimin e hetimeve dhe përqendrimin e veprimeve hetimore të duhura për krimet, të tilla si: korrupsioni, krimet e jakave të bardha, mashtrimi dhe çdo shkelje tjetër financiare, si dhe për veprat penale të dhunshme të kryera në kuadër të organizatave kriminale apo terroriste.

4.4.2 Rekomandohet që PP-ja dhe SPAK-u të rishikojnë kapacitetet dhe mjetet përkatëse të nevojshme për kryerjen e hetimeve, si dhe të miratojnë një strategji që i jep përparësi çështjeve të pazgjidhura të cilat janë në rritje të vazhdueshme.

4.4.3 Me qëllim rritjen e eficiencës dhe thellimit të veprimeve hetimore rekomandohet rritja e përdorimit të njohurive të posaçme dhe ekspertizës



nga strukturat ekzistuese, të specializuara në fushat që lidhen me hetimin e veprave penale përkatëse.

4.4.4 Rekomandohet rritja e eficiencës në shpërndarjen dhe përdorimin e burimeve njerëzore për të rritur shkallën e suksesit të prokurorive.

4.4.5 Të rishikohet mundësia për miratimin e modeleve standarde të dokumenteve të punës së përditshme të prokurorëve dhe zyrave të prokurorisë, me qëllim reduktimin e kohës për kryerjen e veprimeve të hetimit, unifikimin e procedurave dhe veprimeve konkrete gjatë punës, rritjen e eficiencës së veprimtarisë, si dhe uljen e veprimeve të nevojshme për hetimin e çështjeve të prapambetura.

4.4.6 Rekomandohet rritja e rolit të PP-së dhe SPAK-ut për zhvillimin e trajnimeve të rregullta, me aktorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Këto trajnime duhet të kryhen rregullisht dhe duhet të standardizohen për t'i përshtatur njohuritë e prokurorëve dhe OPGJ-ve, në funksion të kryerjes së veprimeve hetimore.

4.4.7 Trajnimi i vazhdueshëm dhe zhvillimi profesional i prokurorëve janë thelbësorë për të siguruar kompetencën dhe efektivitetin e tyre në trajtimin e rasteve komplekse, veçanërisht të atyre që lidhen me korrupsionin. Programet e edukimit të vazhdueshëm duhet të përmirësohen, duke u fokusuar në zhvillimet më të fundit ligjore, standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira në punën e prokurorëve. Duhet të eksplorojnë sa më shumë mundësi për diversifikuar temat e trajnimeve në mënyrë që të merren njohuri të posaçme dhe të gjithanshme për kategori të caktuara veprash penale, si dhe të diversifikohen subjektet që ofrojnë trajnime, krahas Shkollës së Magjistraturës.

4.4.8 Prokurorëve dhe OPGJ-ve duhet t'u ofrohen mundësi për specializim në fusha kyçe, të tilla si antikorrupsioni, krimet në fushën financiare, krimet kibernetike/kompjuterike dhe krimi i organizuar, përmes moduleve të avancuara të trajnimit dhe *workshop*-eve. Për më tepër, mund të nxitet bashkëpunimi ndërkombëtar dhe programet e shkëmbimit, duke i lejuar prokurorët të fitojnë njohuri nga juridiksione të tjera dhe të ndajnë përvojat, duke pasuruar kështu aftësitë e tyre profesionale.

4.4.9 Rekomandohet që PP-ja dhe SPAK-u të bashkëpunojnë me Shkollën e Magjistraturës dhe aktorë të tjerë për të zgjedhur dhe për të implementuar një program për trajnimin, ngritjen e

kapaciteteve dhe injektimin e burimeve financiare nëpërmjet një plani kombëtar veprimi për trajnimin për ndjekjen penale të korrupsionit.

4.4.10 Rekomandohet rritja e rolit të PP-së dhe SPAK-ut për ofrimin e trajnimeve të prokurorëve dhe OPGJ-ve për standardet dhe procedurat e BE-së, lidhur me ekstradimin dhe ndihmën e ndërsjellë juridike, për më tepër që Shqipëria ndodhet në një fazë të avancuar për integrimin e saj në Bashkimin Evropian.

4.5 Përdorimi i metodave bashkëkohore të hetimit

4.5.1 Rekomandohet që prokuroria të intensifikojë përdorimin e metodave moderne të hetimit, me qëllim rritjen e efikasitetit në zbulimin dhe ndjekjen penale të veprave penale me kompleksitet të lartë.

4.5.2 Rekomandohet rritja e numrit të rasteve të përdorimit të metodave bashkëkohore dhe të metodave të veçanta të hetimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare hetimore.

4.5.3 Rekomandohet përmirësimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit në zyrat e prokurorisë.

4.5.4 Rekomandohet rritja e përdorimit të teknologjive bashkëkohore të njohura, përfshirë inteligjencën artificiale, për analizimin dhe kryqëzimin e të dhënave të mbledhura për të siguruar shpejtësi në kryerjen e veprimeve hetimore.

4.5.5 Rekomandohet promovimi dhe zgjerimi i përdorimit të metodave bashkëkohore të hetimit, si p.sh.: hetimet proaktive të bazuara në inteligjencën kriminale, përdorimi i teknikave të mbikëqyrjes elektronike dhe përgjimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi, zbatimin e analizës financiare dhe ndjekja e parimeve të hetimit pasuror, përdorimi i teknologjive digjitale për grumbullimin, menaxhimin dhe analizën e provave, si dhe rritja e kapaciteteve teknike dhe profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore për përdorimin e këtyre metodave.

4.6 Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë

4.6.1 Rekomandohet vijimi i bashkëpunimit për hartimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme në fushën penale, duke u angazhuar sistematikisht në procesin e hartimit, rishikimit dhe monitorimit të dokumenteve kombëtare në fushën e drejtësisë penale dhe luftës kundër kriminalitetit, duke kontribuar me të dhëna, analiza dhe rekomandime



praktike mbi zbatimin e legjislacionit penal në praktikë, si dhe duke emëruar një pikë kontakti institucionale për pjesëmarrje të rregullt në grupet e punës për hartimin e këtyre dokumenteve.

4.6.2 Rekomandohet bashkëpunimi i ngushtë në përgatitjen e një metodologjie për hartimin e statistikës së njësuar në fushën e drejtësisë për shkëmbimin periodik të të dhënave statistikore penale (çdo 3 muaj), me qëllim unifikimin e burimeve zyrtare të informacionit. Mbledhja dhe përdorimi i të dhënave të tilla është thelbësor për një vendimmarrje të mbështetur në informacion të saktë e të plotë, sikundër edhe për planifikimin strategjik. Të dhënat nga SPAK-u dhe PP-ja duhet të jenë gjithëpërfshirëse, duke mbuluar kriteret e ndryshme, përfshirë llojin e veprës penale dhe fazën e procedimit.

4.6.3 Rekomandohet vijimi dhe intensifikimi i bashkëpunimit ndërmjet prokurorisë dhe Ministrisë së Drejtësisë në cilësinë e autoritetit qendror për çështje të ndihmës juridike ndërkombëtare, me qëllim përmirësimin e efikasitetit në ekzekutimin e kërkesave për ekstradim, letërporosi dhe bashkëpunim të ndërsjellë penal.

4.6.4 Rekomandohet krijimi i një protokollit zyrtar për mbledhjen e të dhënave cilësore dhe sasiore nga prokuroria, që do të përdoren nga Ministria e Drejtësisë për përgatitjen e raporteve vjetore, periodike ose të veçanta, që i paraqiten Kuvendit, përfshirë tendencat në kriminalitet, zbatimin e strategjive dhe rekomandimet për përmirësim ligjor.

4.6.5 Rekomandohet që prokuroria të forcojë bashkëpunimin me shërbimin e ndihmës juridike dhe të kontribuojë në identifikimin dhe adresimin e çdo pengese praktike, që cenon ushtrimin e kësaj të drejte thelbësore.

4.7 Bashkëpunimi ndërinstitucional

4.7.1 Rekomandohet miratimi i një strategjie të përbashkët të PP-së dhe SPAK-ut, duke ndjekur reformat e ndërmarra tashmë, thelbësore për stabilitetin afatgjatë të vendit, për të pasur një qasje të koordinuar e gjithëpërfshirëse, si dhe për të lehtësuar e për të rritur bashkëpunimin ndërmjet tyre.

4.7.2 Rekomandohet bashkëpunimi me organet e specializuara dhe të ngritura për zbatimin e monitorimit të veprimtarisë, që ushtrohet në fusha të ndryshme të grupuara, si: siguria kibernetike dhe mbrojtja e të dhënave personale, dhuna ndaj grave,

rekomandimet e MONEYVAL-it, veprat penale që kryhen në/dhe përmes rrjeteve sociale, krimet në fushën financiare dhe doganore, krimet mjedisore, krimet në fushën e shëndetit dhe sigurisë ushqimore, krimet në fushën e prokurimeve dhe tenderave etj.

4.7.3 Rekomandohet bashkëpunimi me institucionet përkatëse, me qëllim sigurimin e zbatimit të masave të parashikuara në strategjitë kombëtare, si ajo për të miturit, të drejtësisë, të viktimave të krimit, antikorrupsionit, trafikimit të qenieve njerëzore, sigurisë kibernetike, si dhe të gjitha strategjive të tjera sipas fushave përkatëse.

4.7.4 Rekomandohet që të vendosen pika kontakti ndërmjet prokurorisë dhe institucioneve përkatëse për vepra penale të cilat kërkojnë hetim të thelluar dhe njohuri të specializuara, me qëllim lehtësimin e komunikimit të shpejtë dhe efikas, formalizimi i rregullimit të marrëdhënies me to, si dhe miratimin e metodologjisë së saktë për funksionimin e pikave të kontaktit.

4.7.5 Rekomandohet rritja e efektivitetit të shkëmbimit të të dhënave me Ministrinë e Drejtësisë, ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera ligjzbatuese, me qëllim identifikimin e saktë të trendeve në kryerjen e veprave penale për të siguruar marrjen e masave për zbatimin e një politike penale adekuate dhe koherente.

4.7.6 Rekomandohet që prokuroria të marrë masa për nënshkrimin e memorandumeve apo marrëveshjeve për shkëmbimin e të dhënave ndërmjet institucioneve, sipas masave të vendosura nëpërmjet legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

4.7.7 Përpara se ndonjë e dhënë të shkëmbehet ndërmjet organeve, duhet të merret parasysh nëse kërkohet një memorandum mirëkuptimi ose marrëveshje për ndarjen e këtyre të dhënave, nëse nuk ekziston tashmë, e cila do të lehtësonte një shkëmbim të tillë të të dhënave. Kjo duhet të adresojë, sipas nevojave, ndër të tjera, palët, organizatat e tjera, të përfshira në ndarjen/qasjen e të dhënave, të dhënat që do të ndahen, qeverisjen e informacionit, bazën ligjore dhe të drejtat e informacionit.

4.7.8 Të rritet bashkëpunimi nëpërmjet formave të ndryshme ose gjetjes së formave të reja të bashkëpunimit midis prokurorisë, Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit, në përputhje me nevojat e identifikuar nga secili institucion.



4.7.9 Rekomandohet rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional për përgatitjen për procesin e vlerësimit të Shqipërisë nga MONEYVAL-i për pastrimin e parave/luftimin e financimit të terrorizmit.

4.8 Bashkëpunimi ndërkombëtar

4.8.1 Rekomandohet rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar, sipas legjislacionit në fuqi për të shënjestruar krimin e organizuar dhe krimin ndërkufitar.

4.8.2 Rekomandohet forcimi më tej i luftës kundër krimit të organizuar, duke përfshirë bashkëpunimin e vazhdueshëm me shtetet anëtare të BE-së dhe agjencitë e BE-së (përfshirë Europolin, në kuadrin e platformës multidisiplinare evropiane kundër kërcënimeve kriminale (EMPACT dhe Eurojust-in), të rrisë kapacitetin për të luftuar krimin kibernetik dhe pastrimin e parave, dhe parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore.

4.8.3 Rekomandohet, gjithashtu, që të forcohet bashkëpunimi institucional, nëpërmjet rritjes së krijimit të skuadrave të përbashkëta hetimore për të trajtuar krimet komplekse ndërkombëtare, duke lejuar bashkëpunimin në kohë reale dhe ndarjen e provave.

Aneks 1

ANALIZA KRAHASUESE 2023–2024

Bazuar në statistikën e dërguara nga organi i prokurorisë, në zbatim të nenit 38, germa “h”, të ligjit nr. 97/2016¹, si nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar².

- Gjykimi i drejtpërdrejtë:

- Viti 2023:

Organi i prokurorisë për vitin 2023 ka dërguar për gjykim 9652 çështje (nuk përfshihen çështjet e mbartura në gjykim), por vetëm për 283 çështje ka kërkuar që të gjykohen me procedurë gjykimi të drejtpërdrejtë ose rreth 2.9%.

- Viti 2024:

Organi i prokurorisë për vitin 2024 ka dërguar për gjykim 9030 çështje (nuk përfshihen çështjet e mbartura në gjykim), por vetëm për 333 çështje ka kërkuar që të gjykohen me procedurë gjykimi të drejtpërdrejtë ose rreth 3.7%.

- Konkluzion:

Nga të dhënat statistikore rezulton se gjykimi i drejtpërdrejtë vijon të jetë një nga llojet e gjykimeve më pak të kërkuara nga organi i prokurorisë. Gjithsesi, rezulton një ulje e numrit të çështjeve të dërguara për gjykim krahasuar me vitin 2023 me 622 çështje më pak, dhe një rritje e çështjeve për të cilat është kërkuar gjykimi i drejtpërdrejtë me 50 çështje më shumë.

- Numri i çështjeve të filluara kryesisht:

- Viti 2023 – Prokuroria e Përgjithshme:

Në vitin 2023, rezulton se nga organi i Prokurorisë së Përgjithshme, numri i përgjithshëm i veprave penale të referuara dhe kallëzuara është 38.613, nga të cilat vetëm 138 janë vepra penale të filluara kryesisht nga Prokurori ose rreth 0,35% e numrit të përgjithshëm.

Nga këto 138 çështje të filluara kryesisht, vetëm 18 janë të filluara kryesisht për veprat penale në fushën e korrupsionit³ ose rreth 13 % e numrit të çështjeve kryesisht.

- Viti 2024 – Prokuroria e Përgjithshme:

Në vitin 2024, rezulton se nga organi i Prokurorisë së Përgjithshme, numri i përgjithshëm i veprave penale të referuara dhe kallëzuara është 39535, nga të cilat vetëm 155 janë vepra penale të filluara kryesisht nga Prokurori ose rreth 0,39% e numrit të përgjithshëm.

Nga këto 155 çështje të filluara kryesisht, vetëm 20 janë të filluara kryesisht për veprat penale në fushën e korrupsionit⁴ ose rreth 12.9% e numrit të çështjeve kryesisht.

¹ Me shkresat e Prokurorisë së Përgjithshme me nr. 622/51 prot., datë 12.3.2025, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 1522 prot., datë 12.3.2025 dhe nr. 622/54 prot., datë 17.3.2025, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 1021/2 prot., datë 17.3.2025, bazuar në nenin 38/“h”, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” ku parashikohet se: “Prokurori i Përgjithshëm ushtron këto kompetenca: b) i dërgon Ministrisë së Drejtësisë të dhënat statistikore të ndjekjes penale, për hartimin e statistikës së njëzuar në fushën e drejtësisë.”.

² Shkresa e Prokurorisë së Posaçme me nr. 9020 prot., datë 12.3.2025, protokolluar pranë nesh me nr. 1021/1 prot., datë 12.3.2025.

³ Krahasimi është bërë për 8 veprat penale (nenet 164/“a”, 164/“b”, 248, 256 dhe 257/“a”, 244/1; 254/1; 254/3 dhe 259/1 të Kodit Penal).

⁴ Krahasimi është bërë për 8 veprat penale (nenet 164/“a”, 164/“b”, 248, 256 dhe 257/“a”, 244/1; 254/1; 254/3 dhe 259/1 të Kodit Penal).



Tabela krahasimore për të dyja vitet 2023–2024 për çështjet kryesisht në fushën e korrupsionit, të

mbetur në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme.

Veprat penale në fushën e korrupsionit	Viti 2023	Viti 2024	Konkluzione
164/“a”	0	0	Nuk ka çështje të filluara kryesisht.
164/“b”	0	0	Nuk ka çështje të filluara kryesisht.
248	15	19	Rritje me 4 çështje më shumë.
256	0	0	Nuk ka çështje të filluara kryesisht.
257/“a”	1	0	Ulje me 1 çështje më pak.
244/1	0	1	Rritje me 1 çështje më shumë.
254/1	0	0	Nuk ka çështje të filluara kryesisht.
254/3	0	0	Nuk ka çështje të filluara kryesisht.
259/1	2	0	Ulje me 2 çështje më pak.

- Viti 2023 – Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar:

Në vitin 2023, Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) rezulton se⁵ ka hetuar, gjithsej, 750 procedime penale, nga të cilat 451 procedime penale janë mbartur nga viti 2022, ndërsa 299 procedime penale janë regjistruar nga Prokuroria e Posaçme gjatë vitit 2023 si procedime penale të reja. Nga 299 procedime penale të reja të filluara në vitin 2023, 44 procedime penale janë dërguar për kompetencë nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore dhe 67 procedime penale janë regjistruar kryesisht nga Prokuroria e Posaçme me 23 persona nën hetim. Për 42 procedime penale është vendosur bashkimi i çështjes duke shkuar në 708 procedime penale, me 575 persona nën hetim.

- Viti 2024 – Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar:

Në vitin 2024, Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) rezulton se⁶ ka hetuar, gjithsej, 793 procedime penale, nga të cilat 65 procedime penale janë regjistruar kryesisht nga Prokuroria e Posaçme.

- Konkluzion:

Rezulton se ka rritje të numrit të përgjithshëm të çështjeve penale me 922 çështje penale të referuara dhe kallëzuara më shumë se

në vitin 2023, si dhe një rritje e numrit të çështjeve të regjistruara kryesisht me 17 çështje më shumë.

Ndërsa për çështjet e filluara kryesisht për veprat penale kundër korrupsionit, kemi rritje vetëm me 2 çështje më shumë.

Për vitin 2024, Prokuroria e Posaçme rezulton se ka një rritje të numrit të procedimeve të hetuara me 43 procedime më shumë, por numri i procedimeve të regjistruara kryesisht ka një ulje me 2 procedime më pak, rreth 8,2% e totalit të procedimeve të hetuara.

- Korrupsioni:

- Viti 2023 – Prokuroria e Përgjithshme:

Nga të dhënat statistikore për të njëjtin grupveprash, përpara ndryshimeve të kompetencës lëndore me ligjin nr. 41/2021, datë 23.3.2021, “Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, ‘Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, rezulton se nga organi i Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2023 janë hetuar 1981 procedime penale për tetë veprat penale të mbetura në kompetencë lëndore në fushën e korrupsionit,⁷ me një numër total prej 223 personash nën hetim dhe janë marrë të pandehur 336 persona. Janë dërguar për gjykim vetëm 204 procedime penale ose rreth 10.3 % e çështjeve të hetuara, me 338 të pandehur.

⁵ Me shkresën e Prokurorisë së Posaçme nr. 9020 prot., datë 12.3.2025, protokolluar pranë nesh me nr. 1021/1 prot., datë 12.3.2025.

⁶ Me shkresën e Prokurorisë së Posaçme nr. 9020 prot., datë 12.3.2025, protokolluar pranë nesh me nr. 1021/1 prot., datë 12.3.2025.

⁷ Bazuar në 8 veprat penale në fushën e korrupsionit që kishin mbetur në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme (nenet 164/“a”, 164/“b”, 248, 256 dhe 257/“a”, 244/1; 245/1; 245/3 dhe 259/1 të Kodit Penal).



Për vitin 2023 ka përfunduar gjykimi për 40 çështje penale për veprat penale kundër korrupsionit me një numër prej 91 të pandehurish, nga të cilët janë dënuar 186 persona.

- Viti 2024 – Prokuroria e Përgjithshme:

Nga të dhënat statistikore për të njëjtin grupveprash, përpara ndryshimeve të kompetencës lëndore me ligjin nr. 41/2021, datë 23.3.2021, “Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995, ‘Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, rezulton se nga organi i Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2024 janë hetuar 2030 procedime penale për tetë veprat penale të mbetura në kompetencë lëndore në fushën e korrupsionit,⁸ me një numër total prej 252 personash nën hetim dhe janë marrë të pandehur 260 persona. Janë dërguar për gjykim vetëm 158 procedime penale ose rreth 7.8 % e çështjeve të hetuara, me 235 të pandehur.

Për vitin 2024 ka përfunduar gjykimi për 43 çështje penale për veprat penale kundër korrupsionit me një numër prej 101 të pandehurish, nga të cilët janë dënuar 193 persona.

- Konkluzion:

Për vitin 2024, lidhur me veprat penale në fushën e korrupsionit të mbetur në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Përgjithshme⁹, rezulton se ka një rritje të numrit të hetimeve për veprat penale të korrupsionit në krahasim me vitin 2023, me 49 çështje më shumë, rritje të numrit të personave nën hetim me 29 persona më shumë nën hetim dhe me ulje 76 persona më pak të marrë si të pandehur, krahasuar me të dhënat e vitit të kaluar.

Gjithashtu, rezulton një ulje e numrit të çështjeve të dërguara për gjykim me 46 çështje më pak dhe ulje e numrit të personave të marrë të pandehur me 103 të pandehur më pak.

Rezulton se ka një rritje të lehtë të çështjeve për të cilat ka përfunduar gjykimi me 3 çështje më tepër, një rritje e numrit me 10 persona të

pandehur më shumë dhe 7 të dënuar më shumë.

- Viti 2023 – Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar:

Lidhur me veprat penale në fushën e korrupsionit me ndryshimet ligjore në Kodin e Procedurës Penale¹⁰, i kanë kaluar SPAK-ut për kompetencë lëndore nenet: 230, 230/“a”, 230/“b”, 230/“c”, 230/“ç”, 231, 232, 232/“a”, 232/“b”, 233, 234, 234/“a”, 234/“b”, 244, paragrafi 2, 244/“a”, 245, 245/1, paragrafët 2 dhe 4, 257, 258, paragrafi 2, 259, paragrafi 2, 259/“a”, 260, 312, 319, 319/“a”, 319/“b”, 319/“c”, 319/“ç”, 319/“d”, 319/“dh”, 319/“e”, 328 dhe 328/“b” të Kodit Penal, duke sjellë që një pjesë e dispozitave të kalojnë sërish për kompetencë lëndore pranë Prokurorive të juridiksionit të zakonshëm.

Nga të dhënat statistikore rezulton se nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), për vitin 2023, janë regjistruar 447 procedime penale në fushën e korrupsionit ose rreth 63.1% e veprave penale të regjistruara i përkasin grupit të veprave në fushën e korrupsionit.

Nga 447 çështje të hetuara nga Prokuroria e Posaçme për veprat penale në fushën e korrupsionit, 38 çështje janë dërguar me kërkesën për gjykim për 142 të pandehur, nga të cilët 38 persona të pandehur hetuar me masa sigurimi “arrest në burg”; 6 persona të pandehur hetuar me masë sigurimi “arrest në burg në mungesë” (ose 31 persona më pak nga viti i kaluar¹¹), 22 persona të pandehur hetuar me masë sigurimi “arrest në shtëpi” (ose 5 persona më pak se vitin e kaluar¹²), 19 persona të pandehur hetuar me masë sigurimi “detyrim për t’u paraqitur” (ose 5 persona më tepër se vitin e kaluar¹³), 1 person i pandehur për “ndalimi i daljes jashtë shtetit” (1 person më tepër se vitin e kaluar¹⁴) dhe 56 persona të pandehur janë hetuar dhe dërguar në gjykatë pa caktuar ndaj tyre ndonjë masë sigurimi.

⁸ Bazuar në 8 veprat penale në fushën e korrupsionit që kishin mbetur në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme (nenet 164/“a”, 164/“b”, 248, 256 dhe 257/“a”, 244/1; 245/1; 245/3 dhe 259/1 të Kodit Penal).

⁹ Bazuar në 8 veprat penale në fushën e korrupsionit që kishin mbetur në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme (nenet 164/“a”, 164/“b”, 248, 256 dhe 257/“a”, 244/1; 245/1; 245/3 dhe 259/1 të Kodit Penal).

¹⁰ Ndryshuar me ligjin nr. 41/2021, datë 23.3.2021, “Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, Faqe | 7986

‘Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”.

¹¹ Për vitin 2022 rezultojnë 75 persona me masë sigurimi arrest në burg (pa specifikuar nëse janë në mungesë ose jo).

¹² Për vitin 2022 rezultojnë 27 persona me masë sigurimi arrest në shtëpi.

¹³ Për vitin 2022 rezultojnë 14 persona me masë sigurimi detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore.

¹⁴ Për vitin 2022 nuk ka pasur asnjë person me këtë masë ndaluese.



Ndërsa për Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk ka të dhëna statistikore për çështje penale për të cilat ka përfunduar gjykimi.

Por rezulton se ka të dhëna statistikore lidhur me vendimet e dhëna, e konkretisht, për vitin 2023 nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë dhënë, gjithsej, 67 vendime dënimi me 233 persona të dënuar, nga të cilat 47 çështje penale me 174 persona kanë qenë për veprat penale në fushën e korrupsionit dhe vepra penale të tjera. Ndërsa, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për vitin 2023 janë dhënë, gjithsej, 57 vendime dënimi me 133 persona të dënuar, nga të cilat 35 çështje penale me 84 persona kanë qenë për vepra penale në fushën e korrupsionit dhe vepra penale të tjera.

- Viti 2024 – Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar:

Lidhur me veprat penale në fushën e korrupsionit me ndryshimet ligjore në Kodin e Procedurës Penale¹⁵, i kanë kaluar SPAK-ut për kompetencë lëndore nenet: 230, 230/“a”, 230/“b”, 230/“c”, 230/“ç”, 231, 232, 232/“a”, 232/“b”, 233, 234, 234/“a”, 234/“b”, 244, paragrafi 2, 244/“a”, 245, 245/1, paragrafët 2 dhe 4, 257, 258, paragrafi 2, 259, paragrafi 2, 259/“a”, 260, 312, 319, 319/“a”, 319/“b”, 319/“c”, 319/“ç”, 319/“d”, 319/“dh”, 319/“e”, 328 dhe 328/“b” të Kodit Penal, duke sjellë që një pjesë e dispozitave të kalojnë sërish për kompetencë lëndore pranë prokurorive të juridiksionit të zakonshëm.

Nga të dhënat statistikore rezulton se nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), për vitin 2024, janë regjistruar 483 procedime penale në fushën e korrupsionit ose rreth 60.91% e veprave penale të regjistruara i përkasin grupit të veprave në fushën e korrupsionit.

Nga 483 çështje të hetuara nga Prokuroria e Posaçme për veprat penale në fushën e korrupsionit, 41 çështje janë dërguar me kërkesën për gjykim për 141 të hetuar/të pandehur, nga të cilët për 36 persona të pandehur është caktuar masa e sigurimit “arrest në burg”, nga të cilët 7 në mungesë (ose 8 persona më pak se nga viti i kaluar); për 19 persona

të pandehur është caktuar masa e sigurimit “arrest në shtëpi” (ose 3 persona më shumë se nga viti i kaluar); për 25 persona të pandehur është caktuar masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur” (ose 6 persona më tepër se vitin e kaluar); për 5 persona të pandehur është caktuar masa e sigurimit “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik” dhe 56 persona të pandehur janë hetuar dhe dërguar në gjykatë pa caktuar ndaj tyre ndonjë masë sigurimi (në të njëjtat shifra si vitin e kaluar); nuk ka asnjë rast të caktimit të numrit të personave me masë sigurimit “ndalimi i daljes jashtë shtetit” (1 person më pak).

Për vitin 2024 nuk rezulton të ketë të dhëna statistikore për veprat penale kundër korrupsionit për të cilat ka përfunduar gjykimi në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë dhe Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Gjithashtu, nuk ka as të dhëna statistikore lidhur me vendimet e dhëna për këto grupveprash penale nga Gjykatat e Posaçme.

- Konkluzion:

Për vitin 2024, lidhur me veprat penale në fushën e korrupsionit, të cilat me ndryshimet ligjore në Kodin e Procedurës Penale i kanë kaluar SPAK-ut për kompetencë, rezulton se kemi një rritje të numrit të përgjithshëm të çështjeve penale të regjistruara në fushën e korrupsionit prej 36 çështje më shumë, rritje e numrit të çështjeve të dërguara për gjykim me 3 çështje më shumë, si dhe ulje e lehtë me 1 të pandehur më pak se në vitin 2023.

Për vitin 2024 nuk rezulton të ketë të dhëna statistikore për veprat penale kundër korrupsionit për të cilat ka përfunduar gjykimi në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë dhe Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Gjithashtu, nuk ka as të dhëna statistikore lidhur me vendimet e dhëna për këto grupveprash penale nga Gjykatat e Posaçme.

- Për veprën penale të “Refuzimit për deklarimin, mosdeklarimin, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe i nëpunësve publik ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim” – neni 257/“a” i Kodit Penal:

¹⁵Ndryshuar me ligjin nr. 41/2021, datë 23.3.2021, “Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995,

‘Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”.



Vepra penale e “Refuzimit për deklarimin, mosdeklarimin, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe i nëpunësve publik ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, parashikuar nga neni 257/“a” i Kodit Penal, është veprë penale që referohet nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit.

- Viti 2023

Numri i procedimeve penale të regjistruara nga ana e organit të Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2023 është 7, ndërsa numri i procedimeve të dërguara për gjykim është 2.

- Viti 2024

Numri i procedimeve penale të regjistruara nga ana e organit të Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2024 është 17, ndërsa numri i procedimeve të dërguara për gjykim është 2.

- Konkluzion:

Konstatohet se për vitin 2024 kemi rritje të numrit të çështjeve të regjistruara me 10 çështje më shumë dhe mbetemi në të njëjtat shifra të numrit të procedimeve të dërguara për gjykim njësoj si në vitin 2023.

- Veprat penale në fushën e Krimit të Organizuar:

- Viti 2023 – Prokuroria e Përgjithshme:

Referuar të dhënave statistikore për Prokurorinë e Përgjithshme rezulton se për vitin 2023, në lidhje me veprat penale të trafikimit¹⁶, rezulton se janë regjistruar 243 çështje penale me 41 persona nën hetim, nga të cilët 23 janë marrë si të pandehur. Nga ky grupveprash, numrin më të madh të çështjeve e ka vepra penale “Trafikimi i mjeteve motorike” parashikuar nga neni 141/“a” i K. Penal me 156 çështje të regjistruara. Nga këto çështje janë dërguar për gjykim 30 çështje me 41 të pandehur.

- Viti 2024 – Prokuroria e Përgjithshme:

Referuar të dhënave statistikore për Prokurorinë e Përgjithshme rezulton se për vitin 2024, në lidhje me veprat penale të trafikimit¹⁷, rezulton se janë regjistruar 306 çështje penale me 24 persona nën hetim, nga të cilët 24 janë marrë si të pandehur. Nga ky grupveprash, numrin më të madh të çështjeve e ka vepra penale “Trafikimi i mjeteve motorike” parashikuar nga neni 141/“a” i K. Penal me 206

çështje të regjistruara. Nga këto çështje janë dërguar për gjykim 33 çështje me 49 të pandehur.

- Viti 2023 – Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar:

Nga të dhënat statistikore rezulton se, gjatë vitit 2023 Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), ka regjistruar 201 procedime penale në fushën e krimit të organizuar. Në lidhje me çështjet e regjistruara rezulton se janë dërguar për gjykim 11 çështje.

Nga 11 çështjet e dërguara për gjykim për vitin 2023, rezulton se numri i të hetuarve/pandehurve është 109 persona ose 9 persona më shumë se vjet.

Nga këto çështje për 90 persona është caktuar masa e sigurimit “Arrest me burg”, 3 persona të pandehur hetuar me masë sigurimi “Arrest në shtëpi”, 5 persona të pandehur hetuar me masë sigurimi “Arrest në burg në mungesë”, 10 persona të pandehur hetuar me masë sigurimi “Detyrim për t’u paraqitur”, 1 person i pandehur me “Detyrimi daljes jashtë shtetit”.

Për vitin 2023 nuk rezulton të ketë të dhëna statistikore më vete për veprat penale kundër krimit të organizuar për të cilat ka përfunduar gjykimi në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë dhe Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Konkretisht, për vitin 2023 rezulton se ka përfunduar gjykimi i themelit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për 75 çështje penale për veprat penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar me një numër prej 260 të pandehurish. Ndërsa për Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk ka të dhëna statistikore për çështje penale për të cilat ka përfunduar gjykimi.

Por rezulton se ka të dhëna statistikore lidhur me vendimet e dhëna, e konkretisht, për vitin 2023 nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë dhënë, gjithsej, 67 vendime dënimi me 233 persona të dënuar, nga të cilat 20 çështje penale me 59 persona kanë qenë për vepra penale në fushën e krimit të organizuar.

Në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për vitin 2023 janë dhënë, gjithsej, 57 vendime dënimi me 133 persona të dënuar, nga të cilat 22 çështje me 49

¹⁶ Nenet 109, 109/“b”, 110/ “a”, 128/“b”, 138/“a”, 141/“a”, 278/“a” dhe 282/“a” të Kodit Penal.

¹⁷ Nenet 109, 109/“b”, 110/“a”, 128/“b”, 138/“a”, 141/“a”, 278/“a” dhe 282/“a” të Kodit Penal.



persona kanë qenë për vepra penale në fushën e krimit të organizuar.

- Viti 2024 – Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar:

Nga të dhënat statistikore rezulton se, gjatë vitit 2024 Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), ka regjistruar 245 procedime penale në fushën e krimit të organizuar. Në lidhje me çështjet e regjistruara rezulton se janë dërguar për gjykim 21 çështje.

Nga 21 çështjet e dërguara për gjykim për vitin 2024, rezulton se numri i të hetuarve/ pandehurve është 134 persona ose 25 persona më shumë se vjet.

Nga këto çështje, për 108 persona është caktuar masa e sigurimit “Arrest me burg” nga të cilat 24 në mungesë, për 21 persona është caktuar masa e sigurimit “Arrest në shtëpi”; 5 persona të pandehur hetuar me masë sigurimi “Detyrim për t’u paraqitur”.

- Konkluzion:

Në lidhje me veprat penale të trafikimit, në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2024, rezulton një rritje e konsiderueshme e numrit të çështjeve të regjistruara me 63 procedime më shumë dhe ulje e numrit të personave nën hetim me 17 më pak dhe rritje e lehtë e personave të marrë si të pandehur me 1 person më shumë.

Lidhur me numrin e çështjeve të dërguara për gjykim për vitin 2024, numri i tyre është rritur me 3 çështje më shumë, po ashtu edhe numri i të pandehurve në gjykim është rritur me 8 persona më shumë krahasuar me vitin 2023.

Gjithashtu, Prokuroria e Posaçme lidhur me veprat penale në fushën e krimit të organizuar, rezulton një rritje me 44 procedime më shumë. Lidhur me numrin e çështjeve të dërguara për gjykim për vitin 2024, kemi një rritje me 10 çështje më shumë, si dhe rritje të numrit të pandehurve në gjykim me 25 të pandehur më shumë krahasuar me vitin 2023.

Konstatohet një rritje prej 13 personash më shumë për të cilët është caktuar masa e sigurimit personal “Arrest në burg”/“Arrest në burg” në mungesë, rritje me 18 persona më shumë për masën “arrest në shtëpi”, me ulje me 5 persona më pak për masën “detyrim paraqitje” dhe, gjithashtu, nuk ka asnjë masë

sigurimi “Detyrimi daljes jashtë shtetit” për të cilën në vitin 2023 ka qenë 1 person me këtë masë. Pra, numri i personave të pandehur për të cilët është caktuar masa e sigurimit “arrest me burg” vijon të mbetet i lartë për vitin 2024 me 108 persona, nga të cilat 24 në mungesë.

- Lëndët narkotike¹⁸

- Viti 2023:

Për vitin 2023 nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm janë hetuar 3213 çështje penale, me një numër prej 1183 persona nën hetim. Nga statistikat rezulton se janë marrë të pandehur 990 persona.

Nga këto çështje në hetim, janë dërguar për gjykim 599 çështje ose 18.6 % e çështjeve, me 904 të pandehur të dërguar për gjykim. *Numrin më të lartë të çështjeve në hetim e ka vepra penale: “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, neni 283 i Kodit Penal, me 1887 çështje në hetim, nga të cilat janë dërguar për gjykim 476 çështje.*

- Viti 2024:

Për vitin 2024 nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm janë hetuar 3447 çështje penale, me një numër prej 1005 persona nën hetim. Nga statistikat rezulton se janë marrë të pandehur 1321 persona.

Nga këto çështje në hetim, janë dërguar për gjykim 722 çështje ose 20.95 % e çështjeve, me 1210 të pandehur të dërguar për gjykim. *Numrin më të lartë të çështjeve në hetim e ka vepra penale: “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, neni 283 i Kodit Penal, me 2092 çështje në hetim, nga të cilat janë dërguar për gjykim 618 çështje.*

- Konkluzion:

Në vitin 2024 janë hetuar 234 çështje penale më shumë se në vitin 2023. Nga ana tjetër, rezulton një ulje e numrit të personave nën hetim me 178 persona të hetuar më pak, dhe rritje e numrit të pandehurve me 331 të pandehur më shumë.

Ka një rritje të çështjeve të dërguara për gjykim me 123 çështje më shumë se në vitin 2023 dhe rritje e numrit të të pandehurve me 306 të pandehur më shumë.

Në lidhje me veprat penale mbizotëruese për vitin 2024 vijon të jetë vepra penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” neni 283 i Kodit Penal, e cila ka pësuar rritje të mëtejshme në shifra krahasuar me vitin 2023, me 205 çështje nën hetim më shumë dhe 142 çështje të dërguara për gjykim më shumë.

- Veprat penale në fushën e terrorizmit

¹⁸ Ku janë përfshirë nenet 283–286/“a” të K. Penal.

**- Viti 2023:**

Në lidhje me veprat penale kundër terrorizmit¹⁹, të cilat në bazë të nenit 75/“a” të Kodit të Procedurës Penale i përkasin Prokurorisë së Posaçme, rezulton se janë regjistruar në total 4 çështje për vitin 2023 me asnjë person nën hetim dhe asnjë të pandehur. Në lidhje me çështjet e dërguara për gjykim për këtë kategori veprash për vitin 2023, nuk ka asnjë çështje të dërguar për gjykim.

Nga informacioni i përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme, lidhur me veprat penale për nxitjen e urrejtjes dhe pjesëmarrjen në konfliktet e armatosura²⁰ për vitin 2023 janë regjistruar 7 çështje penale me 2 persona nën hetim dhe asnjë të pandehur, për veprën penale “Nxitja e urrejtjes ose grindjeve”, parashikuar nga neni 265 i Kodit Penal. Rezulton se janë dërguar për gjykim 1 çështje, me 1 të pandehur që i përkasin veprës penale “Nxitja e urrejtjes ose grindjeve” parashikuar nga neni 265 i Kodit Penal.

- Viti 2024:

Në lidhje me veprat penale kundër terrorizmit²¹, të cilat në bazë të nenit 75/“a” të Kodit të Procedurës Penale i përkasin Prokurorisë së Posaçme, rezulton se janë regjistruar në total 26 çështje për vitin 2024 *me 1 të hetuar/të pandehur. Në lidhje me çështjet e dërguara për gjykim për këtë kategori veprash për vitin 2024, ka 1 çështje të dërguar për gjykim (për nenin 230/“a”), me 1 të hetuar/të pandehur dhe 1 person pa masë.*

Nga informacioni i përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme, lidhur me veprat penale për nxitjen e urrejtjes dhe pjesëmarrjen në konfliktet e armatosura²² për vitin 2024 janë regjistruar 6 çështje penale me 1 person nën hetim dhe asnjë të pandehur, për veprën penale “Nxitja e urrejtjes ose grindjeve”, parashikuar nga neni 265 i Kodit Penal. Rezulton se janë dërguar për gjykim 1 çështje, me 1 të pandehur që i përkasin veprës penale “Nxitja e urrejtjes ose grindjeve” parashikuar nga neni 265 i Kodit Penal.

- Konkluzion:

Krahasuar me vitin 2023, për veprat penale kundër terrorizmit kemi rritje me 22 çështje të regjistruara më shumë, rritje me 1 çështje më

shumë dërguar për gjykim dhe me 1 të hetuar/të pandehur më shumë të dërguar për gjykim.

Në lidhje me veprat penale për nxitjen e urrejtjes dhe pjesëmarrjen në konfliktet e armatosura, rezulton se kemi 1 çështje të regjistruar më pak, me 1 person nën hetim më pak dhe me asnjë të pandehur njësoj si në vitin 2023. Ndërsa lidhur me çështjet e dërguara për gjykim dhe numrin e të pandehurve dërguar për gjykim mbetemi në të njëjtat shifra si në vitin 2023.

- Dhuna në Familje**- Viti 2023**

Në lidhje me veprën penale “Dhuna në familje” parashikuar nga neni 130/“a” i Kodit Penal (të katër paragrafët), rezulton se për vitin 2023 janë regjistruar 1396 çështje penale ose rreth 3.92% e të gjitha çështjeve penale të regjistruara²³ dhe 1078 të pandehur. Rezulton se janë dërguar për gjykim 996²⁴ çështje për këtë veprë penale me total prej 1048²⁵ të pandehur, çka përbën një ulje prej 8.87% e procedimeve dhe 11.33% e të pandehurve të dërguar për gjykim.

Lidhur me politikën e dënimit të ndjekur gjatë gjykimit, në çështjet e dërguara për gjykim nga prokuroria për veprën penale “Dhuna në familje”, rezulton se nuk është kërkuar në asnjë rast dënimi maksimal i parashikuar nga paragrafi përkatës. Gjithashtu, krahasuar me vitin 2022 rezulton se: i. në asnjë rast nuk është kërkuar dënimi me gjobë; ii. në asnjë rast nuk është kërkuar dënimi sa periudha e paraburgimit; iii. për 102 të pandehur është kërkuar dënimi minimal i parashikuar nga dispozita; iv. për 287 të pandehur është kërkuar dënimi mesatar; v. në asnjë rast nuk është kërkuar ulja në minimumin e parashikuar nga dispozita; vi. për 240 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të dënimit; vii. në asnjë rast nuk është kërkuar tërheqja e akteve; viii. në 1 rast është kërkuar pushimi i akuzës; ix. për 5 të pandehur është kërkuar pushimi i çështjes; dhe x. në asnjë rast nuk është kërkuar pafajësi.

- Viti 2024

Në lidhje me veprën penale “Dhuna në familje” parashikuar nga neni 130/“a” i Kodit Penal (të katër paragrafët), rezulton se për vitin 2023 janë regjistruar

¹⁹ Nenet 230–232/“b” të Kodit Penal

²⁰ Nenet 265–265/“c” të Kodit Penal.

²¹ Nenet 230–232/“b” të Kodit Penal

²² Nenet 265–265/“c” të Kodit Penal.

²³ Për vitin 2023 janë regjistruar në total 38613 çështje.

²⁴ Për vitin 2022 ka qenë 1093 çështje.

²⁵ Për vitin 2022 ka qenë 1182 të pandehur.



1656 çështje penale, me 1238 persona në hetim/të pandehur ose me rritje 18.6% të procedimeve dhe rritje 14.8% e të pandehurve të regjistruar krahasuar me vitin 2023.

Rezulton se janë dërguar për gjykim 1124 procedime me 1194 të pandehur ose me rritje prej 12.85% të procedimeve dhe rritje 13.9% e të pandehurve të dërguar për gjykim, në krahasim me vitin 2023.

Lidhur me politikën e dënimit të ndjekur gjatë gjyimit, në çështjet e dërguara për gjykim nga prokuroria për veprën penale “Dhuna në familje” është kërkuar në 5 raste dënimi maksimal i parashikuar nga paragrafi përkatës . Gjithashtu, krahasuar me vitin 2023 rezulton se: i. në 1 rast është kërkuar dënimi me gjobë; ii. në 5 raste është kërkuar dënimi sa periudha e paraburgimit; iii. për 90 të pandehur është kërkuar dënimi minimal i parashikuar nga dispozita; iv. për 492 të pandehur është kërkuar dënimi mesatar; v. në asnjë rast nuk është kërkuar ulja nën minimumin e parashikuar nga

dispozita; vi. për 325 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të dënimit; vii. në 4 raste është kërkuar tërheqja e akteve; viii. në 2 raste është kërkuar pushimi i akuzës; ix. për 34 të pandehur është kërkuar pushimi i çështjes; dhe x. në 4 raste është kërkuar pafajësi.

- Konkluzion:

Rezulton rritje të numrit të çështjeve të regjistruara për veprën penale “Dhuna në familje” parashikuar nga neni 130/“a” i Kodit Penal me 260 çështje më shumë, me 160 të pandehur më shumë.

Gjithashtu, në lidhje me çështjet e dërguara për gjykim ka rritje me 128 çështje më shumë, me 146 persona të marrë si të pandehur më shumë.

Në lidhje me dënimin e kërkuar nga prokurori, konstatohet të ketë ashpërsim të politikës penale, në lidhje me këtë veprë, e konkretisht rezultojnë këto të dhëna:

Masa e dënimit	Viti 2023	Viti 2024	Konkluzioni
Max. i dispozitës	0	5	Rritje me 5 raste dhënie dënimi maksimal.
Koha e paraburgimit	0	5	Rritje me 5 raste dhënie dënimi sa periudha e paraburgimit.
Dënimi mesatar i dispozitës	287	492	Rritje me 205 raste dhënie dënimi mesatar.
Min. i dispozitës	102	90	Ulje me 12 raste dhënie dënimi minimal.
Pezullim ekzekutimi	240	325	Rritje prej 85 personash.
Gjobë	0	1	Rritje me 1 rast dhënie gjobe.

Për sa më sipër, konstatohet se kemi rritje me 5 raste që është kërkuar dënimi maksimal, nga asnjë rast që ka qenë në vitin 2023. Gjithashtu, kemi një rritje të lehtë me 1 rast të dënimit me gjobë, rritje me 5 raste të dënimit sa periudha e paraburgimit, ulje me 12 raste të dënimit në minimum, rritje e konsiderueshme me 205 raste të dënimit mesatar, rritje me 85 raste të pezullimit të ekzekutimit të dënimit, rritje me 29 raste të pushimit të çështjes, rritje me 4 raste ku është kërkuar tërheqja e akteve, rritje me 4 raste ku është kërkuar pafajësi dhe rritje me 1 rast të pushimit të akuzës.

- Veprat penale në fushën e mjedisit

- Viti 2023:

Në lidhje me veprat penale në fushën e mjedisit²⁶, nga të dhënat statistikore në vitin 2023 janë regjistruar 343 procedime penale ose me ulje 7.80% të numrit të procedimeve, me 40 persona nën hetim dhe 33 persona të pandehur.

Në lidhje me çështjet e dërguara për gjykim për këtë grup eprash rezulton se për vitin 2023 janë dërguar për gjykim 60 procedime me 69 të pandehur.

²⁶ Nenet 201–207, nenet 207/“a”, 207/“b”, 207/“c” dhe 207/“ç” të Kodit Penal, përfshirë ndryshimet e reja të vitit 2021.

**- Viti 2024:**

Në lidhje me veprat penale në fushën e mjedisit²⁷, nga të dhënat statistikore në vitin 2024 janë regjistruar 299 procedime penale me 55 persona të hetuar/të pandehur ose me ulje 12.83% të numrit të procedimeve dhe ulje me 24.66% të të pandehurve të regjistruar krahasuar me vitin 2023.

Në lidhje me çështjet e dërguara për gjykim për këtë grupveprash rezulton se për vitin 2024 janë dërguar për gjykim 55 procedime me 78 të pandehur.

- Konkluzion:

Në tërësi, për këtë kategori veprash penale në krahasim me vitin 2024, vihet re një ulje e numrit të procedimeve të regjistruara me 44 procedime më pak ose me ulje 12.8% të numrit të procedimeve, ulje me 18 persona nën hetim/të pandehur më pak ose me ulje 24.65% të numrit të pandehurve/personave nën hetim të regjistruar krahasuar me vitin 2023. Gjithashtu, rezulton një ulje me 5 procedime më pak dërguar për gjykim ose ulje me 8.3% të procedimeve, si dhe rritje prej 9 të pandehur më shumë ose rritje 13.04% të të pandehurve të dërguar për gjykim krahasuar me vitin 2023.

Aneks 2**LIDHUR ME ASHPËRSIMIN E DËNIMIT**

Bazuar në statistikën e dërguara nga organi i prokurorisë, në zbatim të nenit 38, germa “h”, të ligjit nr. 97/2016²⁸, si dhe informacionin e përcjellë nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar²⁹:

Veprat penale kundër korrupsionit, në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Përgjithshme (nenet 164/“a”, 164/“b”, 248, 256 dhe 257/“a”, 244/1; 245/1-1; 245/1-3 dhe 259/1 të Kodit Penal), si dhe veprat penale në fushën

e korrupsionit në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Posaçme – SPAK-ut (nenet 230, 230/“a”, 230/“b”, 230/“c”, 230/“ç”, 231, 232, 232/“a”, 232/“b”, 233, 234, 234/“a”, 234/“b”, 244 paragrafi 2, 244/“a”, 245, 245/1 paragrafët 2 dhe 4, 257, 258 paragrafi 2, 259 paragrafi 2, 259/“a”, 260, 312, 319, 319/“a”, 319/“b”, 319/“c”, 319/“ç”, 319/“d”, 319/“dh”, 319/“e”, 328 dhe 328/“b” të Kodit Penal). Sqarojmë se kompetenca lëndore e SPAK-ut ka ndryshuar gjatë vitit 2021 me ligjin nr. 41/2021.

- Viti 2023:

Lidhur me veprat penale në fushën e korrupsionit në kompetencë lëndore të Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar³⁰, nga të dhënat statistikore rezulton se, për vitin 2023 janë regjistruar 447 procedime penale në fushën e korrupsionit, ku vetëm 38 çështje janë dërguar për gjykim me një numër prej 142 persona të hetuar/pandehur.

Nga këto çështje, për 38 persona të pandehur është caktuar masa e sigurimit “arrest në burg”; për 22 persona të pandehur është caktuar masa e sigurimit “arrest në shtëpi”; për 19 persona të pandehur është caktuar masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur”; për 6 persona të pandehur është caktuar masa e sigurimit “arrest në burg në mungesë”; për 1 person të pandehur është caktuar masa e sigurimit “ndalimi i daljes jashtë shtetit” dhe 56 persona të pandehur janë hetuar dhe dërguar në gjykatë pa caktuar ndaj tyre ndonjë masë sigurimi.

Për vitin 2023 nuk rezulton të ketë të dhëna statistikore më vete për veprat penale kundër korrupsionit për të cilat ka përfunduar gjykimi në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë dhe Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Konkretisht, për vitin 2023 rezulton se ka përfunduar gjykimi i themelit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për 75 çështje penale për veprat penale kundër

²⁷ Nenet 201–207, nenet 207/“a”, 207/“b”, 207/“c” dhe 207/“ç” të Kodit Penal, përfshirë ndryshimet e reja të vitit 2021.

²⁸ Me shkresat e Prokurorisë së Përgjithshme me nr. 622/51 prot., datë 11.3.2025, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 1522 prot., datë 12.3.2025 dhe shkresën nr. 622/54 prot., datë 17.3.2025, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 1021/2 prot., datë 17.3.2025, bazuar në nenin 38/“h”, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” ku parashikohet se: “Prokurori i Përgjithshëm Faqe| 7992

ushtron këto kompetenca: b) i dërgon Ministrisë së Drejtësisë të dhënat statistikore të ndjekjes penale, për hartimin e statistikës së njëzuar në fushën e drejtësisë.”.

²⁹ Me shkresën e Prokurorisë së Posaçme nr. 9020 prot., datë 12.3.2025, protokolluar pranë nesh me nr. 1021/1 prot., datë 12.3.2025.

³⁰ Ndryshuar me ligjin nr. 41/2021, datë 23.3.2021, “Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, ‘Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”.



korupsionit dhe krimin të organizuar me një numër prej 260 të pandehurish. Ndërsa për Gjykatën e Apelit për Korupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk ka të dhëna statistikore për çështje penale për të cilat ka përfunduar gjykimi.

Por rezulton se ka të dhëna statistikore lidhur me vendimet e dhëna, e konkretisht, për vitin 2023 nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korupsionin dhe Krimin e Organizuar janë dhënë gjithsej 67 vendime dënimi me 233 persona të dënuar, nga të cilat 47 çështje penale me 174 persona kanë qenë për veprat penale në fushën e korupsionit dhe vepra penale të tjera. Ndërsa, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korupsionin dhe Krimin e Organizuar, për vitin 2023, janë dhënë, gjithsej, 57 vendime dënimi me 133 persona të dënuar, nga të cilat 35 çështje penale me 84 persona kanë qenë për vepra penale në fushën e korupsionit dhe vepra penale të tjera.

Lidhur me veprat penale në fushën e korupsionit të cilat kanë mbetur në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Përgjithshme³¹, rezulton se për vitin 2023 janë dërguar për gjykim 204 çështje me 338 të pandehur, nga të cilët vetëm 13 persona kanë qenë me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Ndërsa në përfundim të gjykimit, kërkesa e prokurorisë ka qenë për 1 të pandehur dënim me gjobë dhe 192 me burgim nga të cilët:

Dënimi minimal i parashikuar nga dispozita: 21 të pandehur.

Dënimi mesatar i parashikuar nga dispozita: 20 të pandehur.

Pezullim i ekzekutimit (neni 59 i Kodit Penal): 151 të pandehur.

Ndërkohë për 8 veprat penale të mbetura në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton që në 1 rast (për nenin 248) është kërkuar tërheqje aktesh dhe prokurori ka kërkuar në 5 raste pushimin e çështjes, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

- Viti 2024:

Lidhur me veprat penale në fushën e korupsionit në kompetencë lëndore të Strukturës së

Posaçme kundër Korupsionit dhe Krimin të Organizuar³², nga të dhënat statistikore rezulton se, për vitin 2024 janë regjistruar 483 procedime penale në fushën e korupsionit, ku vetëm 41 çështje janë dërguar për gjykim me një numër prej 141 persona të hetuar/pandehur.

Nga këto 41 çështje dërguar për gjykim me një numër prej 141 persona të hetuar/pandehur, për 36 persona të pandehur është caktuar masa e sigurimit “arrest në burg” nga të cilat 7 në mungesë; për 19 persona të pandehur është caktuar masa e sigurimit “arrest në shtëpi”; për 25 persona të pandehur është caktuar masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur”; për 5 persona të pandehur është caktuar masa e sigurimit “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik” dhe 56 persona të pandehur janë hetuar dhe dërguar në gjykatë pa caktuar ndaj tyre ndonjë masë sigurimi.

Për vitin 2024 nuk rezulton të ketë të dhëna statistikore për veprat penale kundër korupsionit për të cilat ka përfunduar gjykimi në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë dhe Apelit për Korupsionin dhe Krimin e Organizuar. Gjithashtu, nuk ka as të dhëna statistikore lidhur me vendimet e dhëna për këto grupveprash penale nga Gjykatat e Posaçme.

Lidhur me veprat penale në fushën e korupsionit të cilat kanë mbetur në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Përgjithshme³³, rezulton se për vitin 2024 janë dërguar për gjykim 158 çështje me 235 të pandehur, nga të cilët vetëm 13 persona kanë qenë me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Ndërsa në përfundim të gjykimit kërkesa e prokurorisë ka qenë për 1 të pandehur dënim me gjobë dhe 193 me burgim nga të cilët:

Dënimi minimal i parashikuar nga dispozita: 7 të pandehur.

Dënimi mesatar i parashikuar nga dispozita: 60 të pandehur.

Pezullim i ekzekutimit (neni 59 i Kodit Penal): 126 të pandehur.

Ndërkohë për 8 veprat penale të mbetura në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton që në 1 rast (për nenin 248) është kërkuar

³¹ Bazuar në 8 veprat penale në fushën e korupsionit që kishin mbetur në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme (nenet 164/ “a”, 164/ “b”, 248, 256 dhe 257/ “a”, 244/1; 245/1; 245/3 dhe 259/1 të Kodit Penal).

³² Ndryshuar me ligjin nr. 41/2021, datë 23.3.2021, “Për një shtesë dhe disa ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995,

‘Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”.

³³ Bazuar në 8 veprat penale në fushën e korupsionit që kishin mbetur në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme (nenet 164/“a”, 164/“b”, 248, 256 dhe 257/“a”, 244/1; 245/1; 245/3 dhe 259/1 të Kodit Penal).



tërheqje aktesh; në 32 raste është kërkuar pushimi i çështjes për veprën penale të “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike” neni 244/1 i K. Penal – 23 raste dhe “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal – 9 raste; në 2 raste ka pushuar akuzën, si dhe ka kërkuar pafajësi në 10 raste (për nenin 248).

- Konkluzion:

Krahasuar me vitin 2023, rezulton se nga të dhënat statistikore të Prokurorisë së Përgjithshme, konstatohet ulje e çështjeve të dërguara për gjykim me 46 çështje më pak, dhe ulje e numrit të personave të marrë të pandehur me 103 persona më pak, me tendencë uljeje prej dy vitesh.

Për vitin 2024 nuk konstatohet ashpërsim i politikës penale, pasi në krahasim me vitin 2023 rezulton se kemi vetëm 1 të pandehur më shumë për caktimin e masës së dënimit me burgim, lidhur me veprat penale në fushën e korrupsionit.

Gjithashtu, në Prokurorinë e Posaçme, lidhur me veprat penale në fushën e korrupsionit që i kanë kaluar për kompetencë lëndore, për vitin 2024 rezulton një rritje e numrit të përgjithshëm të çështjeve penale të regjistruara në fushën e korrupsionit prej 36 çështje më shumë dhe rritje e lehtë e çështjeve të dërguara për gjykim me 3 çështje më shumë, dhe me 1 person të pandehur të dërguar për gjykim më pak.

Referuar masave të sigurimit personal pranë Prokurorisë së Posaçme vihet re një rënie prej 8 masa sigurimi “arrest në burg” më pak se në vitin 2023, ulje e numrit të personave me arrest në shtëpi me 3 persona më pak se në vitin 2023 dhe 6 persona më shumë me masë sigurimi detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore, ulje e numrit të personave me masë sigurimit “ndalimi i daljes jashtë shtetit” me 1 person më pak. Po kështu rezulton që për vitin 2024 të jetë caktuar për 5 persona të pandehur masa e sigurimit “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”. Konstatohet se politika penale, në lidhje me masat e sigurimit për këtë kategori veprash nuk ka ndonjë ashpërsim për vitin 2024 por mbetet pothuajse në të njëjtat nivele me vitin 2023.

- Veprat penale në fushën e krimit të organizuar në kompetencë të SPAK-ut

- Viti 2023:

Lidhur me veprat penale në fushën e krimit të organizuar në kompetencë lëndore të Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nga të dhënat statistikore rezulton se, për vitin 2023 janë regjistruar 201 procedime penale në fushën e krimit të organizuar, ku vetëm 11 çështje janë dërguar për gjykim me një numër prej 109 persona të hetuar/pandehur.

Nga këto çështje, për 90 persona është caktuar masa e sigurimit “Arrest me burg”, për 3 persona është caktuar masa e sigurimit “Arrest në shtëpi”; 10 persona të pandehur hetuar me masë sigurimi “Detyrim për t’u paraqitur”, 5 persona të pandehur hetuar me masë sigurimi “Arrest në burg në mungesë”, 1 person i pandehur me “Detyrimi daljes jashtë shtetit”.

Për vitin 2023 nuk rezulton të ketë të dhëna statistikore më vete për veprat penale kundër krimit të organizuar për të cilat ka përfunduar gjykimi në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë dhe Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Konkretisht, për vitin 2023 rezulton se ka përfunduar gjykimi i themelit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për 75 çështje penale për veprat penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar me një numër prej 260 të pandehurish. Ndërsa për Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk ka të dhëna statistikore për çështje penale për të cilat ka përfunduar gjykimi.

Por rezulton se ka të dhëna statistikore lidhur me vendimet e dhëna, e konkretisht, për vitin 2023 nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë dhënë, gjithsej, 67 vendime dënimi me 233 persona të dënuar, nga të cilat 20 çështje penale me 59 persona kanë qenë për vepra penale në fushën e krimit të organizuar.

Në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për vitin 2023, janë dhënë, gjithsej, 57 vendime dënimi me 133 persona të dënuar, nga të cilat 22 çështje me 49 persona kanë qenë për vepra penale në fushën e krimit të organizuar.

- Viti 2024:

Lidhur me veprat penale në fushën e krimit të organizuar në kompetencë lëndore të Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nga të dhënat statistikore rezulton se,



për vitin 2024 janë regjistruar 245 procedime penale në fushën e krimit të organizuar, ku vetëm 21 çështje janë dërguar për gjykim me një numër prej 134 persona të hetuar/pandehur.

Nga këto çështje, për 108 persona është caktuar masa e sigurimit “Arrest me burg” nga të cilat 24 në mungesë, për 21 persona është caktuar masa e sigurimit “Arrest në shtëpi”; 5 persona të pandehur hetuar me masë sigurimi “Detyrim për t’u paraqitur”.

Për vitin 2024 nuk rezulton të ketë të dhëna statistikore për veprat penale kundër krimit të organizuar për të cilat ka përfunduar gjykimi në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë dhe Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Gjithashtu, nuk ka as të dhëna statistikore, lidhur me vendimet e dhëna për këto grupveprash penale nga Gjykatat e Posaçme.

- Konkluzion:

Rezulton se për vitin 2024, Prokuroria e Posaçme ka një rritje të numrit të procedimeve të regjistruara prej 44 procedimesh më shumë, rritje e çështjeve të dërguara për gjykim me 10 çështje më shumë dhe rritje të numrit të pandehurve në gjykim me 25 të pandehur më shumë se në vitin 2023.

Referuar masave të sigurimit personal, konstatohet një rritje prej 13 personash më shumë për të cilët është caktuar masa e sigurimit personal “Arrest në burg”, rritje me 18 persona më shumë për masën “arrest në shtëpi”, me ulje me 5 persona më pak për masën “detyrim paraqitje” dhe, gjithashtu, nuk ka asnjë masë sigurimi “Detyrimi daljes jashtë shtetit” për të cilën në vitin 2023 ka qenë 1 person me këtë masë. Pra, konstatohet se kemi ashpërsim të politikës penale dhe masave të sigurimit për këtë kategori veprash penale.

- Veprat penale të trafikimit (nenet 109, 109/“b”, 110/“a”, 128/“b”, 138/“a”, 141/“a”, 278/“a” dhe 282/“a” të Kodit Penal)

- Viti 2023:

Në lidhje me veprat penale të trafikimit, nga të dhënat statistikore të Prokurorisë së Përgjithshme, për vitin 2023, rezulton se janë 30 çështje të dërguara për gjykim me 41 të pandehur, nga të cilët 17 janë me masë sigurimi “Arrest në burg”. Ndërsa në përfundim të gjykimit kërkesa e prokurorisë ka qenë:

Dënimi minimal i parashikuar nga dispozita: 7 të pandehur.

Dënimi mesatar i parashikuar nga dispozita: 10 të pandehur.

Dënimi maksimal i parashikuar nga dispozita: 0 të pandehur.

Pezullimi i ekzekutimit (neni 59 i Kodit Penal): 6 të pandehur.

Për vitin 2023, nuk rezulton të jetë kërkuar në asnjë rast pushimi i çështjes, pushimi i akuzës dhe tërheqje e akteve.

- Viti 2024:

Në lidhje me veprat penale të trafikimit, nga të dhënat statistikore të Prokurorisë së Përgjithshme, për vitin 2024, rezulton se janë 33 çështje të dërguara për gjykim me 49 të pandehur, nga të cilët 34 janë me masë sigurimi “Arrest në burg”. Ndërsa në përfundim të gjykimit kërkesa e prokurorisë ka qenë:

Dënimi sa periudha e paraburgimit: 2 të pandehur.

Dënimi minimal i parashikuar nga dispozita: 7 të pandehur.

Dënimi mesatar i parashikuar nga dispozita: 15 të pandehur.

Dënimi maksimal i parashikuar nga dispozita: 0 të pandehur.

Pezullimi i ekzekutimit (neni 59 i Kodit Penal): 3 të pandehur.

Për vitin 2024, nuk rezulton të jetë kërkuar në asnjë rast pushimi i çështjes, pushimi i akuzës dhe tërheqje e akteve.

- Konkluzion:

Rezulton një rritje e lehtë e numrit të çështjeve të dërguara për gjykim në krahasim me vitin 2023, me 3 çështje më shumë dhe rritje e numrit të të pandehurve në gjykim me 8 persona më shumë. Për sa i përket masës së sigurimit “Arrest në burg”, rezulton një rritje prej 17 personash më shumë krahasuar me vitin 2023.

Për sa i përket ashpërsimit të dënimit për këtë kategori veprash, konstatohet se kemi rritje të kërkesave të prokurorit për dhënien e dënimit mesatar me 5 persona me shumë, një rritje për dhënien e dënimit sa periudha e paraburgimit me 2 persona më shumë dhe mbetemi në të njëjtat shifra me vitin 2023 për dënimin minimal dhe maksimal, si dhe kemi një ulje të kërkesës për pezullim ekzekutimi të dënimit me burgim për 3 persona më pak.



- Vepra penale e pastrimit të produkteve të veprës penale (neni 287 i Kodit Penal):

- Viti 2023

Në lidhje me këtë vepër penale, në vitin 2023, nga të dhënat statistikore të Prokurorisë së Përgjithshme rezultojnë se janë 11 çështje të dërguara për gjykim me 16 të pandehur, nga të cilët nuk ka asnjë me masë sigurimi “Arrest në burg”. Ndërsa në përfundim të gjyqimit kërkesa e prokurorisë ka qenë:

Dënimi minimal i parashikuar nga dispozita: Asnjë të pandehur.

Dënimi mesatar i parashikuar nga dispozita: 12 të pandehur.

Dënimi maksimal i parashikuar nga dispozita: Asnjë të pandehur.

Pezullimi i ekzekutimit (neni 59 i Kodit Penal): 1 të pandehur.

Ndërkohë rezultojnë se në asnjë rast nuk është kërkuar pushimi i çështjes, pushimi i akuzës dhe tërheqja e akteve.

- Viti 2024

Në lidhje me këtë vepër penale në vitin 2024, nga të dhënat statistikore të Prokurorisë së Përgjithshme rezultojnë se janë 13 çështje të dërguara për gjykim me 21 të pandehur, nga të cilët nuk ka asnjë me masë sigurimi “Arrest në burg”. Ndërsa në përfundim të gjyqimit kërkesa e prokurorisë ka qenë:

Dënimi minimal i parashikuar nga dispozita: Asnjë të pandehur.

Dënimi mesatar i parashikuar nga dispozita: 5 të pandehur.

Dënimi maksimal i parashikuar nga dispozita: 1 të pandehur.

Pezullimi i ekzekutimit (neni 59 i Kodit Penal): 7 të pandehur.

Ndërkohë rezultojnë se në asnjë rast nuk është kërkuar pushimi i çështjes, pushimi i akuzës dhe tërheqja e akteve.

- Konkluzion:

Për vitin 2024, rezultojnë një rritje e lehtë me 2 çështje më shumë dërguar për gjykim dhe 5 persona më shumë të marrë si të pandehur, si dhe nuk ka asnjë me masë sigurimi “Arrest në burg” njësoj si në vitin 2023.

Rezultojnë ulje e rasteve me 7 persona më pak për dënimin mesatar, rritje e lehtë me 1 person më shumë për dënimin maksimal, rritje me 6 persona më shumë për pezullimin e dënimit dhe mbetemi në të njëjtat shifra me asnjë rast të personave me dënim minimal dhe asnjë rast për

të cilën të jetë kërkuar pushimi i çështjes, pushimi i akuzës dhe tërheqja e akteve.

- Veprat penale në fushën e narkotikëve (nenet 283–286/“a” të Kodit Penal)

- Viti 2023:

Në vitin 2023, rezultojnë se nga ana e organit të Prokurorisë së Përgjithshme janë dërguar për gjykim 599 çështje me 904 të pandehur, nga të cilët vetëm 505 persona kanë qenë me masë sigurimi arrest në burg. Ndërsa në përfundim të gjyqimit kërkesa e prokurorisë për 1 të pandehur ka qenë për dënim me gjobë dhe 607 me burgim nga të cilët:

Dënimi sa periudha e paraburgimit: 5 të pandehur.

Dënimi minimal i parashikuar nga dispozita: 68 të pandehur.

Dënimi mesatar i parashikuar nga dispozita: 339 të pandehur.

Dënimi maksimal i parashikuar nga dispozita: 3 të pandehur.

Pezullim i ekzekutimit (neni 59 i Kodit Penal): 192 të pandehur.

Ndërkohë rezultojnë se për vitin 2023, është kërkuar për 1 rast tërheqja e akteve, për 8 raste pushimi i çështjes dhe në 2 raste është kërkuar pushimi i akuzës.

- Viti 2024:

Në vitin 2024, rezultojnë se nga ana e organit të Prokurorisë së Përgjithshme janë dërguar për gjykim 722 çështje me 1210 të pandehur, nga të cilët vetëm 731 persona kanë qenë me masë sigurimi arrest në burg. Ndërsa në përfundim të gjyqimit kërkesa e prokurorisë për 1 të pandehur ka qenë për dënim me gjobë dhe 893 me burgim nga të cilët:

Dënimi sa periudha e paraburgimit: 0 të pandehur.

Dënimi minimal i parashikuar nga dispozita: 94 të pandehur.

Dënimi mesatar i parashikuar nga dispozita: 493 të pandehur.

Dënimi maksimal i parashikuar nga dispozita: 16 të pandehur.

Pezullim i ekzekutimit (neni 59 i Kodit Penal): 290 të pandehur.

Ndërkohë rezultojnë se për vitin 2024, është kërkuar për 2 raste tërheqja e akteve, për 11 raste pushimi i çështjes, në 5 raste është kërkuar pushimi i akuzës dhe në 7 raste është kërkuar pafajësi.

**- Konkluzion:**

Rezultun një rritje e numrit të çështjeve të dërguara për gjykim me 123 çështje më shumë, rritje e numrit të të pandehurve me 306 persona më shumë dhe rritje e personave ndaj të cilëve është vendosur masa “arrest në burg” me 226 persona më shumë se në vitin 2023.

Për sa i përket ashpërsimit të dënimit për këtë kategori veprash, konstatohet se kemi rritje të kërkesave të prokurorit për dhënien e dënimit minimal me 26 persona më shumë, rritje për dhënien e dënimit mesatar me 154 persona më shumë, rritje të dënimit maksimal me 13 persona më shumë; rritje të pezullimit të ekzekutimit me 98 persona më shumë si dhe rezultun se nuk ka asnjë rast të dhënies së dënimit sa periudha e paraburgimit, me 5 persona më pak se në vitin 2023.

Gjithashtu, rezultun një rritje e lehtë e kërkesave për tërheqje aktesh 1 më tepër, të pushimit të çështjes me 3 më tepër, të pushimit të akuzës me 3 më tepër, si dhe kemi 7 kërkesa për pafajësi për vitin 2024.

- Veprat penale kundër të miturve (nenet 124, 124/“b”, 128/“b” dhe 129 të Kodit Penal)

- Viti 2023:

Në vitin 2023, rezultun se nga ana e organit të Prokurorisë së Përgjithshme janë dërguar për gjykim 28 çështje me 32 të pandehur, nga të cilët vetëm 4 persona kanë qenë me masë sigurimi “Arrest në burg”. Ndërsa në përfundim të gjykimit, në asnjë rast nuk është kërkuar dënimi me gjobë dhe për 24 persona të pandehur është kërkuar dënimi me burgim, nga të cilët:

Dënimi minimal i parashikuar nga dispozita: 5 të pandehur.

Dënimi mesatar i parashikuar nga dispozita: 9 të pandehur.

Dënimi maksimal i parashikuar nga dispozita: 1 i pandehur.

Pezullim i ekzekutimit (neni 59 i Kodit Penal): 9 të pandehur.

Në 2 raste prokurori ka kërkuar pushimin e çështjes.

- Viti 2024:

Në vitin 2024, rezultun se nga ana e organit të Prokurorisë së Përgjithshme janë dërguar për gjykim 27 çështje me 29 të pandehur, nga të cilët vetëm 8 persona kanë qenë me masë sigurimi “Arrest në burg”. Ndërsa në përfundim të gjykimit në 1 rast

është kërkuar dënimi me gjobë dhe për 24 persona të pandehur është kërkuar dënimi me burgim, nga të cilët:

Dënimi minimal i parashikuar nga dispozita: 4 të pandehur.

Dënimi mesatar i parashikuar nga dispozita: 8 të pandehur.

Dënimi maksimal i parashikuar nga dispozita: 0 të pandehur.

Pezullim i ekzekutimit (neni 59 i Kodit Penal): 12 të pandehur.

Në asnjë rast prokurori nuk ka kërkuar pushimin e çështjes, si dhe nuk asnjë rast të kërkesës për tërheqje aktesh, pushim akuze apo pafajësi.

- Konkluzion:

Në krahasim me vitin 2023, ka një ulje të lehtë të numrit të çështjeve të dërguara për gjykim me 1 çështje më pak, ulje të numrit të personave të marrë si të pandehur me 3 të pandehur më pak, por nga ana tjetër ka rritje me 4 të pandehur më shumë me masë sigurimi “Arrest në burg”.

Lidhur me ashpërsimin e politikës penale dhe kërkesave për dënim rezultun se jemi në të njëjtat shifra të dënimit me burgim si në vitin e kaluar, nga të cilat 1 kërkesë më pak konstatohet për dënimin minimal, 1 kërkesë më pak për dënimin mesatar, 1 kërkesë më pak për dënimin maksimal dhe 3 kërkesa më tepër për pezullimin e ekzekutimit të dënimit, si dhe kemi 1 kërkesë për dënimin me gjobë për të cilën nuk ka pasur në vitin 2023.

Gjithashtu, për vitin 2024 nuk kemi asnjë kërkesë ku prokurori të ketë kërkuar pushimin e çështjes, me ulje me 2 më pak se vitin e kaluar.

- Veprat penale kundër mjedisit (nenet 201–207/“ç” të Kodit Penal).

- Viti 2023:

Në lidhje me veprat penale kundër mjedisit në vitin 2023 rezultun se nga 60 çështje të dërguara për gjykim me 69 të pandehur, është caktuar vetëm për 2 të pandehur masa e sigurimit “Arrest në burg”.

Ndërsa në përfundim të gjykimit, kërkesa e prokurorisë ka qenë për 14 të pandehur dënim me gjobë dhe 35 të pandehur dënim me burgim, nga të cilët:

Dënimi me kohën e paraburgimit: asnjë i pandehur.

Dënimi minimal i parashikuar nga dispozita: 8 të pandehur.



Dënimi mesatar i parashikuar nga dispozita: 6 të pandehur.

Pezullim i ekzekutimit (neni 59 i Kodit Penal): 21 të pandehur.

Në asnjë rast nuk është kërkuar pushimi i çështjes, pushimi i akuzës, tërheqja e akteve apo pafajësi.

- Viti 2024:

Në lidhje me veprat penale kundër mjedisit në vitin 2024 rezultoi se nga 55 çështje të dërguara për gjykim me 78 të pandehur, është caktuar vetëm për 2 të pandehur masa e sigurimit “Arrest në burg”.

Ndërsa në përfundim të gjykimit, kërkesa e prokurorisë ka qenë për 19 të pandehur dënim me gjobë dhe 34 të pandehur dënim me burgim nga të cilët:

Dënimi me kohën e paraburgimit: asnjë i pandehur.

Dënimi minimal i parashikuar nga dispozita: 2 të pandehur.

Dënimi mesatar i parashikuar nga dispozita: 2 të pandehur.

Pezullim i ekzekutimit (neni 59 i Kodit Penal): 30 të pandehur.

Po kështu është kërkuar në 2 raste tërheqje aktesh, në 2 raste pushimi i akuzës dhe në 4 raste pushimi i çështjes dhe në asnjë rast nuk është kërkuar pafajësi.

- Konkluzion:

Në krahasim me vitin 2024, për veprat penale në fushën e mjedisit rezultoi ulje e numrit të çështjeve të dërguara për gjykim me 5 çështje më pak dhe rritje e numrit të pandehurve me 9 të pandehur më shumë, si dhe mbetimi në shifra të njëjta lidhur me caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”.

Për sa i përket ashpërsimit të dënimit për këtë kategori veprash rezultoi se jemi pothuaj në të njëjtat shifra të kërkesave për dënimin me burgim, vetëm me 1 të pandehur më pak për të cilën është kërkuar dënim me burgim, e konkretisht kemi 6 kërkesa më pak për dënimin minimal, 4 kërkesa më pak për dënimin mesatar dhe 9 kërkesa më tepër për pezullimin e ekzekutimit.

Ndërkohë njësoj si në vitin 2023 edhe për vitin 2024 nuk ka asnjë kërkesë për dënimin sa koha e paraburgimit, për dënimin maksimal, si

dhe kemi 2 kërkesa më shumë për tërheqje aktesh, 2 kërkesa më shumë për pushimin e akuzës dhe 4 kërkesa më shumë për pushimin e çështjes, si dhe në asnjë rast nuk është kërkuar pafajësi.

- Lidhur me veprat penale në fushën e taksave dhe tatimeve:

- Viti 2023:

Gjatë vitit 2023, për veprat penale, në lidhje me taksat dhe tatimet,³⁴ rezultoi se janë regjistruar 187 procedime penale me 55 të pandehur. Janë dërguar për gjykim 63 çështje penale me 156 të pandehur. Për veprën penale “Moskryerja e detyrave nga organet tatimore” të parashikuar nga neni 181/“a” të Kodit Penal, sikurse në vitin 2022 nuk rezultoi të jetë regjistruar ndonjë procedim penal. Ndërkohë për veprën penale “Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore” sipas nenit 175 i K. Penal, ku përfshihen nëpunësit publik të dyshuar të administratës doganore janë regjistruar 3 procedime penale, njësoj si në vitin 2022.

- Viti 2024:

Gjatë vitit 2024, për veprat penale, në lidhje me taksat dhe tatimet,³⁵ rezultoi se janë regjistruar 199 procedime penale me 22 të pandehur. Janë dërguar për gjykim 49 çështje penale me 66 të pandehur. Për veprën penale “Moskryerja e detyrave nga organet tatimore” të parashikuar nga neni 181/“a” të Kodit Penal, rezultoi të jetë regjistruar 1 procedim penal. Ndërkohë për veprën penale “Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore” sipas nenit 175 i K. Penal, ku përfshihen nëpunësit publik të dyshuar të administratës doganore janë regjistruar 2 procedime penale.

- Konkluzion:

Në vitin 2024, për veprat penale në fushën e taksave dhe tatimeve, rezultoi se kemi rritje të lehtë të procedimeve të regjistruara me 12 procedime më shumë ose me një rritje prej 6.4% të numrit të procedimeve të regjistruara krahasuar me vitin 2023, dhe me ulje të numrit të të pandehurve me 33 të pandehur më pak.

Gjithashtu, lidhur me çështjet e dërguara për gjykim rezultoi ulje me 14 çështje të dërguara për gjykim më pak ose me ulje prej 22.2% të numrit të procedimeve krahasuar me vitin 2023. Po kështu, krahasuar me vitin 2023, konstatohet ulje edhe e numrit të të pandehurve të dërguar

³⁴ Referuar neneve 180–182/“a”, të Kodit Penal.

³⁵ Referuar neneve 180–182/“a” të Kodit Penal.



për gjykim me 90 të pandehur më pak ose me ulje prej 57.7% të numrit të të pandehurve të dërguar për gjykim.

Aneks 3

ANALIZA MBI TË CILËN JANË BAZUAR REKOMANDIMET 2025

- Garantimi i pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit

Në radhë të parë, pavarësia e prokurorisë është një “gjendje shpirtërore” nga ana e prokurorit individual, që të marrë vendime në mënyrë racionale dhe të paanshme në bazë të ligjit dhe provave të disponueshme pa presion apo ndikim të jashtëm dhe pa frikë nga ndërhyrjet; dhe së dyti, pavarësia e prokurorisë duhet të mbështesë, gjithashtu, rregullimet institucionale dhe operacionale që shteti duhet të krijojë për t’u mundësuar prokurorëve të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre në mënyrë korrekte dhe të paanshme, përfshirë ndërhyrjet politike ose forma të tjera.

Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka marrë masat e duhura në adresim të secilës pikë të rekomandimeve prioritare, për ndjekjen dhe plotësimin e tyre, duke informuar, në lidhje me masat e ndërmarra për secilin rekomandim. Në lidhje me këtë rekomandim SPAK-u është shprehur se në vitin 2024 numri i prokurorëve të posaçëm ka ndryshuar pasi në Prokurorinë e Posaçme janë caktuar edhe 3 prokurorë, duke plotësuar organikën me 20 prokurorë të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, me vendimin nr. 6/2021, “Për përcaktimin e numrit të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme”.

Prokuroria e Posaçme ka vijuar bashkëpunimin ndërinstitucional me Prokurorinë e Përgjithshme, prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, policinë gjyqësore, policinë e shtetit dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit në funksion të zbatimit të ligjit për luftën kundër terrorizmit dhe krimin të organizuar, parandalimit dhe ndëshkimit të autorëve të veprave të tilla penale.

Gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme ka vijuar bashkëpunimin ndërkombëtar me autoritetet e huaja bazuar në Konventat e Këshillit të Evropës

dhe Konventat e Kombeve të Bashkuara, si dhe në marrëveshje dypalëshe ku Republika e Shqipërisë është palë.

Në lidhje me rekomandimin për garantimin e pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit, nga të dhënat e përcjella nga organi i prokurorisë³⁶, lidhur me zbatimin e rekomandimeve prioritare të dhëna për vitin 2024 në ushtrim të kompetencave kushtetuese e ligjore, Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë një sërë udhëzimesh për zbatim nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm dhe konkretisht:

Me udhëzimin e përgjithshëm nr. 5/2024, datë 16.5.2024, “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024, në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, me qëllim orientimin e politikave institucionale për ndjekjen e unifikuar të rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit nëpërmjet masave administrative dhe procedurale të përcaktuara.

Në vijim të këtij udhëzimi, është miratuar urdhri nr. 53, datë 16.5.2024, “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024”, në të cilin janë normuar masa për rritjen e rolit aktiv të drejtuesit të prokurorisë, drejtuesit të seksionit dhe prokurorit, në funksion të shtimit të rasteve të hetimeve të filluara kryesisht për veprat penale prioritare të rekomanduara. Kryerja e hetimeve proaktive efektive dhe/ose me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit, ka qenë në vijimësi udhëzim për rritjen e mëtejshme të efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit për veprat penale prioritare të rekomanduara.

Këto akte u janë përcjellë për njohje prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe me shkresat nr. 599/7 prot., datë 4.10.2024 dhe nr. 622 prot., datë 7.1.2025, është kërkuar informacion për ecurinë e zbatimit të tyre. Gjithashtu, drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe apeleve kanë nxjerrë udhëzimet përkatëse për zbatimin e këtyre akteve.

Në zbatim të udhëzimit nr. 5/2024, datë 16.5.2024, prokurorët kanë rritur rolin aktiv në hetimin paraprak, në kryerjen e hetimeve proaktive efektive dhe/ose me përdorim të mjeteve të posaçme/speciale të hetimit në funksion të rritjes së

³⁶ Me shkresën me nr. 622/22 prot., datë 30.12.2024, protokolluar me nr. 5456/2 prot., datë 31.12.2024, dhe me

shkresën me nr. 622/54 prot., datë 17.3.2025, protokolluar me nr. 1021/2 prot., datë 17.3.2025.



hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë. Në përgjigjen e saj, Prokuroria e Përgjithshme konfirmon se, pavarësisht rritjes së numrit të hetimeve kryesisht, sërish nuk është në nivelin duhur, ku një nga arsyet kryesore vijon të mbetet mbingarkesa e cila kufizon prokurorët në ushtrimin e këtij diskrecioni ligjor.

Evidentohet se në vitin 2024 janë filluar kryesisht 155³⁷ procedime penale ose me rritje 12.32% të numrit të procedimeve të filluara kryesisht krahasuar me vitin 2023. Peshën më të madhe në këto raste e përbëjnë veprat penale të parashikuara në kreun VIII, seksionin “*Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publikë*” e të cilat rezultojnë në masën 28,39%, seksionin II, “*Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik*”, 12,26% e totalit, të gjitha për veprën penale të shpërdorimit të detyrës (19 procedime penale); 32,26% e procedimeve janë regjistruar për vepra penale të parashikuara në kreun III, “*Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike*” dhe 6,45% për vepra penale të parashikuara në kreun II, “*Vepra penale kundër personit*”.

Prokurorët në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm për vitin 2024 kanë kryer hetime proaktive dhe ose/me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit në kuadrin e 405³⁸ procedimeve penale, duke shënuar kështu një ulje prej 109 procedimesh penale në krahasim me vitin 2023, dhe me një ulje prej 168 procedimesh më pak në krahasim me vitin 2022, ku konstatohet një tendencë uljeje në dy vitet e fundit. Ky proces është finalizuar me arrestimin në flagrancë/ndalimin e 354³⁹ personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale në kompetencë të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, ku sërish krahasuar me vitin 2023 ka ulje prej 120 personash të arrestuar në flagrancë/ndaluar.

Për vitin 2024, në vijim të bashkëpunimit me SPAK-un prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kanë transferuar 67⁴⁰ procedime/referime ose një më pak se numri i referimeve të pranuar krahasuar

me vitin 2023, nga të cilat janë pranuar 61⁴¹ procedime/referime ose 91,04% e procedimeve të transferuara në kompetencë lëndore të asaj prokurorie.

Në përgjigjen e Prokurorisë së Përgjithshme është ritheksuar sërish roli i Prokurorit të Përgjithshëm në krijimin e politikave institucionale penale, mbrojtjen e garantimin e paanshmërisë së prokurorit dhe mundësimin e trajnimeve për paanësinë, integritetin dhe mbi parimet e etikës së prokurorit.

Përmendet sërish zbatimi i udhëzimit nr. 12, datë 20.7.2020, “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm*”, i ndryshuar, udhëzimit nr. 3/2016, datë 29.12.2016, “*Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori*”, i ndryshuar, dhe udhëzimet përkatëse për zbatimin e rekomandimeve vjetore, të cilat monitorohen nëpërmjet kërkesave për informacion, paraqitjes së raporteve vjetore mbi ecurinë e punës në secilën prokurori të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe pjesëmarrjes së prokurorit të përgjithshëm në analizat vjetore të punës së prokurorive. Gjithashtu, është vlerësuar me rigorozitet çdo informacion i marrë nga burime ligjore (ankesa qytetarësh, vendime gjyqësore, raporte nga institucione apo organizata të shoqërisë civile), që ngre problematika në veprimtarinë e prokurorisë apo prokurorëve.

Në kuadrin e forcimit të mekanizmit të kontrollit dhe llogaridhënies në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimit ndër-institucional me Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, edhe për vitin 2024, i ka ripropozuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dy inspektime tematike me objekt: i. respektimi i të drejtave të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, viktimave të krimeve seksuale dhe të dhunës në familje; ii. zbatimi i masës së shmangies nga ndjekja penale, zbatimi i masave të sigurimit dhe dënimit për të mitur, çështje për të cilat prokurori i përgjithshëm ka miratuar disa akte nënligjore (udhëzime të përgjithshme: udhëzimi nr. 5/2018; udhëzimi nr. 17/2020; udhëzimi nr.

³⁷ Për vitin 2023 rezulton që janë filluar kryesisht 138 procedime penale, pra 17 procedime më shumë për vitin 2024.

³⁸ Për vitin 2023 rezulton që numri i hetimeve proaktive me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit ka qenë 514 procedime penale, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 573 procedime penale.

Faqe | 8000

³⁹ Për vitin 2023 kanë qenë arrestuar në flagrancë 474 persona.

⁴⁰ Për vitin 2023 janë transferuar 68 procedime në Prokurorinë e Posaçme.

⁴¹ Për vitin 2023 janë pranuar nga Prokuroria e Posaçme 44 procedime/referime.



8/2021; dhe urdhra administrativë: urdhri nr. 124/2020; urdhri nr. 87/2021). Gjithashtu, mbi bazën e një ankese ndaj një prokurori, pas shqyrtimit në Prokurorinë e Përgjithshme, i është përcjellë për shqyrtim dhe vlerësim Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Po në funksion të garantimit të pavarësisë por dhe kontrollit, llogaridhënies dhe mirëfunksionimit në sistemin e prokurorisë, në datën 12 nëntor 2024, Sektori i Monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme, në bashkëpunim me përfaqësues nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, kryen verifikime lidhur me veprimtarinë e punës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, ku dolën me sugjerimet përkatëse.

Një vend të rëndësishëm në garantimin e efektivitetit të sistemit dhe përgjegjësisë së prokurorëve zë ngarkesa e punës. Në datën 27.7.2024, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka bërë shpërndarjen e 23 magjistratëve të sapoemëruar, por përsëri mbetet i lartë numri i vakancave, pasi mungon 34,58% e numrit organik të prokurorëve, kjo për shkak të mbarimit të statusit, pezullimit nga procesi i rivlerësimit ose komandimit në institucione të tjera, në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, një prokuror mban ngarkesën e 1,5 prokurorëve.

Për Prokurorin e Përgjithshëm, vijon të mbetet prioritet marrja e masave për të ulur efektin negativ të mbingarkesës disanjeçare të punës, nëpërmjet caktimit të burimeve njerëzore në ndihmë të prokurorëve (oficerë të policisë gjyqësore e sekretarë), mbështetja me aksesin në bazat e të dhënave dhe udhëzime e manuale për hetimin e veprave të caktuara penale.

Konkretisht me urdhrat nr. 18, datë 30.1.2024, “Për caktimin e strukturës faktike në Prokurorinë e Përgjithshme”; nr. 19, datë 30.1.2024, “Për caktimin e strukturave të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe apelit të juridiksionit të përgjithshëm”; nr. 32, datë 13.3.2024, “Për shtimin e një pozicioni pune kancelar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë”; nr. 61, datë 13.6.2024, “Për shtimin e 2 prokurorëve në organikën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”, të Prokurorit të Përgjithshëm, janë caktuar strukturat organike të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Përgjithshme.

Në kuadër të rekomandimit për marrjen e masave për rritjen e kontrollit nga prokurori të punës së oficerëve të Policisë Gjyqësore, krahas masave administrative dhe procedurale për nxitjen e rolit aktiv të prokurorëve dhe drejtuesve për ushtrimin e kontrollit efektiv të prokurorit ndaj oficerëve të policisë gjyqësore, Prokuroria e Përgjithshme ka konsideruar të rëndësishëm ushtrimin e kontrollit efektiv në veprimtarinë e oficerëve të policisë gjyqësore në seksione nga strukturat e monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme.

Për vitin 2024, i është kërkuar Komisionit të Policisë Gjyqësore fillimi i procedimit ndaj 2 oficerëve të policisë gjyqësore; 1 oficeri të policisë gjyqësore për shkeljet disiplinore të parashikuara në nenin 33, pika 2, shkronjat “a” dhe “c”, të ligjit nr. 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, i ndryshuar, dhe 1 oficeri të policisë gjyqësore për shkeljen disiplinore të parashikuar në nenin 33, pika 2, shkronja “d”, e ligjit nr. 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, i ndryshuar.

Gjatë vitit 2024, Sektori i Monitorimit, në Prokurorinë e Përgjithshme, në zbatim të udhëzimit nr. 10/2021, “Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore”, i ndryshuar, ka vijuar monitorimin dhe ka kryer inspektim tematik për saktësinë në hedhjen e të dhënave në sistemin SVHOPGJP në veprimtarinë e oficerëve të seksionit të policisë gjyqësore në prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Lezhë dhe Durrës. Në përfundim të këtij procesi, Prokurori i Përgjithshëm ka përcjellë qarkoren nr. 505/2 prot., datë 26.7.2024, nëpërmjet të cilës është kërkuar rritja e rolit të drejtuesit të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm.

Për vitin 2024, Komisioni i Policisë Gjyqësore, mbi bazën e kërkesave të subjekteve të parashikuara nga neni 35, i ligjit nr. 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, ka vendosur fillimin e procedimit disiplinor ndaj 8 oficerëve të policisë gjyqësore dhe ka pasur në shqyrtim gjatë këtij viti 5 procedime disiplinore të mbartura nga viti 2023. Komisioni ka përfunduar shqyrtimin e procedimit disiplinor për 11 raste, nga të cilat: në 3 procedime disiplinore ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore është dhënë masa disiplinore



“vërejtje me paralajmërim”; në 2 procedime disiplinore ndaj oficerëve të Policisë Gjyqësore është dhënë masa disiplinore *“peçullim nga detyra 6 muaj”*; në 2 procedime disiplinore ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore është dhënë masa disiplinore *“ulje në detyrë për 3 muaj”*; 1 procedim disiplinor është pushuar për shkak se oficeri i Policisë Gjyqësore ishte larguar më parë nga detyra me dëshirën e tij dhe në 3 raste është pushuar procedimi disiplinor për shkak se nuk kanë rezultuar shkelje disiplinore të parashikuara nga ligji nr. 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”. Nga 11 procedimet disiplinore të shqyrtuara, 8 oficerë të policisë gjyqësore të proceduar disiplinorisht i përkasin shërbimeve të policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit, kurse 3 oficerë të policisë gjyqësore të proceduar disiplinorisht i përkasin seksioneve të prokurorisë.

Për forcimin e kapaciteteve profesionale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, në funksion të eficiencës dhe efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit, Prokuroria e Përgjithshme ka bashkëpunuar me Shkollën e Magjistraturës dhe me misionet/projektet ndërkombëtare që asistojnë sistemin e drejtësisë penale, dhe është bashkërenduar me Komisionin e Policisë Gjyqësore për forcimin e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe policisë gjyqësore të seksioneve, nëpërmjet realizimit të trajnimeve, përfshirë edhe aktivitete të përbashkëta trajnimi me prokurorët dhe agjencitë ligjzbatuese. Në kuadrin e trajnimit vazhdues, gjatë vitit 2024, në Shkollën e Magjistraturës janë zhvilluar 119 tema në fusha të ndryshme, të përzgjedhura në përputhje me nevojat dhe profilizimin në seksione sipas ligjit. Këto tema janë ndjekur nga 1063 prokurorë dhe 520 oficerë të policisë gjyqësore, ku një prokuror ose një oficer i policisë gjyqësore kanë marrë pjesë në më shumë se një trajnim.

Në kuadrin e disa projekteve dhe aktiviteteve rajonale dhe evropiane, përgjatë vitit 2024 janë përfshirë në trajnime, seminare, *workshope*, tryeza të rrumbullakëta, 142 prokurorë të prokurorisë të juridiksionit të përgjithshëm dhe 34 oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve në prokurori, për rritjen e kapaciteteve profesionale në fusha prioritare, siç janë krimi kibernetik, veprat penale në fushën zgjedhore, veprat penale në fushën mjedisore, dhuna me bazë gjinore, trafikimi i personave mbrojtja e dëshmitarëve, hetimet financiare dhe rikuperimi i aseteve, krimi i

organizuar dhe korrupsioni, armët e zjarrit, dhuna në familje, efikasiteti i drejtësisë, etj. Këto aktivitete janë organizuar nga OSBE-ja, UNODC-ja, EUROJUST-i, KiE, WBCJ-ja, GIZ-i, CEPEJ, TAIEX, SEESAC-i, Ambasada Britanike, Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulta, Grupit Lokal të Koordinimit për zbatimin e Udhërrëfyesit Rajonal për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta në Ballkanin Perëndimor, *Terre des Hommes*, Shoqata Ornitologjike e Shqipërisë, Qendra për Nisma Ligjore, Platforma Rajonale për Ballkanin Perëndimor, etj.

Lidhur me trajnimin e oficerëve të policisë gjyqësore për periudhën raportuese, Komisioni i Policisë Gjyqësore ka bashkërenduar punën me Shkollën e Magjistraturës për përfshirjen në programin e trajnimit vazhdues të kësaj shkolle të oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve të prokurorisë. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve të prokurorisë kanë marrë pjesë dhe kanë ndjekur programin e trajnimeve vazhduese të Shkollës së Magjistraturës, në veçanti lidhur me viktimat e krimit dhe drejtësinë për të mitur.

Prokuroria e Përgjithshme e konsideron me rëndësi të veçantë ngritjen dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve për rritjen e efektivitetit të punës. Sistemi i ri i Menaxhimit të Çështjeve do të mbështetet nga Bashkimi Evropian. Për këtë qëllim, Prokurori i Përgjithshëm, me urdhrin nr. 4, datë 4.1.2024, ka ngritur grupin e punës me ekspertë prokurorë nga të gjithë nivelet e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm, të cilët zhvilluan dy vizita studimore të frytshme në zyra prokurorie në Itali dhe Kosovë, për shkak të ngjashmërisë së legjislacionit procedural penal, dhe e dyta për shkak se ka zhvilluar një sistem të ri bashkëkohor të menaxhimit të çështjeve. Në muajin tetor 2024, është nënshkruar marrëveshja midis BE-së dhe UNOPS-së për implementimin e sistemit CAMS dhe komponentëve të tjerë që lidhen me këtë sistem, dhe janë zhvilluar disa takime me përfaqësues të UNOPS-së dhe grupit të punës, ku në datën 5.11.2024, u prezantuan fazat dhe afatet e projektit.

Për sa i përket bashkëpunimit me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, edhe gjatë vitit 2024 është vijuar me hartimin e udhërrëfyesit për ngritjen e sistemeve elektronike të sistemit të drejtësisë. Grupi



ndërinstitucional i punës ka zhvilluar takime periodike mujore për këtë qëllim dhe pritjet finalizimi, dhe miratimi i tij brenda vitit 2025.

Lidhur me kërkesën për shpërndarjen elektronike të çështjeve, është paraqitur një përshtkrim i përdorimit të sistemit CAMS, me anë të të cilit realizohet ndarja e rastësishme e çështjeve në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në zbatim të udhëzimit nr. 3/2016, datë 29.12.2016, “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori”, i ndryshuar, dhe nëpërmjet këtij procesi prokuroria siguron transparencë në shpërndarjen e çështjeve dhe garantim të pavarësisë e paanshmërisë së prokurorëve në ushtrimin e funksioneve.

- Lufta kundër korrupsionit

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit, i publikuar në mars 2024⁴², vëllimi 2- “Pastrimi i parave dhe krimet financiare” 46, ndër të tjera, përmend se: *Qeveria e Shqipërisë ka bërë përparim në përmirësimin e regjimit të saj kundër pastrimit të parave/ dhe financimit të terrorizmit (AML/CFT). Shqipëria mbetet e cenueshme ndaj pastrimit të parave për shkak të korrupsionit, krimit të organizuar, boshllëqeve në kuadrin ligjor dhe rregullator AML/CFT, si dhe pengesave në komunikimin ndër-agjencish. Reformat gjyqësore të vazhdueshme kanë përmirësuar regjimin AML/CFT të Shqipërisë. Agjencitë e zbatimit të ligjit po përdorin ligjin e sekuestrimit antimafia për të konfiskuar pasuritë që lidhen me trafikun e drogës dhe korrupsionin. Sfidat e kapacitetit, duke përfshirë trajnime dhe teknologji të pamjaftueshme dhe mungesën e bashkëpunimit mes agjencive të zbatimit të ligjit dhe organeve mbikëqyrëse, pengojnë përparimin. Megjithatë, një rritje në numrin e grupeve të përbashkëta hetimore midis SPAK-ut dhe agjencive të tjera ndërkombëtare të prokurorisë dhe zbatimit të ligjit po përmirëson bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet kriminale transnacionale. Shqipëria ka ndërmarrë hapa pozitivë, në lidhje me pronësinë përfitimprurëse, mbikëqyrjen e institucioneve financiare dhe ndihmën ligjore të ndërsjellë. Shqipëria duhet të rrisë hetimet dhe ndjekjen penale për pastrimin e parave për të luftuar korrupsionin, krimin e organizuar dhe trafikimin e drogës; të përmirësojë bashkëpunimin ndërinstitucional; dhe të integrojë plotësisht SPAK-un në përpjekjet kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Pavarësisht hetimeve të shumta për*

pastrim parash, ndjekjet penale mbeten të ulëta. Shqipëria duhet të zbatojë ligjet ekzistuese, të ndjekë udhëzimet rregullatore, të kryejë mbikëqyrje efektive, të përmirësojë bashkëpunimin në zbatimin e ligjit dhe të zgjerojë kapacitetin e policisë dhe prokurorëve për t'u fokusuar te korrupsioni, pastrimi i parave dhe krimet ekonomike. Shqipëria duhet të zbatojë plotësisht reformat e Kodit Penal të bëra në vitet 2016 dhe 2017.

Progresi raporti për Shqipërinë 2024⁴³ për luftën kundër korrupsionit konstaton se: *Shqipëria ndodhet mes një niveli të caktuar përgatitjeje dhe një niveli të modernuar përgatitjeje, dhe ka treguar disa përparime. Zbatimi i vazhdueshëm i procesit të vetting-ut ka pasur një ndikim pozitiv në luftën kundër korrupsionit në sistemin gjyqësor. Përfundimi i vetting-ut për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët është i afërt në shkallën e parë, me 794 raste të përfunduara nga 805 (98% e totalit). Një rezultat tjetër i drejtpërdrejtë i vetting-ut u regjistrua në shtator 2024, kur KPK-ja (Komisioni i Pavarur i Kualifikimit) i referoi 19 raste vetting-u me elemente të dukshme kriminale prokurorisë për hetime të mëtejshme, duke ndjekur kështu një rekomandim kyç nga BE-ja.*

SPAK-u, i përbërë nga Prokuroria e Posaçme, Byroja Kombëtare e Hetimit dhe gjykatat kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (gjykatat e posaçme të shkallës së parë dhe apelit), ka vazhduar të japë rezultate pozitive në hetimin, ndjekjen penale dhe dënimet në raste korrupsioni në nivele të larta, përfshirë ato që lidhen me politikanë dhe zyrtarë të lartë, si dhe raste që përfshijnë mbrojtjen e interesave financiarë të BE-së. Kapaciteti i SPAK-ut për hetimet financiare është rritur dhe përdorimi sistematik i hetimeve financiare dhe konfiskimeve të pasurive është përmirësuar. Megjithatë, numri i referimeve në SPAK nga autoritetet e tjera ka rënë. Organet e tjera të ngarkuara me luftën kundër korrupsionit, veçanërisht Prokuroria e Përgjithshme dhe Policia e Shtetit, ende përballen me sfida në zbulimin dhe hetimin efektiv të korrupsionit. Në përgjithësi, korrupsioni mbetet një shqetësim serioz dhe përpjekjet parandaluese kanë pasur një ndikim të kufizuar.

Perceptimi i publikut, ekspertëve dhe bizneseve është se ekziston një nivel i lartë korrupsioni në sektorin publik. Ky perceptim ka mbetur relativisht i qëndrueshëm vitet e fundit. Vlerësime të synuara të rrezikut dhe masa të dedikuara janë të nevojshme për të adresuar korrupsionin në sektorët më të ndjeshëm, përfshirë policinë, doganat, menaxhimin e tokës dhe

⁴² 2024 International Narcotics Control Strategy Report, Volume 2 Money Laundering and financial crimes, publikuar në mars 2024, në faqen zyrtare: <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2025/01/2024-INCSR-Vol-2-Money-Laundering.pdf>

⁴³ Albania 2024 Report, Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2024 Communication on EU Enlargement Policy.



pronave, Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe prokurimet publike. Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan pjesërisht dhe mbeten kryesisht të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti: të forcojë hetimin, ndjekjen penale, gjykimin dhe dënimin përfundimtar të rasteve të korrupsionit, veçanërisht në nivel të lartë, duke përfshirë konfiskimin përfundimtar të pasurive kriminale që rezultojnë nga veprat penale të lidhura me korrupsionin, dhe të risë referimet proaktive nga institucionet shtetërore dhe agjencitë e zbatimit të ligjit të SPAK-ut; të miratojë dhe të zbatojë në mënyrë efektive strategjinë kundër korrupsionit dhe planet shoqëruese të veprimit, duke përfshirë vlerësime të plota të rreziqut për sektorët e ndjeshëm, të zbatojë në mënyrë efektive planet e integritetit në ato autoritete shtetërore më të prirura ndaj korrupsionit, si Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe të adresojë plotësisht rekomandimet e Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit të Këshillit të Evropës (GRECO); të bëjë më efikase kontrollin e deklarimeve të pasurisë duke rishikuar kushtet administrative të mandatit të ILDKPKI-së dhe duke siguruar që të gjitha deklaratat e pasurisë të publikohen online.

Sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International për vitin 2024⁴⁴, Shqipëria ka pësuar rënie për sa i përket korrupsionit në nivele të larta, duke u rankuar në vendin e 80 nga vendi 98 që ishte në vitin 2023 dhe me pesë pikë më shumë me 42 pikë nga 37 pikë që kishte në vitin 2023.

Lidhur me problemin e korrupsionit të sistemit gjyqësor, ai vazhdon të perceptohet se është i lartë. **Sipas dokumentit “Indeksi i sundimit të ligjit 2024 i World Justice Project⁴⁵”, i cili paraqet një pasqyrë të sundimit të ligjit në 140 vende, duke dhënë rezultatet dhe renditjen sipas vlerësimit nga 0 në 1, Shqipëria renditet në vendin e 89-ë nga 140 vende. Në lidhje me vlerësimin sipas secilit faktor, për faktorin sistemi i drejtësisë penale, si një aspekt thelbësor për sundimin e ligjit, i cili përfshin të gjithë sistemin penal, Shqipëria është renditur në vendin e 89-ë në listë. Në lidhje**

me faktorin e dytë të vlerësimit – matja e mungesës së korrupsionit, Shqipëria renditet në vendin e 107-të.

- Nga Prokuroria e Përgjithshme rezultojnë se:

Lidhur me veprat penale në fushën e korrupsionit të cilat janë aktualisht në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Përgjithshme, rezultojnë se për shkak të ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale, ka ndryshuar numri i veprave penale në kompetencën lëndore të kësaj prokurorie.

Gjatë vitit 2024, janë hetuar 2030 çështje penale për veprat penale në fushën e korrupsionit⁴⁶, me një numër total prej 252 personash nën hetim dhe janë marrë të pandehur 260 persona.

Rezultojnë se ka një rritje të numrit të hetimeve për veprat penale të korrupsionit në krahasim me vitin 2023, me 49 çështje më shumë, rritje të numrit të personave nën hetim me 29 persona më shumë nën hetim dhe me ulje 76 persona më pak të marrë si të pandehur, krahasuar me të dhënat e vitit të kaluar⁴⁷.

Por pavarësisht kësaj, rastet që dërgohen për gjykim mbeten përsëri të ulëta krahasuar me numrin total prej 2030 çështjesh të regjistruara në fushën e korrupsionit pasi për vitin 2024 janë dërguar për gjykim vetëm 158 procedime penale ose rreth 7.8% të çështjeve të hetuara, me 235 të pandehur. Konkretisht për vitin 2024 konstatohet një ulje e numrit të çështjeve të dërguara për gjykim me 46 çështje më pak dhe 103 të pandehur më pak.

Për vitin 2024, ka përfunduar gjykimi për 43 çështje penale për veprat penale kundër korrupsionit me një numër prej 101 të pandehurish, nga të cilët janë dënuar 193 persona, pra krahasuar me vitin 2023⁴⁸ rezultojnë se ka një rritje të lehtë me 3 çështje më tepër, një rritje e numrit me 20 persona të pandehur më shumë dhe 7 të dënuar më shumë.

Në vitin 2024, numri i përgjithshëm i veprave penale të referuara dhe kallëzuara është 39535⁴⁹, nga

⁴⁴ Publikuar në faqen zyrtare të Transparency International: <https://www.transparency.org/en/cpi/2024>.

⁴⁵ World Justice project “Indeksi i sundimit të ligjit 2024, raport vjetor, përgatitur nga një grup ekspertësh vendas dhe të huaj, ka paraqitur të dhënat e administruara nga perspektiva e publikut të zakonshëm, në lidhje me zbatimin e ligjit. Publikuar në faqen web: <https://worldjusticeproject.org/rule-of-law-index/country/2024/Albania/>.

⁴⁶ Bazuar në 8 veprat penale në fushën e korrupsionit që kishin mbetur në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme (nenet 164/“a”, 164/“b”, 248, 256 dhe Faqe| 8004

257/“a”, 244/1; 245/1-1; 245/1-3 dhe 259/1 të Kodit Penal).

⁴⁷ Për vitin 2023 janë hetuar 1981 çështje penale për veprat penale në fushën e korrupsionit, me një numër total prej 223 personash nën hetim dhe janë marrë të pandehur 336 persona.

⁴⁸ Në vitin 2023 për 8 veprat penale të mbetura në kompetencë të Prokurorisë së Përgjithshme kishin përfunduar gjykimin 40 çështje penale me 91 të pandehur, nga të cilët janë dënuar 186 persona.

⁴⁹ Për vitin 2023 numri i veprave penale të referuara dhe të kallëzuara ishte në total 38613.



të cilat vetëm 155⁵⁰ janë vepra penale të filluara kryesisht nga prokurori ose rreth 0,39% e numrit të përgjithshëm.

Rezulton se ka rritje të numrit të përgjithshëm të çështjeve penale të referuara dhe kallëzuara me 17 çështje më shumë se në vitin 2023 dhe rritje të numrit të çështjeve të regjistruara kryesisht me 17 çështje më shumë.

Nga 155 çështje penale të filluara kryesisht nga prokurori, vetëm 20 janë të filluara kryesisht për veprat penale në fushën e korrupsionit⁵¹ ose rreth 12,9% e numrit të çështjeve kryesisht, ku numrin më të madh e zënë çështjet e regjistruara për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, me 19 çështje.

Gjithashtu, rezulton edhe 1 çështje e regjistruar kryesisht për veprën penale të parashikuar nga neni 244/1 të Kodit Penal.

Nëse i krahasojmë me vitin 2023 për të njëjtat vepra penale në fushën e korrupsionit, rezulton një rritje e lehtë e numrit të çështjeve të filluara kryesisht në fushën e korrupsionit, me 2 çështje më shumë⁵².

Ndërsa, në total **numri i çështjeve të regjistruara (kryesisht dhe me referim)** për veprat penale të pastrimit të parave⁵³ është 251 çështje, me një numër total prej 7 personash nën hetim nga të cilët 7 prej tyre janë marrë si të pandehur. Krahasuar me të dhënat për vitin 2023⁵⁴, rezulton se ka një rritje të ndjeshme prej 93 çështjesh të regjistruara më shumë, ulje e numrit të personave nën hetim me 4 më pak dhe një rritje e lehtë të numrit të të pandehurve me 3 të pandehur më shumë.

Lidhur me betimet proaktive në veprat e korrupsionit, sikundër u evidentua në vitin 2024 për grupveprat penale në fushën e korrupsionit prokurorët kanë filluar kryesisht 155⁵⁵ procedime penale ose me rritje 12,32% të numrit të procedimeve të filluara kryesisht krahasuar me vitin 2023. Peshën më të madhe në këto raste e përbëjnë veprat penale të parashikuara në kreun VIII, seksionin “Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike” të cilat rezultojnë në

masën 28,39%, seksionin II, “Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik”, 12,26% e totalit, të gjitha për veprën penale të shpërdorimit të detyrës (19 procedime penale); 32,26% e procedimeve janë regjistruar për vepra penale të parashikuara në kreun III, “Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike” dhe 6,45% për vepra penale të parashikuara në kreun II, “Vepra penale kundër personit”. Në vijim të bashkëpunimit me SPAK-un, prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kanë transferuar 67⁵⁶ procedime/referime ose një më pak se numri i referimeve të pranuar krahasuar me vitin 2023, nga të cilat janë pranuar 61⁵⁷ procedime/referime, ose 91,04% e procedimeve të transferuara në kompetencë lëndore të asaj prokurorie.

Në përgjigjen e Prokurorisë së Përgjithshme, sërish është theksuar kompetenca lëndore për veprat penale në fushën e korrupsionit referuar neni 75/“a” i Kodit të Procedurës Penale, ku pjesa më e madhe e veprave penale janë në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Posaçme. Gjithashtu, është përmendur vijimi i zbatimit të Aktit të Koordinimit Institucional, datë 15.12.2020, “Për rritjen e eficientës nëpërmjet bashkërendimit të Prokurorisë së Përgjithshme me Prokurorinë e Posaçme dhe unifikimin e disa veprimtarive administrative dhe procedurale ndër-institucionale, duke respektuar veçoritë dhe kompetencat institucionale të parashikuara në ligj”, mes Prokurorisë së Përgjithshme me Prokurorinë e Posaçme.

Për vitin 2024, janë regjistruar 39 procedime penale për vepra që lidhen me korrupsionin ose vepra penale që lidhen me detyrën, që zënë 63,93% të numrit të referimeve/procedimeve penale të transferuara dhe të pranuar për kompetencë në Prokurorinë e Posaçme për këtë periudhë.

Po ashtu, ka vijuar zbatimi i marrëveshjeve dypalëshe të vitit 2020 ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme me: Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe Inspektoratin e Lartë të Kontrollit të Pasurive dhe

⁵⁰ Në vitin 2023 kanë qenë 138 çështje të filluara kryesisht.

⁵¹ Krahasimi është bërë për 8 veprat penale (nenet 164/“a”, 164/“b”, 248, 256 dhe 257/“a”, 244/1; 254/1; 254/3 dhe 259/1 të Kodit Penal).

⁵² Në vitin 2023 kanë qenë 18 çështje të filluara kryesisht në fushën e korrupsionit.

⁵³ Nenet 287, 287/“a” dhe 287/“b” të Kodit Penal

⁵⁴ Në vitin 2023 për këto tre vepra penale janë regjistruar 158 çështje me 11 persona nën hetim dhe 4 të pandehur.

⁵⁵ Për vitin 2023 rezulton që janë filluar kryesisht 138 procedime penale.

⁵⁶ Për vitin 2023 janë transferuar 68 procedime në Prokurorinë e Posaçme.

⁵⁷ Për vitin 2023 janë pranuar nga Prokuroria e Posaçme 44 procedime/referime.



Konfliktit të Interesave, me synim rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me krimin ekonomik, shpërdorimin e fondeve publike, ushtrimin e veprimtarisë shtetërore në kundërshtim me ligjin.

Për vitin 2024 është rritur roli aktiv i prokurorëve për veprat penale të korrupsionit dhe që lidhen me detyrën, duke filluar kryesisht 19 procedime penale, nga 18 procedime penale të filluara në vitin 2023 dhe në kryerjen e hetime proaktive dhe/ose me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit, në 34 procedime penale nga 31 procedime penale në vitin 2023. Ky proces ka rezultuar me arrestimin në flagrancë apo ndalimin e 25 personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale në kompetencë të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm, shifër kjo që për vitin 2023 ka qenë 7 persona të dyshuar.

Referuar të dhënave statistikore për vitin 2024, për grupveprat penale të korrupsionit dhe ato që lidhen me detyrën (*përfshirë veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal*) në kompetencë të juridiksionit të përgjithshëm, janë regjistruar 569 procedime me 160 të pandehur dhe 157 procedime me 234 të pandehur janë dërguar për gjykim, ose krahasuar me vitin 2023 me ulje 10,25% të numrit të procedimeve të regjistruara dhe me ulje 22,27% të numrit të procedimeve të dërguara për gjykim për këto vepra penale. Gjithashtu, vihet re një rritje prej 4,84% të të pandehurve të dënuar për 2024-ën, krahasuar me vitin 2023.

Prokuroria e Përgjithshme ka cituar disa tregues statistikor për këto grupveprash për vitin 2024, krahasuar me vitin 2023, si vijon:

- Për nenin 244 të Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, gjatë vitit 2024 janë regjistruar 109 procedime penale, që përbëjnë ulje prej 4,38% krahasuar me 114 procedime penale të regjistruara për vitin 2023. Lidhur me numrin e të pandehurve regjistruar, vërehet ulje e lehtë nga 88 në 82 të pandehur ose 6,82%. Me ulje prej 43,41% rezultojnë procedimet e dërguara në gjykatë, nga 129 në 73;

- Për nenin 245/1 të Kodit Penal “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, janë regjistruar 3 procedime penale, ndaj 7 procedimeve të regjistruara për vitin 2023, ndërkohë që rezultojnë 2 procedime të dërguara në gjykatë dhe 7 të pandehur për vitin 2024;

- Për nenin 259 të Kodit Penal “Korrupsioni pasiv i personave me funksione publike”, për vitin 2024 janë regjistruar 26 procedime penale me 5 të pandehur ose me një ulje prej 35% e procedimeve të regjistruara krahasuar me vitin 2023 dhe ulje 81,48% e të pandehurve të regjistruar krahasuar me vitin 2023. Ndërkohë janë dërguar për gjykim 11 procedime me 22 të pandehur ose një rritje me 22,22% e procedimeve të dërguara për gjykim krahasuar me vitin 2023 dhe një rritje e të pandehurve të dërguar për gjykim nga 15 në 22 ose 46,67%.

- Për nenin 248 të Kodit Penal “Shpërdorimi i detyrës”, janë regjistruar 426 procedime penale, ose një ulje prej 8,19% e procedimeve krahasuar me vitin 2023. Lidhur me numrin e të pandehurve të regjistruar, vërehet rritje krahasuar me vitin 2023, nga 60 në 72 të pandehur ose 20%. Me rritje prej 12,90% rezultojnë dhe procedimet e dërguara në gjykatë, nga 62 në 70, ndërkohë rezultojnë ulje prej 29,35% e numrit të të pandehurve të dërguar për gjykim krahasuar me vitin 2023;

Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me Projektin Eu4Focal në prill të vitit 2024 publikoi Manualin për Pastrimin e Parave “*Goditja e aseteve kriminale: Manual gjithëpërfshirës mbi pastrimin e parave dhe recuperimin e aseteve*”, me synim rritjen e hetimeve financiare dhe pasurore në vijim të zbatimit të udhëzimit nr. 10/2020. Ky manual është publikuar në faqen zyrtare të internetit dhe është përfshirë me sukses si pjesë e programeve të trajnimit fillestar dhe vazhdues në Shkollën e Magjistraturës.

Për vitin 2024 mund të veçohen dy raste ku si rezultat i hetimeve të suksesshme të prokurorive të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm janë sekuestruar pasuri të fituara si rezultat i veprimtarisë kriminale në fushën e pastrimit të parave, të lidhura me veprat penale të korrupsionit dhe për shkak të detyrës.

Rasti i parë lidhet me një procedim penal në të cilin është kërkuar masa e arrestit në burg për 3 ish-zyrtarë një prej tyre ish i zgjedhur vendor dhe një shtetas, të akuzuar për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, “Falsifikimit të dokumenteve” dhe “Pastrimit të produkteve të veprës penale” parashikuar nga nenet 248, 186/3 dhe 287 të Kodit Penal. Shtetasi në bashkëpunim me ish-zyrtarët ka përvetësuar pasuri me dokumente të falsifikuara dhe e ka tjetërsuar këtë pasuri duke e ditur që është produkt i veprës penale të falsifikimit



të dokumenteve dhe prokurori ka kërkuar dhe sekuestrimin e pasurisë prej 7500 m², tokë e llojit “arë”.

Rasti i dytë ka të bëjë me sekuestrimin e 448.000 m² tokë të tjetërsuar nëpërmjet falsifikimit nga pronësi e shtetit në pasuri të individëve nga disa shtetas dhe disa zyrtarë të ASHK-së. Prokurori, në kuadër të një procedimi penal, ka kërkuar, përveç sekuestrimit të 448.000 m² tokë, dhe caktimin e masave të sigurisë “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Arrest në burg”, për 16 personat nën hetim, 3 prej të cilëve zyrtarë të ASHK-së, të akuzuar për veprat penale të “Shpërdorimit të detyrës”, “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, “Mashttrimit” dhe “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga nenet 248, 287, 142 dhe 186 të Kodit Penal.

Edhe në kuadër të luftës kundër korrupsionit, Prokuroria e Përgjithshme e ka vlerësuar si domosdoshmëri forcimin e kapaciteteve profesionale për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, e për këtë ka bashkërenduar me Shkollën e Magjistraturës dhe Komisionin e Policisë Gjyqësore.

Në kuadrin e trajnimit vazhdues, për vitin 2024 në Shkollën e Magjistraturës janë zhvilluar 9 trajnime, lidhur me temat në fushën e korrupsionit apo në fushën e krimeve me natyrë ekonomike e financiare, me pjesëmarrjen e 98 prokurorëve dhe 54 oficerëve të policisë gjyqësore.

Gjithashtu, në kuadër të projekteve të ndryshme ku prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm janë përfutues, janë zhvilluar aktivitetet nga KiE dhe GIZ me pjesëmarrjen totale të 7 prokurorëve.

- Nga Prokuroria e Përgjithshme rezultojnë se:

Janë hetuar gjithsej 793⁵⁸ procedime penale. Krahësuar me të dhënat e pasqyruara në raportin e vitit 2023, rezultojnë një rritje e numrit të procedimeve të hetuara me 43 procedime më shumë.

⁵⁸ Për vitin 2022 kanë qenë regjistruar 750 procedime penale, nga të cilat 451 procedime penale janë mbartur nga viti 2022, ndërsa 299 procedime penale janë regjistruar nga Prokuroria e Posaçme gjatë vitit 2023 si procedime penale të reja.

⁵⁹ Për vitin 2023, rezultojnë 38 çështje të dërguara për gjykim.

⁶⁰ Për vitin 2023, rezultojnë 147 persona të hetuar/pandehur.

⁶¹ Për vitin 2023, rezultojnë 44 persona me masë sigurimi arrest në burg nga të cilët 6 persona me masë sigurimi arrest në burg në mungesë.

Gjatë vitit 2024, Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), ka regjistruar 483 procedime penale në fushën e korrupsionit ose rreth 60.9% e veprave penale të regjistruara i përkasin grupit të veprave në fushën e korrupsionit.

Për 41 çështjet e dërguara për gjykim për vitin 2024 rezultojnë se numri i të hetuarve/pandehurve ka qenë 141 persona. Krahësuar me vitin e kaluar, rezultojnë 3 çështje më shumë të dërguara për gjykim⁵⁹ dhe 6 të pandehur më pak⁶⁰.

Nga 141 të pandehur rezultojnë se për 36 persona të pandehur është caktuar masa e sigurimit “arrest në burg”, nga të cilët 7 në mungesë (ose 8 persona më pak se nga viti i kaluar⁶¹); për 19 persona të pandehur është caktuar masa e sigurimit “arrest në shtëpi” (ose 3 persona më shumë se nga viti i kaluar⁶²); për 25 persona të pandehur është caktuar masa e sigurimit “detyrim për t’u paraqitur” (ose 6 persona më tepër se vitin e kaluar⁶³); për 5 persona të pandehur është caktuar masa e sigurimit “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”⁶⁴ dhe 56 persona të pandehur janë hetuar dhe dërguar në gjykatë pa caktuar ndaj tyre ndonjë masë sigurimi (në të njëjtat shifra si vitin e kaluar⁶⁵); nuk ka asnjë rast të caktimit të numrit të personave me masë sigurimi “ndalimi i daljes jashtë shtetit” (1 person më pak). Referuar këtyre të dhënave konstatohet se nuk ka ashpërsim të politikës penale për këtë kategori veprash, krahësuar me vitin e kaluar.

Për sa i përket hetimeve proaktive ose hetimeve të filluara kryesisht, referuar të dhënave të paraqitura nga SPAK-u, Prokuroria e Posaçme ka ruajtur të njëjtin trend pozitiv edhe në qasjen proaktive të hetimeve, ku gjatë vitit 2024 janë regjistruar 65 hetime të nisura kryesisht, nga 67 procedime penale që kanë qenë për vitin 2023.

Ka pasur aplikim të metodave të hetimit proaktiv në rastin e përgjimeve telefonike dhe, gjithashtu,

⁶² Për vitin 2023, rezultojnë 22 persona me masë sigurimi arrest në shtëpi.

⁶³ Për vitin 2023, rezultojnë 19 persona me masë sigurimi detyrim për t’u paraqitur.

⁶⁴ Për vitin 2023, nuk ka pasur asnjë person i pandehur me masë e sigurimit “Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik

⁶⁵ Për vitin 2023, ka pasur 56 persona të pandehur të hetuar dhe dërguar në gjykatë pa caktuar ndaj tyre ndonjë masë sigurimi.



edhe aplikimi i metodave të posaçme të hetimit, si: vëzhgime, kontrole, simulime, sekuestrimi i provave materiale, letërporosi, agentë të infiltruar. Gjithsesi rezulton se përgjatë vitit 2024 Prokuroria e Posaçme ka përdorur metodën e përgjimit për 163 procedime penale⁶⁶ ku janë interceptuar 3096 pajisje fundore. Krahasuar me vitin 2023, rezulton se kemi një ulje me 23 më pak të përdorimit të metodës së përgjimit dhe një ulje me 239 më pak të pajisjeve fundore të interceptuara ose 7.1% më e ulët.

Kapaciteti i SPAK-ut në hetimet financiare është rritur dhe përdorimi sistematik i hetimeve financiare dhe sekuestimeve të pasurisë është përmirësuar. Prokuroria e Posaçme ka miratuar, gjithashtu, udhëzimin e përgjithshëm nr. 1093, datë 11.11.2024, *“Për masat administrative dhe procedurale për kryerjen e hetimit financiar dhe pasuror në Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”*. Prokuroria e Posaçme, në zbatim të ligjit, ka ushtruar fillimin e hetimit financiar dhe pasuror paralel në pjesën më të madhe të hetimeve penale dhe në funksion të menaxhimit të aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara, vijon bashkëpunimin e ngushtë me Agjencinë e Administrimit dhe Konfiskimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

Nga të dhënat statistikore, rezulton se në vitin 2024, numri i procedimeve të regjistruara nga Prokuroria e Posaçme, në kuadër të luftës kundër *“Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”* është rritur me 47 procedime të regjistruara nga 35 procedime për vitin 2023, pra me një rritje prej 12 procedimesh të regjistruara më tepër ose me një rritje prej 34% në krahasim me vitin 2023, ndërsa në krahasim me vitin 2021 ku numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale të *“Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”* ka qenë 15 procedime rezulton se këto procedime për vitin 2024 janë mbi trefishuar.

Gjithashtu, për vitin 2024 ka pasur rritje të vlerës së aseteve të sekuestruara dhe konfiskuara në vlerën prej rreth 65,5 milionë euro, nga të cilat vlera e pasurive të sekuestruara është në shumën rreth 28,7 milionë euro ose rreth 43,8% të vlerës totale, ndërsa për pasuritë e konfiskuara kjo vlerë arrin në shumën

rreth 36,8 milionë euro ose rreth 56,2% të vlerës totale. Krahasuar me vitin 2023, ku vlera totale e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara ishte rreth 41 milionë, për vitin 2024 është 65,5 milionë euro, pra me një rritje në masën rreth 59,7% më tepër.

Prokuroria e Posaçme e ka vlerësuar si domosdoshmëri forcimin e kapaciteteve profesionale të prokurorëve nëpërmjet trajnimeve me fokus në luftën kundër korrupsionit dhe veçanërisht të hetimeve financiare. Në zbatim të urdhrit nr. 679, datë 9.10.2023, të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme *“Për miratimin e planit të trajnimit të personelit administrativ sipas kategorive për vitin 2023–2026”*, gjatë vitit 2024 janë kryer trajnime specifike sa i përket hetimeve financiare dhe atyre që lidhen me hetimin e kriptovalutave. Trajnimet janë zhvilluar në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës dhe agjencitë ligjzbatuese vendase, si: Agjencia e Inteligjencës Financiare, Agjencia e Administrimit dhe Konfiskimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe me agjencitë e huaja ligjzbatuese si: NCA, FBI, Eurojust etj. Gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme ka zhvilluar, gjithashtu, takime me donatorë ndërkombëtarë të cilët ofrojnë ekspertizë për mbështetje në fusha të ndryshme të trajnimeve dhe veçanërisht në fushën e hetimit financiar. Ekspertiza e marrë në këto trajnime ka shërbyer për identifikimin e transaksioneve të kryera në sistemin e kriptovalutave, duke aplikuar formula efikase në hetimet financiare, si dhe duke përdorur metodat më të mira për kryerjen e analizës financiare.

- Lufta kundër krimin të organizuar

Lidhur me këtë rekomandim, nga monitorimet ndërkombëtare kemi këto raportime:

Progres Raporti 2024,⁶⁷ në lidhje me pastrimin e parave konstaton, se: *“Shqipëria është ndërmjet nivelit të disa përpjekjeve dhe atij të një përgatitje të modernuar për t'u përshtatur me acquis të BE-së në këtë fushë. U arrit përparim i disa në plotësimin e rekomandimeve të vitit të kaluar, duke rritur kapacitetin e SPAK-ut për hetimet financiare (me akses të përmirësuar në bazat e të dhënave), duke forcuar luftën kundër pastrimit të parave dhe sekuestrimit të pasurive*

⁶⁶ Për vitin 2023, ishin regjistruar 186 procedime penale me 3335 pajisje fundore.

⁶⁷ *“Albania 2024 Report, Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2023 Communication on EU Enlargement* Faqe | 8008

Policy” publikuar në datën 30.10.2024, në faqen: https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8e3c3f9-b2ec-4cb1-87489058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf



të lidhura me krimin e organizuar. Shqipëria duhet të vazhdojë punën për të siguruar pavarësinë e agjencive të saj të zbatimit të ligjit. Shqipëria vazhdoi të zbatojë rekomandimet e Moneyval për përmirësimin e masave në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, dhe e përfundoi në mënyrë të ndjeshme Planin e Veprimit 2020, i cili çoi në vendimin e FATF-së për heqjen e Shqipërisë nga lista gri në tetor 2023. Më korrik 2024, Komiteti Kombëtar i Koordinimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave miratoi Strategjinë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit 2024–2030. Shqipëria ka legjislacion të miratuar për standardet e menaxhimit të riskut dhe kërkesat për licencimin e institucioneve financiare, përfshirë institucione jobankare dhe zyra të këmbimit valutor, në përputhje me rekomandimet e Moneyval. Legjislacioni kombëtar, i miratuar në korrik 2023, ka për qëllim të jetë në përputhje me aktet e BE-së në luftën kundër pastrimit të parave dhe regjistri i pronarëve përfutues është operativ. Pas miratimit të këtij ligji, kapacitetet e Njësisë Shqiptare të Inteligjencës Financiare u forcuan dhe ajo përmirësoi trajnimin e brendshëm për teknikat e hetimit financiar, ndjekjen e pasurisë, sekuestrimin dhe konfiskimin, teknikat e zbatimit të bazuara në risk dhe parandalimin e krimeve kibernetike, dhe një trajnim i tillë u ofrua edhe për entitete të tjera. Entitetet kryesore që raportuan në Agjencinë e Inteligjencës Financiare gjatë periudhës së raportimit vazhduan të ishin institucionet financiare - bankat dhe institucione jobankare, të ndjekura nga zyrat noteriale. Gjatë vitit 2023, Banka e Shqipërisë ka inspektuar 50 zyra këmbimi valutor, duke u fokusuar në përmbushjen e kërkesave të legjislacionit kundër pastrimit të parave. Këto inspektime çuan në vënien e 15 gjobave dhe 8 njoftimeve paralajmëruese, si dhe revokimin e licencave për 14 zyra këmbimi valutor, duke e reduktuar numrin e tyre në 621⁶⁸.

- Nga të dhënat statistikore të dërguara nga Prokuroria e Përgjithshme për vitin 2024 lidhur me veprat penale të krimit të organizuar, rezultojnë:

Lidhur me veprat penale në fushën e lëndëve narkotike⁶⁹, në vitin 2024 janë hetuar 3447 çështje penale ose 123 çështje penale më shumë se në vitin 2023. Rezultojnë se janë hetuar 1005 persona dhe janë marrë të pandehur 1321 persona.

Krahasuar me vitin 2023⁶⁹ rezultojnë ulje me 178 persona të hetuar më pak dhe rritje me 331 të pandehur më shumë. Janë dërguar për gjykim 722 çështje ose 20.95% e çështjeve, me 1210 të pandehur, nga ku rezultojnë rritje krahasuar me vitin 2023, me 123 çështje më shumë të dërguara për gjykim dhe 306 të pandehur më shumë⁷⁰. Numrin më të lartë të çështjeve në hetim e zë vepra penale: “Prodhimin dhe shitjen e narkotikëve”, neni 283 i Kodit Penal, me 2092 çështje në hetim, nga të cilat janë dërguar për gjykim 618 çështje.

Nga analiza e të dhënave statistikore, lidhur me veprat penale të trafikimit⁷¹, për vitin 2024 rezultojnë se janë regjistruar 306 çështje penale me 24 persona në hetim, nga të cilët 24 janë marrë si të pandehur. Nga këto çështje janë dërguar për gjykim 33 çështje me 49 të pandehur, ose rreth 10.78% e çështjeve të regjistruara. Numrin më të madh të çështjeve të regjistruara e zë vepra penale “Trafikimi i mjeteve motorike” parashikuar nga neni 141/“a” i K. Penal me 206 çështje.

Rezultojnë një rritje e konsiderueshme e numrit⁷² të çështjeve të regjistruara me 63 procedime më shumë dhe ulje e numrit të personave nën hetim me 17 më pak, si dhe rritje me vetëm 1 person të marrë si të pandehur më tepër. Lidhur me numrin e çështjeve të dërguara për gjykim për vitin 2024, numri i tyre është rritur me 3 çështje më shumë, po ashtu edhe numri i të pandehurve në gjykim është rritur me 8 persona më shumë krahasuar me vitin 2023⁷³.

Lidhur me veprat penale për nxitjen e urrejtjes dhe pjesëmarrjen në konfliktet e armatosura,⁷⁴ për vitin 2024, janë regjistruar 6 çështje penale për veprën penale “Nxitja e urrejtjes ose grindjeve”, parashikuar nga neni 265 i Kodit Penal, me 1 person nën hetim dhe asnjë të pandehur. Rezultojnë se kemi 1 çështje të regjistruar për këtë grupveprash më pak dhe me 1 person më pak në hetim krahasuar me vitin 2023⁷⁵, dhe kemi 1

⁶⁸ Ku janë përfshirë nenet 283–286/“a” të K. Penal.

⁶⁹ Në vitin 2023 kanë qenë 3213 çështje të hetuara me 1183 persona nën hetim dhe 990 të pandehur.

⁷⁰ Në vitin 2023 janë dërguar për gjykim 599 çështje me 904 persona të pandehur.

⁷¹ Nenet 109, 109/“b”, 110/“a”, 128/“b”, 138/“a”, 1ë/“a”, 278/“a” dhe 282/“a” të K. Penal.

⁷² Në vitin 2023 ishin regjistruar 243 çështje penale me 41 persona në hetim, nga të cilët 23 janë marrë si të pandehur.

⁷³ Në vitin 2023 ishin dërguar për gjykim 30 çështje me 41 të pandehur për këtë kategori veprash penale.

⁷⁴ Nenet 265–265/“c” të K. Penal.

⁷⁵ Në vitin 2023 janë regjistruar 7 çështje penale, me 2 persona të marrë nën hetim dhe 0 të pandehur.



çështje të dërguar për gjykim me 1 të pandehur, në të njëjtat shifra si në vitin 2023⁷⁶.

Në kuadër të udhëzimit të përgjithshëm nr. 5/2024, strukturat përkatëse në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm janë udhëzuar për vijimin e rritjes së mëtejshme të bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese brenda vendit, rajonale e ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale në fushën e narkotikëve dhe trafikeve.

Prokurori i Përgjithshëm, në datën 1.3.2024, ka nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme “*Për ekspertimin e farërave dhe fidanëve të rinj të bimëve narkotike të sekuestruara*”.

Referuar të dhënave statistikore të vitit 2024, janë paraqitur rezultatet e këtyre masave në hetimin dhe ndjekjen penale të autorëve të veprave penale të trafikimit të paligjshëm, prodhimi/kultivimi i narkotikëve dhe veprave penale në mbrojtje të sigurisë kombëtare, si më poshtë:

i. Për veprën penale të “*Trafikimit të narkotikëve*”, parashikuar nga neni 283/“a” i Kodit Penal, nga të dhënat statistikore rezulton se për vitin 2024 janë regjistruar 42 procedime me 22 të pandehur dhe 16 procedime me 31 të pandehur janë dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2023 kemi një ulje prej 29,27% të numrit të procedimeve, ulje 70,21 % të numrit të pandehurve të regjistruar, ulje 19,23% të numrit të procedimeve të dërguar për gjykim, si dhe ulje prej 36% të të pandehurve të dërguar për gjykim për këtë vepër;

ii. Për veprën penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”, të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, në vitin 2024, sipas të dhënave statistikore për këtë vepër janë regjistruar 1057 procedime me 973 të pandehur ose një rritje prej 3,02% të procedimeve të regjistruara dhe rritje 9,08% të të pandehurve të regjistruara krahasuar me vitin 2023. Për vitin 2024 janë dërguar për gjykim 616 procedime me 1040 të pandehur ose rritje prej 29,83% e procedimeve të dërguara për gjykim dhe një rritje prej 45,45% e të pandehurve të dërguar për gjykim;

iii. Për veprën penale “*Kultivimi i bimëve narkotike*”, të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, në vitin 2024, sipas të dhënave statistikore për këtë vepër janë regjistruar 619 procedime me 93 të pandehur ose një ulje prej 14,74% e procedimeve të

regjistruara dhe një ulje prej 14,68% të të pandehurve të regjistruar. Lidhur me procedimet dhe të pandehurit e dërguar për gjykim për këtë vepër penale, 86 procedime me 136 të pandehur janë dërguar për gjykim ose një ulje prej 7,53% e procedimeve të dërguara për gjykim krahasuar me vitin 2023.

Kërkesat e prokurorit, lidhur me masat e sigurimit për persona që kanë kryer krime në fushën e narkotikëve, janë relativisht të ashpra, ku 78,02% janë kërkesa për masa sigurimi me arrest dhe pjesa tjetër janë kërkesa për masa më të lehta, si detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore. Edhe kërkesat për caktimin e dënimit janë relativisht të ashpra për të pandehurit e akuzuar për këto krime. Kështu, në vitin 2024 numri i kërkesave për caktimin e dënimit me burg është 66,78% dhe numri i kërkesave për caktimin e alternativave të dënimit me burg është 33,22%.

Ndjekja penale, politika penale dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit është ndër çështjet prioritare në prokurori, nisur nga cenimi i rëndë i të drejtave të njeriut që karakterizon këtë formë krimi.

Në funksion të plotësimit të kuadrit nënligjor unifikues me qasjen që ka në qendër viktimën e trafikimit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar udhëzimin e përgjithshëm nr. 6, datë 23.7.2024, “*Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër trafikimit të personave*”, për unifikimin e masave administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, duke siguruar hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të trafikimit të personave. Gjithashtu, ky udhëzim ka për qëllim plotësimin e kuadrit nënligjor unifikues në vijim të udhëzimit të përgjithshëm nr. 5/2018, “*Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale*”.

Ka vijuar angazhimi dhe bashkëpunimi me projekte ndërkombëtare që mbështesin institucionet shqiptare dhe ato të rajonit, si projekti “*Forcimi i kapaciteteve të institucioneve ligjzbatuese për bashkëpunimin ndërsektorial dhe ndjekjen penale të trafikimit të personave*” i OSBE-së dhe projekti “*Mbështetja e BE-së për të forcuar luftën kundër kontrabandës së migrantëve dhe trafikimit të qenieve njerëzore në Ballkanin Perëndimor*”.

Gjithashtu, është theksuar bashkëpunimi me Ministrinë e Brendshme në kuadër të miratimit të

⁷⁶ Në vitin 2023 ishte 1 çështje e dërguar për gjykim me 1 të pandehur.



marrëveshjes ndërinstitucionale për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit, në mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Përgjatë vitit 2024, në kuadër të forcimit të kapaciteteve, prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe koordinatorët e viktimave janë angazhuar në trajnime dhe takimet të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, organizata të ndryshme joqeveritare që operojnë në këtë fushë apo organizata të tjera ndërkombëtare që asistojnë prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm në fushën e trafikimit apo krimeve të rënda, ku kanë marrë pjesë në total 129 prokurorë dhe 93 oficerë të policisë gjyqësore.

Një rol aktiv është mbajtur edhe në drejtimin e asistencës ndaj viktimave të trafikimit, ku koordinatorët e viktimave në Prokurorinë e Përgjithshme janë angazhuar në aktivitete të përbashkëta të organizuara nga UNODC-ja, Ministria e Brendshme, *Terre des Hommes* etj. Në kuadër të këtij projekti është përgatitur dhe një draftprotokoll për punën e koordinatorit të viktimave.

Në kuadrin e bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese ndërkombëtare, nga të dhënat statistikore të gjeneruara nga sistemi IMPRO në Prokurorinë e Përgjithshme, sa i takon bashkëpunimit ndërkombëtar me autoritetet e huaja për vitin 2024 rezulton se janë trajtuar 12 letërporosi nga jashtë për trafikimin e qenieve njerëzore.

Referuar të dhënave statistikore, tendenca e disa veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe të trafikimit të paligjshëm dhe mbajtjes pa leje ose prodhimit të armëve e municioneve për vitin 2024, krahasuar me vitin 2023, është si vijon:

i. Për veprën penale “*Trafikimin e personave të rritur*”, të parashikuar nga neni 110/“a” i Kodit Penal, për vitin 2024, janë regjistruar 11 procedime penale me 3 të pandehur ose krahasuar me vitin 2023 me rritje prej 83,33% të numrit të procedimeve të regjistruara dhe me ulje nga 50% të të pandehurve të regjistruar. Gjithashtu, për këtë periudhë kemi 4 të pandehur të dënuar për këtë veprë penale;

ii. Për veprën penale “*Trafikimi i të miturve*”, të parashikuar nga neni 128/“b” i Kodit Penal, sipas të dhënave statistikore rezulton se për vitin 2024 janë regjistruar 2 procedime penale, ndërkohë rezultojnë 2 të pandehur të dënuar për këtë veprë penale;

iii. Lidhur me veprën penale të “*Trafikimit të armëve dhe municionit*”, parashikuar nga neni 278/“a” i

Kodit Penal, nga të dhënat statistikore rezulton se për vitin 2024, janë regjistruar 14 procedime penale dhe 8 të pandehur. Duke i krahasuar me vitin 2023 konstatohet një ulje prej 33,33% e procedimeve të regjistruara, ulje me 11,11% e numrit të të pandehurve të regjistruar, rritje nga 3 në 7 (2,3 herë) i numrit të procedimeve të dërguara për gjykim për këtë veprë dhe nga 3 në 10 (3,33 herë) e numrit të të pandehurve të dërguar për gjykim;

iv. Lidhur me veprën penale “*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit*”, parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal, nga të dhënat statistikore për vitin 2024 rezulton se janë regjistruar 298 procedime dhe 239 të pandehur, ndërkohë që 177 procedime me 221 të pandehur janë dërguar për gjykim ose krahasuar me vitin 2023 vihet re ulje prej 11,57% e numrit të procedimeve të regjistruara, ulje prej 15,51% e numrit të procedimeve dërguar gjyqit, ulje 8,43% e të pandehurve të regjistruar dhe ulje 3,91% e numrit të të pandehurve të dërguar për gjykim për këtë veprë. Sa i përket politikës penale, lidhur me këtë veprë, 89,65% e kërkesave të prokurorit për masa sigurimi janë kërkesa për masa sigurimi “arrest me burg”. Lidhur me kërkesat për caktimin e dënimit, për vitin 2024 kërkesat për caktimin e dënimit me burg përbëjnë 88,50% të numrit total të kërkesave të prokurorit dhe vetëm 1,50% janë kërkesa për dënim me gjobë. Sa i përket masës së dënimit, është kërkuar aplikimi i pezullimit të dënimit dhe vendosja në provë për vetëm 24,29% e të pandehurve.

Sa i përket veprave penale me qëllime terroriste, referuar nenit 75/“a” të Kodit të Procedurës Penale, kompetenca lëndore e tyre i përket Prokurorisë së Posaçme.

Referuar të dhënave statistikore, lidhur me kreun V të Kodit Penal, “Vepra penale kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues”, dhe kreun VI të Kodit Penal, “Krime që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera”, gjatë vitit 2024, janë regjistruar 4 procedime penale dhe 1 i pandehur për krime kundër pavarësisë e rendit kushtetues dhe krime që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera, dhe janë dërguar 2 procedime me 4 të pandehur në gjykatë. Konkretisht rezulton se:

është regjistruar 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 214 i Kodit Penal “*Sigurimi i informatave*” dhe 1 procedim me 3 të pandehur është dërguar në gjykatë;



janë regjistruar 2 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 223 i Kodit Penal “*Thirrjet publike për veprime të dhunshme*” dhe 1 procedim me 1 të pandehur është dërguar në gjykatë;

është regjistruar 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 228 i Kodit Penal “*Veprimet e dhunshme ndaj vendeve të punës së personave të mbrojtur ndërkombëtarisht*”.

Lidhur me hetimet financiare për veprat penale të pastrimit të parave dhe produkteve të veprës penale, gjatë vitit 2024 ka vijuar angazhimi i prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm në hetimin e veprës penale të pastrimit të parave, është synuar rritja e cilësisë në hetim dhe rritja e sekuestrimeve apo konfiskimeve të produkteve që rrjedhin nga këto vepra.

Sikundër është përmendur edhe në shtyllën e luftës kundër korrupsionit, Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me Projektin Eu4Focal publikoi Manualin “*Goditja e aseteve kriminale: Manual gjithëpërfshirës mbi pastrimin e parave dhe rekuperimin e aseteve. Kuadri ligjor shqiptar dhe ndërkombëtar*”.

Komisioni Evropian krijoi në vitin 2023, platformën e re të unifikuar për Ballkanin Perëndimor, *e-Tracking*, për mbledhjen e të dhënave në kohë reale, si dhe krijimin e një historiku të ndjekjeve dhe dënimeve penale, ku ndër të tjera referuar kompetencave të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, raportohet për çështjet në hetim për veprën penale të pastrimit të parave, si dhe statistika për grupvepra të caktuara penale, lidhur me krimin ekonomik dhe krime të rënda, si narkotikët, trafikët, etj. Prokuroria e Përgjithshme, në rolin e koordinuesit dhe monitoruesit, dhe prokuroritë e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, si përdorues parësor të platformës, janë angazhuar maksimalisht si në procesin e hedhjes ashtu dhe të raportimit të të dhënave lidhur me sa kërkon kjo platformë.

Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar të bashkërendojë punën dhe me Koordinatorin Kombëtar në Ministrinë e Drejtësisë ashtu dhe me shërbimet e Komisionit Evropian, në funksion të mbarëvajtjes së të gjithë procesit, dhe Prokurori i Përgjithshëm ka miratuar udhëzimin nr. 3, datë 25.4.2024, “*Për përdorimin e platformës elektronike për raportimin e të dhënave për korrupsionin dhe krimin e organizuar*”, në të cilin është kërkuar marrja e masave

administrative dhe procedurale nga drejtuesit në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, lidhur me hedhjen e saktë, të plotë dhe periodike të të dhënave me dy kategori të dhënash: i. me të dhëna për çështjet penale lidhur me pastrimin e produkteve të veprës penale, me vijueshmërinë e këtyre procedimeve penale, deri në fazën e përfundimit të hetimeve; ii. statistika periodike për grupvepra të caktuara penale të cilat vlerësohen të nevojshme dhe ndryshojnë sipas prioriteteve të procesit të integritetit lidhur me krimin ekonomik dhe krime të rënda.

Gjatë vitit 2024, ka përfunduar hedhja e të dhënave statistikore për periudhën 2018–2023 dhe në vijim do të përditësohen të dhënat për vitin 2024, për grupveprat lidhur me pastrimin e parave, trafikët, krimin kibernetik etj., si dhe vijon puna për hedhjen dhe përditësimin e çështjeve konkrete të veprës penale, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal “*Pastrimi i produkteve të veprës penale*”, nga viti 2022 e në vijim.

Referuar të dhënave statistikore për vitin 2024, rezulton se për veprat penale të parashikuara nga neni 287 i Kodit Penal “*Pastrimi i produkteve të veprës penale*” dhe nga neni 287/“b” i Kodit Penal, “*Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale*”, janë regjistruar 251 procedime penale të reja dhe 14 të pandehur, me një rritje prej 58,86% e procedimeve të regjistruara dhe ulje prej 6,67 % të të pandehurve regjistruar, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023. Për këto vepra penale, 17 procedime me 33 të pandehur u dërguan për gjykim dhe 19 të pandehur rezultojnë të dënuar, ose me një rritje prej 21, 43 % e procedimeve penale dërguar gjyqit dhe rritje prej 22, 22% e të pandehurve të dërguar për gjykim. Në këtë periudhë vetëm për veprën penale “*Pastrimi i produkteve të veprës penale*”, sipas nenit 287 të Kodit Penal, janë regjistruar 248 procedime penale me 5 të pandehur dhe 13 procedime me 21 të pandehur janë dërguar për gjykim.

Lidhur me hetimet financiare dhe pasurore për sekuestrimin/konfiskimin e pasurisë, për vitin 2024 në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, në kuadrin e hetimit dhe ushtrimit të ndjekjes penale për veprën penale “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, sipas nenit 287 të Kodit Penal dhe për vepra të tjera penale të lidhura me to, në zbatim të nenit 36 të Kodit Penal dhe neneve 274 dhe/ose 210, 190 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në zbatim të nenit 3/1 e vijues të ligjit



nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, pas kërkesave të prokurorëve gjykata ka vendosur konfiskime të pasurisë/aseteve kriminale në total në kuadrin e 12 çështjeve, dhe sekuestreime të pasurisë/aseteve kriminale në kuadrin e 30 çështjeve. Gjithashtu, në zbatim të nenit 3/1 e vijues të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, në kuadrin e procedimeve/hetimeve pasurore, për vitin 2024 prokurorët kanë regjistruar 185 verifikime pasurore.

Në kuadër të hetimeve financiare e pasurore janë ndërmarrë një sërë aktiviteteve dhe angazhimesh të rëndësishme, e konkretisht:

Përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme, në cilësinë e anëtarëve të Komitetit të Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave dhe pjesë e Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës, janë angazhuar maksimalisht në funksion të:

- hartimit të “Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024–2030”, për t’i shërbyer zbatimit të saj në mënyrë sa më reale dhe efektive në përputhje me rekomandimet dhe masat vepruese institucionale dhe ndërinstitucionale;

- pjesëmarrjes në aktivitetet e zhvilluara nga Grupi Teknik Ndërinstitucional i Punës (GTNP) në varësi të KBLKPP-së duke u angazhuar maksimalisht në nëngrupin II, në fushën “Për mbledhjen dhe cilësinë e informacionit për investigimet penale në lidhje me PP/FT”, e cila lidhet me fushën e veprimtarisë së saj institucionale;

- Planit të Veprimit të “Vlerësimit kombëtar të riskut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Shqipëri” (me një shtrirje kohore 3 vjeçare);

- zbatimit të Planit të Veprimit për vitin 2024 “Për ndjekjen e rekomandimeve të grupit të përbashkët të ICRG/FATF dhe neneve 5 dhe 6, të “Rregullore për funksionimin e Komitetit të Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave”;

- raportimit mbi ecurinë e procesit përgatitor për vlerësimin e Shqipërisë nga Komiteti MONEYVAL në kuadër të raundit të 6-të të vlerësimit (2025–2026).

Janë realizuar një sërë aktiviteteve dhe trajnimesh në kuadër të forcimit të kapaciteteve të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, në fushën e

hetimit të veprës penale të pastrimit të parave organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, KiE, GIZ, projekti EU4FOCAL, me pjesëmarrjen totale të 39 prokurorëve dhe 22 oficerëve të policisë gjyqësore.

Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar ndërveprimin për rritjen e eficiencës në bashkëpunimin me autoritetet gjyqësore të huaja në fushën penale, për fuqizimin e bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare, në funksion të efektivitetit të hetimeve, për veprat penale që lidhen sidomos me trafikimin e narkotikëve, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, trafikimin e qenieve njerëzore, etj. Në kuadër të vlerësimit të raundit të 6-të të MONEYVAL-it në vitin 2025, gjatë vitit 2024 Prokuroria e Përgjithshme dhe prokuroritë e juridiksionit janë angazhuar maksimalisht në këtë proces parapërgatitor. Nga grupi i punës së ngritur në Prokurorinë e Përgjithshme janë plotësuar me rigorozitet pyetësorët e efektivitetit, librat e çështjeve, për rezultatet imediate IO.2, IO.7, IO.8, IO.9 të MONEYVAL-it. Në muajt tetor, nëntor 2024 u realizuan takime/ushtrime simuluese të cilat u udhëhoqën nga ekspertë ndërkombëtarë të Këshillit të Evropës. Në dhjetor 2024, Prokuroria e Përgjithshme përcolli shpjegimet shtesë të detajuara për çdo çështje lidhur me konstatimet e ekspertëve në Dokumentet Teknike të Analizave të Efektivitetit të Masave për IO.2, IO.7, IO.8. Në janar 2025, u zhvillua faza përfundimtare e procesit të Ushtrimeve/Vlerësimeve Simuluese për IO.2, IO.6, IO.7, IO.8, duke u finalizuar me zhvillimin e një seminari me pjesëmarrjen e ekspertëve vlerësues të Këshillit të Evropës, të cilët ofruan udhëzime praktike dhe njohuri të vlefshme për të ndihmuar institucionet shqiptare në ecurinë me sukses të procesit të vlerësimit nga MONEYVAL-i në të ardhmen. Gjatë prezantimit të analizës për IO.7, eksperti vlerësoi Prokurorinë e Përgjithshme për nivelin profesional në plotësimin e pyetësorit të efektivitetit IO.7.

Gjatë vitit 2024 është vijuar puna për përmirësimin e sistemit *e-Tracking* PRESTO, i krijuar me mbështetjen e projektit EURALIUS V, ngritur me urdhrin nr. 92/2021, të Prokurorit të Përgjithshëm, për përfitimin e statistikave në kohë reale për hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale të veprave penale të pastrimit të parave, monitoruar nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit në Prokurorinë e Përgjithshme. Përmirësimi i këtij



sistemi konsiston në: i. Përshtatjen në *e-PRESTO*, të tipologjive të *MONEYVAL-it*; ii. implementimin e dy regjistrave *e-Tracking* për procedimet penale sipas nenit 287 dhe referimet pasurore sipas ligjit antimafia nr. 10192, datë 3.12.2009; iii. implementimin e regjistrat të transferimit të çështjeve midis prokurorëve; iv. përmirësimin e “Raporteve”, regjistrave statistikore me qëllim që sistemi të gjenerojë në mënyrë automatike statistika specifike.

Nga ana tjetër, është përditësuar manuali për përdoruesit dhe Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit në Prokurorinë e Përgjithshme është angazhuar më trajnimin e përdoruesve dhe ofron asistencë teknike, për hedhjen e të dhënave në sistem, proces me rendësi në kuadër të Raundit të VI të vlerësimit të Shqipërisë nga *MONEYVAL-i*.

Në kuadër të masave të marra në luftën kundër pastrimit të parave dhe krimeve të tjera që gjenerojnë të ardhura/produkte nga veprimtaria kriminale, sërish është theksuar zbatimi i udhëzimit të përgjithshëm nr. 5/2024, “Për rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, dhe udhëzimit të përgjithshëm nr. 10/2020, si dhe Aktit të Koordinimit Institucional “Për rritjen e eficiencës nëpërmjet, bashkërendimit të Prokurorisë së Përgjithshme me Prokurorinë e Posaçme dhe unifikimin e disa veprimtarive administrative dhe procedurale ndërinstytucionale”. Sipas të dhënave statistikore dhe të konfirmuara nga informacioni i Prokurorisë së Posaçme, janë regjistruar 22 procedime të regjistruara për vepra që lidhen me krimin e organizuar dhe krimet e rënda dhe 39 procedime penale për vepra që lidhen me korrupsionin ose vepra penale që lidhen me detyrën.

Prokurorët për vitin 2024 kanë rritur rolin aktiv në kryerjen e hetime proaktive me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit në 155⁷⁷ procedime penale vetëm në lidhje me veprat penale: - prodhimi dhe shitja e narkotikëve; - trafikimi i narkotikëve; - kultivimi i bimëve narkotike; - trafikimi i armëve e i municioneve; - mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit; - pastrimi i parave, - ndihma për kalim të paligjshëm të personave. Ky proces i ka shërbyer si parandalimit dhe/ose ndërprerjes së mëtejshme të veprimtarisë kriminale, ashtu dhe goditjes/finalizimit me

arrestimin në flagrancë apo ndalimin e 196⁷⁸ personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale në kompetencë të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Ka vijuar forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional, në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit të PP-së me MB-së, MF-së, DPPSH-së, DPPPP-së, DPD-së, DPT-së të vitit 2020, “Për rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimet financiare dhe sekuestrimin e konfiskimin e aseteve kriminale, në funksion të përmbushjes së rekomandimeve të KSA-së e FATF-së dhe Planit të Veprimit ICRG/FATF”, në rritjen më tej të efektivitetit të çështjeve penale, për veprat penale kundër pastrimit të produkteve kriminale, krimet financiare dhe hetimet pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale. Në zbatim të këtij Memorandumi Bashkëpunimi të vitit 2020, ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (përfshirë DPPPP-në, DPD-në e DPT-në) dhe Ministrisë së Brendshme, pas trajtimit të kërkesave të ardhura nga autoritetet e huaja gjatë vitit 2024, për 51 raste i është kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit kryerja e verifikimit pasuror.

Në funksion të rritjes së eficiencës dhe efektivitetit të hetimeve dhe ndjekjes penale për veprat penale që lidhen me trafikimin e narkotikëve, trafikimin e qenieve njerëzore, pastrimin e parave, etj., janë marrë masa e arritur rezultatet, si më poshtë:

1. Në drejtim të bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar gjatë vitit 2024, Prokurori i Përgjithshëm ka zhvilluar takime dypalëshe me Prokuroren e Përgjithshme të Mbretërisë së Holandës dhe Prokuroren e Përgjithshme të Prokurorisë Federale të Mbretërisë së Belgjikës për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit.

2. Grupi i punës i nivelit të lartë PTA TOC, për monitorimin e zbatimit të “Marrëveshjes dypalëshe ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe, dhe Irlandës së Veriut për transferimin e personave të dënuar”, ka diskutuar mbi ecurinë e çështjeve aktuale të transferimit, bashkëpunimi gjyqësor, reforma në sistemin e burgjeve dhe impakti i saj, planifikimi i monitorimit në vazhdim etj.

⁷⁷ Për vitin 2023 kanë qenë 394 procedime penale.

⁷⁸ Për vitin 2023 ka qenë 325 persona të dyshuar.



3. Janë nënshkruar dy marrëveshje të reja bashkëpunimi, e konkretisht:

i. Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë dhe Prokurorisë Federale të Mbretërisë së Belgjikës, e cila zëvendëson marrëveshjen e mëparshme, datë 10 maj 2011, me qëllim rritjen e bashkëpunimit ekzistues në nivel strukturor;

ii. Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Azerbajxhanit, i cili ka si qëllim forcimin e bashkëpunimit ekzistues në luftën kundër krimit ndërkombëtar, përfshirë çështjet e rekuperimit të aseteve.

Theksohet se aktualisht Shqipëria ka marrëveshje dypalëshe ekstradimi (në të cilat parashikohet ekstradimi i shtetasve respektivë) me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretërinë e Bashkuar, Italinë, Spanjën dhe Kosovën, dhe si pasojë e zbatimit të tyre rezulton të kemi numrin më të lartë të praktikave të ekstradimit me këto shtete. Aktualisht janë 20 praktika aktive të transferimit të të dënuarve nga Mbretëria e Bashkuar në Shqipëri dhe Prokuroria e Përgjithshme së bashku me Ministrinë e Drejtësisë po bashkëpunojnë ngushtë me Ambasadën Britanike në Tiranë për shmangien e vështirësive që hasen lidhur me këto praktika dhe realizimin me sukses të transferimeve.

Për periudhën janar–30 nëntor 2024, të dhënat e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar të administruara në sistemin elektronik IMPRO rezultojnë, si më poshtë:

- Ekstradime nga Shqipëria për jashtë vendit, 137 praktika dhe janë përfunduar gjithsej 71 praktika;

- Ekstradime nga jashtë drejt Shqipërisë, 132 praktika, 47 të përfunduara;

- Urdhërarreste ndërkombëtare të lëshuara nga autoritetet e huaja për shtetasit shqiptarë të cilët nuk mund të ekstradohen për shkak të shtetësisë shqiptare, në total 285 praktika nga të cilat 127 të përfunduara;

- Letërporosi nga jashtë, 599 praktika, ku kërkuesit kryesorë janë vendet e Bashkimit Evropian. Ndërkohë autoritetet gjyqësore shqiptare kanë përfunduar, gjithsej, 219 letërporosi ose 36,50 % të tyre;

- Letërporosi për jashtë, 539 praktika, 125 të përfunduara ose 23,20 %;

- Transferime të dënuarish nga jashtë, 43 praktika;

- Transferime të dënuarish për jashtë, 3 praktika;

- Transferim procedimi nga jashtë drejt Shqipërisë, 6 praktika;

- Transferim procedimi nga Shqipëria për jashtë, 10 praktika;

- Njohje të vendimeve penale të ardhura nga jashtë, 35 praktika;

- Njohje të vendimeve penale shqiptare të dërguara jashtë vendit, 5 praktika;

- 209 praktika shpalljeje në kërkim ndërkombëtar dhe 76 praktika heqjeje nga kërkimi ndërkombëtar;

Prokurori i Përgjithshëm në cilësinë e përfaqësuesit të autoritetit kompetent ka vijuar zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Eurojust, nëpërmjet veprimtarisë së Prokurorit Ndërlidhës të Shqipërisë në Eurojust. Në vitin 2024, volumni i çështjeve të ndjekura në Eurojust ishte 247 çështje, që përbën një rritje prej 5% të ngarkesës krahasuar me vitin 2023. Në vitin 2024, Zyra Shqiptare në Eurojust mbështeti krijimin dhe vijimin e 24 skuadrave të përbashkëta hetimore, ku 6 skuadra hetimore janë krijuar gjatë vitit 2024, duke treguar kështu besimin dhe mbështetjen e autoriteteve kombëtare në shërbimet e kësaj zyre për të lehtësuar bashkëpunimin gjyqësor, si dhe thellimin e bashkëpunimit me vendet e Bashkimit Evropian në luftën kundër krimit transnacional. Autoritetet shqiptare kanë marrë pjesë në 3 Qendra Koordinimi të Ditëve të Aksionit dhe 19 mbledhje të koordinuara bilaterale dhe multilaterale.

Prokuroria e Përgjithshme ka trajtuar me prioritet nevojën e rritjes së kapaciteteve profesionale për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore nëpërmjet trajnimeve të posaçme në fushën e veprave penale të krimit të organizuar, duke përfshirë edhe trajnime të përbashkëta me struktura të tjera ligjzbatuese. Prokurorët kanë ndjekur trajnimet vazhduese të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës, me synim forcimin e kapaciteteve në luftën kundër kriminalitetit dhe në këtë fushë/drejtim kanë marrë pjesë në total 186 prokurorë dhe 113 oficerë të policisë gjyqësore.

Në kuadër të rritjes së kapaciteteve profesionale në këtë fushë, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore kanë marrë pjesë edhe në një sërë aktiviteteve/trajnimesh të organizuara nga organizata/OJF ndërkombëtare, ndër të cilat përmendim UNODC, GIZ, OSCE, Këshilli i



Evropës etj., të cilat janë listuar më sipër, në drejtimin “Garantimi i pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit”.

- Nga të dhënat e sjella nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK)⁷⁹ rezulton:

Gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme ka hetuar gjithsej 245 çështje (mbartur dhe regjistruar) për 400 persona nën hetim për veprat penale të krimit të organizuar⁸⁰, pra rezulton një rritje e numrit të procedimeve penale me 44 më shumë se vitin e kaluar.

Lidhur me përdorimin e metodave speciale të hetimit rezulton se përgjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka pasur rritje të metodave të hetimit proaktiv, në rastin e përgjimeve telefonike, por është rritur, gjithashtu, edhe aplikimi i metodave të posaçme të hetimit, si: vëzhgime, kontrolle, simulime, sekuestro e provave materiale, letërporosi, agjentë të infiltruar, ku përgjatë vitit 2024 Prokuroria e Posaçme ka përdorur metodën e përgjimit për 163 procedime penale⁸¹ ku janë interceptuar 3096 pajisje fundore, me një ulje me 23 procedime më pak të përdorimit të metodës së përgjimit dhe një ulje me 239 më pak të pajisjeve fundore të interceptuara ose 7.1% më e ulët.

Ndërkohë, për sa i përket hetimeve proaktive ose hetimeve të filluara kryesisht për veprat penale të krimit të organizuar, nuk rezulton të ketë të dhëna për vitin 2024⁸², por në total për të gjitha veprat penale rezulton se janë regjistruar vetëm 65 procedime penale kryesisht nga organi i Prokurorisë së Posaçme, nga 67 procedime penale kryesisht që kanë qenë për vitin 2023.

Për vitin 2024 numri i çështjeve të regjistruara nga Prokuroria e Posaçme për veprën penale të trafikut të narkotikëve, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, është 35 çështje me 35 persona nën hetim. Ndërsa, numri i çështjeve nën hetim për këtë vepër penale (mbartur + regjistruar) është 124 çështje me 72 persona nën hetim. Krahësuar me vitin 2023, numri i çështjeve nën hetim për veprën penale të trafikut të narkotikëve, në kuadër të grupit të strukturuar kriminal (nënet 283/“a”/2, 333/“a”,

334) është rritur nga 120 në vitin 2023 në 124 për vitin 2024 ose me një rritje në masën 3,3%. Gjithashtu, gjatë vitit 2024, numri i çështjeve të dërguara në gjykatë me kërkesë për gjykim është 5 çështje me 33 të pandehur.

Për veprat penale në fushën e terrorizimit në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, për vitin 2024 rezulton të jenë 2 çështje nën hetim (e mbartur + regjistruar). Gjithashtu, është dërguar në gjykatë me kërkesë për gjykim për veprën penale të financimit të terrorizimit (neni 230/“a”), 1 çështje me 1 person të pandehur.

Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar është vlerësuar pozitivisht në luftën kundër pastrimit të parave dhe kontributi i saj është vlerësuar si faktor kryesor në daljen e Shqipërisë nga lista e vendeve në monitorim të shtuar apo siç quhet ndryshe nga “lista gri”. Gjatë vitit 2024, zbatimi i masave, me qëllim përmbushjen e rekomandimeve të MONEYVAL-it ka qenë një nga objektivat kryesorë të Prokurorisë së Posaçme, e cila ka raportuar në vijimësi për ecurinë e zbatimit të tyre në bashkëpunim të ngushtë edhe me Agjencinë e Inteligjencës Financiare. Prokuroria e Posaçme, për secilën kategori të veprave penale që janë në kompetencën e saj, vijon të kryejë hetim financiar dhe pasuror paralel, i cili sjell për pasojë sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të autorëve të veprave penale.

Është miratuar udhëzimi i përgjithshëm me nr. 1093, datë 11.11.2024, “Për masat administrative dhe procedurale për kryerjen e hetimit financiar dhe pasuror në Struktura të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”, për intensifikimin e hetimeve paralele financiare, mënyrës së hetimit nga prokurorët e posaçëm, oficerët e BKH-së dhe hetuesit financiarë, si dhe me qëllim përcaktimin e rregullave të qarta, lidhur me mënyrën dhe procedurën e hetimit financiar.

Gjithashtu, sikundër u përmend në shtyllën e luftës kundër korrupsionit, një nga masat e marra nga Prokuroria e Posaçme, me qëllim rritjen e cilësisë së hetimeve financiare, është edhe zbatimi i Planit të trajnimeve për vitin 2023–2026, i miratuar me urdhrin nr. 679, datë 9.10.2023, të drejtuesit të

⁷⁹ Me shkresën e Prokurorisë së Posaçme nr. 9020 prot., datë 12. 3.2025, protokolluar pranë nesh me nr. 1021/1 prot., datë 12.3.2025.

⁸⁰ Për vitin 2023, kanë qenë regjistruar gjithsej 201 procedime penale.

Faqe | 8016

⁸¹ Për vitin 2023, ishin regjistruar 186 procedime penale me 3335 pajisje fundore.

⁸² Për vitin 2023, kanë qenë regjistruar 67 procedime penale kryesisht.



Prokurorisë së Posaçme, ku janë parashikuar dhe kryer trajnime specifike në fushën e hetimeve financiare, përfshirë ato që lidhen me pastrimin e parave dhe produkteve të veprës penale, si dhe në kuadër të forcimit të luftës kundër krimit të organizuar, trafikimit dhe krimeve të tjera të rënda.

Në vijim të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, sikurse është përmendur në përgjigje të rekomandimit për luftën kundër korrupsionit, Prokuroria e Posaçme ka arritur të sekuestrojë dhe të konfiskojë gjatë vitit 2024 një portofol të diversifikuar asetesh, ku përfshihen: pasuri të paluajtshme, vlera monetare, kuota tregtare dhe portofole kriptovalutash në një vlerë totale prej rreth 65,5 milionë eurosh. Krahasuar me vitin 2023, ku vlera totale e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara ishte rreth 41 milionë, për vitin 2024 është 65,5 milionë euro, pra me një rritje në masën rreth 59,7% më tepër. Po kështu, krahasuar me vitin 2023, vihet re një rritje në masën me rreth 34% t numrit të procedimeve të regjistruara në kuadër të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, nga 35 procedime që ishin në vitin 2023, me 47 procedime në vitin 2024.

Gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme ka vendosur në funksion pothuajse në tërësinë e moduleve të tij (portali, protokolli, zyra e drejtuesit, prokurori, regjistri dhe hetuesi) Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Çështjeve, i cili do të përmirësojë edhe përditësimin e të dhënave statistikore, i cili pritet të përfundojë në vitin 2025 dhe të fillojë funksionimin e tij. Lidhur me përditësimin e të dhënave statistikore, për vitin 2024, numri i çështjeve të regjistruara në Prokurorinë e Posaçme për veprat penale të parashikuara nga nenet 287, 287/“a”, 287/“b” “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale të kryera në kuadër të grupit të strukturuar kriminal” është 38 çështje, me 37 persona nën hetim.

Ndërkohë, numri i çështjeve nën hetim për vitin 2024 (të mbartura dhe të regjistruara) për veprat penale të parashikuara nga nenet 287, 287/“a”, 287/“b”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale të kryera në kuadër të grupit të strukturuar kriminal” është 90 çështje, me

49 persona nën hetim. Për sa i përket, numrit të çështjeve të dërguara në gjykatë me kërkesë për gjykim për vitin 2024 për veprat penale të parashikuara nga nenet 287, 287/“a”, 287/“b” “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale të kryera në kuadër të grupit të strukturuar kriminal”, është 3 çështje, me 8 të pandehur.

Lidhur me bashkëpunimin ndërkombëtar, nën koordinimin edhe të Eurojust, gjatë vitit 2024 ka vijuar bashkëpunimi i frytshëm në krijimin e skuadrave të reja të përbashkëta hetimore dhe vazhdimin e veprimtarisë së atyre ekzistuese. Gjatë vitit 2024, ndërmjet Prokurorisë së Posaçme dhe autoriteteve të huaja janë krijuar 10 skuadra të përbashkëta hetimore të reja. Në total, është 27 numri i skuadrave të përbashkëta hetimore aktive në Prokurorinë e Posaçme, që nga krijimi i saj deri në vitin 2024⁸³. Gjatë vitit 2024, veprimtaria e këtyre skuadrave të përbashkëta hetimore është fokusuar në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit, përfshirë edhe trafikimin e qenieve njerëzore.

Në kuadër të veprimtarisë së Skuadrave të Përbashkëta Hetimore, gjatë vitit 2024 janë mbajtur 18 takime koordinuese me autoritetet e huaja që janë palë në këto skuadra, përveç mbledhjeve të përbashkëta të realizuara nëpërmjet video-konferencës. Kjo veprimtari ka çuar në regjistrimin e 166 shtetasve si persona nën hetim, si dhe në vendosjen nga ana e gjykatave të 147 masave të sigurimit personal. Gjithashtu, gjatë vitit 2024, është rritur ndjeshëm edhe komunikimi i drejtpërdrejtë i Prokurorisë së Posaçme me autoritetet homologe evropiane, amerikane, të Rajonit dhe të Amerikës së Jugut. Po kështu, është intensifikuar shkëmbimi i informacionit nëpërmjet rrjeteve dhe kanaleve të sigurta të komunikimit me Eurojust, Interpol, Europol etj. Prokuroria e Posaçme ka vijuar, gjithashtu, komunikimin intensiv me prokurorët dhe oficerët ndërlidhës që mbulojnë Shqipërinë, të atashuar pranë Ambasadave të huaja në Tiranë apo jashtë Shqipërisë.

Përgjatë vitit 2024 Prokuroria e Posaçme ka përdorur metodën e përgjimit për 163 procedime

⁸³ Në raportin vjetor të SPAK-ut për vitin 2023 cilësohej se për vitet 2020–2023 ishin krijuar 32 skuadra. Ndërsa në materialin e përcjellë nga SPAK-u për vitin 2024 konstatohet pasaktësi, pasi njëherë shprehet se, bashkë me

vitin 2024 janë 27 skuadra hetimore dhe më pas shprehet se, krahas 10 skuadrave të reja janë edhe 27 skuadra paraardhëse.



penale⁸⁴ ku janë interceptuar 3096 pajisje fundore. Krahasuar me vitin 2023, rezulton se kemi një ulje me 23 më pak të përdorimit të metodës së përgjimit dhe një ulje me 239 më pak të pajisjeve fundore të interceptuara ose 7.1% më e ulët. Në lidhje me ekzekutimin e vendimeve penale për vitin 2024 janë ekzekutuar 2046 vendime gjyqate, e cila shënon një rritje në masën rreth 22.6%, në krahasim me 1669 vendime për vitin 2023.

- Forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut

Lidhur me këtë rekomandim nuk ka pasur raportim nga monitorimet ndërkombëtare.

- Nga të dhënat statistikore të dërguara nga Prokuroria e Përgjithshme për vitin 2024⁸⁵ rezulton:

Në lidhje me veprat penale kundër fëmijëve, familjes dhe martesës⁸⁶ rezulton se për vitin 2024 janë regjistruar 1762 çështje penale me 463 persona nën hetim dhe janë marrë 803 të pandehur. Krahasuar me vitin 2023⁸⁷ rezultojnë 268 çështje më shumë të regjistruara, 97 persona më shumë nën hetim, dhe 86 të pandehur më pak. Në lidhje me këtë kategori veprash rezulton se për vitin 2024 janë dërguar për gjykim 1156 çështje me 1228 të pandehur. Krahasuar me një vit më parë⁸⁸ ka një rritje prej 121 çështjesh më tepër të dërguara për gjykim dhe 137 të pandehur më shumë.

Në lidhje me veprën penale “Dhuna në familje” parashikuar nga neni 130/“a” i Kodit Penal, për vitin 2024⁸⁹ janë regjistruar 1656⁹⁰ çështje penale, me 1238⁹¹ persona në hetim/të pandehur ose me rritje 18.6% të procedimeve dhe rritje 14.8% të të pandehurve të regjistruar krahasuar me vitin 2023.

Rezulton se në vitin 2024 për veprën penale “Dhuna në familje” parashikuar nga neni 130/“a” i Kodit Penal janë dërguar për gjykim 1124⁹² procedime me 1194⁹³ të pandehur ose me rritje prej 12.85 % të procedimeve dhe rritje 13.9% e të pandehurve të dërguar për gjykim, në krahasim me vitin 2023.

Lidhur me politikën e dënimit të ndjekur gjatë gjykimit, për veprën penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/“a” i Kodit Penal, Prokuroria e Përgjithshme është shprehur se kërkesat e prokurorit lidhur me masat e sigurimit për personat që kanë kryer këtë veprë penale janë të ashpra, ku 88,86% janë kërkesa për masa sigurimi me arrest, që përbën rritje në krahasim me vitin 2023 ku kërkesat për arrest ishin në masën 87,35%. Kërkesat për caktimin e dënimit për të pandehurit e akuzuar për këtë veprë penale rezultojnë se 64,56%⁹⁴ e kërkesave janë për caktimin e dënimit me burg dhe 34,44%⁹⁵ e kërkesave janë për caktimin e alternativave të dënimit me burg, shifra në rritje krahasuar me vitin 2023.

Nga analiza e të dhënave statistikore, ka rezultuar se: në çështjet e dërguara për gjykim nga prokuroria për veprën penale “Dhuna në familje” është kërkuar në 5 raste dënimi maksimal i parashikuar nga paragrafi përkatës⁹⁶. Gjithashtu, krahasuar me vitin 2023 rezulton se: i. në 1 rast është kërkuar dënimi me gjobë⁹⁷; ii. në 5 raste është kërkuar dënimi sa periudha e paraburgimit⁹⁸; iii. për 90 të pandehur është kërkuar dënimi minimal i parashikuar nga dispozita⁹⁹; iv. për 492 të pandehur është kërkuar dënimi mesatar¹⁰⁰; v. në asnjë rast nuk është kërkuar ulja në minimumin e parashikuar nga dispozita¹⁰¹; vi. për 325 të pandehur është kërkuar

⁸⁴ Për vitin 2023 ishin regjistruar 186 procedime penale me 3335 pajisje fundore.

⁸⁵ Rezultojnë disa pasaktësi të materiali i përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme krahasuar me tabelat statistikore lidhur me veprën penale “Dhuna në Familje”, neni 130/“a” i K.Penal.

⁸⁶ Seksioni IX, nenet 124–130/“a” të Kodit Penal.

⁸⁷ Në vitin 2023, ishin regjistruar 1494 çështje me 380 persona nën hetim dhe 734 të pandehur.

⁸⁸ Në vitin 2023, ishin dërguar për gjykim 1035 çështje me 1091 të pandehur.

⁸⁹ Të dhënat janë marrë nga tabelat statistikore të PP-së.

⁹⁰ Për vitin 2023, ka qenë 1396 çështje penale.

⁹¹ Për vitin 2023, kanë qenë të pandehur dhe persona nën hetim 1078 persona.

⁹² Për vitin 2023, kanë qenë 996 çështje të dërguara për gjykim.

Faqe | 8018

⁹³ Për vitin 2023, kanë qenë të pandehur 1048 persona.

⁹⁴ Për vitin 2023, ka qenë 61.82 % kërkesat për caktimin e dënimit me burg.

⁹⁵ Për vitin 2023, ka qenë 38.18 % e kërkesave për dënim alternativ.

⁹⁶ Në vitin 2023, nuk ka pasur asnjë rast dënimi maksimal.

⁹⁷ Në vitin 2023, dënimi me gjobë nuk është kërkuar në asnjë rast.

⁹⁸ Në vitin 2023, në asnjë rast nuk është kërkuar dënimi sa periudha e paraburgimit.

⁹⁹ Në vitin 2023, dënimi minimal është kërkuar për 102 të pandehur.

¹⁰⁰ Në vitin 2023, dënimi mesatar është kërkuar për 287 të pandehur.

¹⁰¹ Në vitin 2023, në asnjë rast nuk është kërkuar ulja në minimumin e parashikuar nga dispozita.



pezullimi i ekzekutimit të dënimit¹⁰²; vii. në 4 raste është kërkuar tërheqja e akteve¹⁰³; viii. në 2 raste është kërkuar pushimi i akuzës¹⁰⁴; ix. për 34 të pandehur është kërkuar pushimi i çështjes¹⁰⁵; dhe x. në 4 raste është kërkuar pafajësi¹⁰⁶.

Për sa më sipër kemi: *rritje* të numrit me 5 raste të dënimit në maksimum, *rritje* me 1 rast të dënimit me gjobë, *rritje* me 5 raste të dënimit sa periudha e paraburgimit, *ulje* me 12 raste më pak të dënimit në minimum, *rritje* me 205 raste të dënimit mesatar, *rritje* me 85 raste të pezullimit të ekzekutimit të dënimit, *rritje* me 29 raste të pushimit të çështjes, *rritje* me 4 raste ku është kërkuar tërheqja e akteve, *rritje* me 4 raste ku është kërkuar pafajësia dhe *rritje* me 1 rast të pushimit të akuzës.

Nga të dhënat statistikore rezulton se në çështjet penale të regjistruara gjatë vitit 2024, janë regjistruar 722 procedime/çështje me 747¹⁰⁷ viktima të mitura, prej të cilëve 370 femra dhe 377¹⁰⁸ meshkuj. Krahasuar me vitin 2023, konstatohet ulje e procedimeve me 48 më pak se në vitin 2023, ulje në tërësi e numrit të viktimave të mitur me 60 viktima të mitur më pak, nga të cilët 84 viktima meshkuj më pak, dhe rritje me 24 viktima femra më shumë.

Nga të dhënat e përcjella nga Prokuroria e Përgjithshme për të miturit në konflikt me ligjin për vitin 2024, janë regjistruar 835¹⁰⁹ procedime penale, ku përfshihen të mitur në konflikt me ligjin me ulje prej 6,29 % krahasuar me vitin 2023. Janë regjistruar 720¹¹⁰ të mitur në konflikt me ligjin si të pandehur ose persona nën hetim, me një ulje prej 3,49% të numrit të të pandehurve/personave

nën hetim të mitur në konflikt me ligjin krahasuar me vitin 2023.

Referuar të dhënave statistikore për vitin 2024, për grupveprat penale në fushën e mjedisit¹¹¹, rezulton se janë regjistruar 299¹¹² procedime penale me 55 persona të pandehur¹¹³ ose me ulje 12.83% të numrit të procedimeve dhe ulje me 24.66% të të pandehurve të regjistruar krahasuar me vitin 2023. Janë dërguar për gjykim 55¹¹⁴ procedime me 78¹¹⁵ të pandehur ose me ulje 8,33 % të procedimeve dërguar gjyqit dhe rritje 13,04 % të të pandehurve të dërguar për gjykim, në krahasim me vitin 2023.

Referuar të dhënave statistikore të përcjella nga Prokuroria e Përgjithshme për vitin 2024 në prokuroritë pranë gjykatave me juridiksion të përgjithshëm, **numri i çështjeve të përfunduara në zbatim të instituteve të reja procedurale penale**¹¹⁶ është 607¹¹⁷ çështje, me 616¹¹⁸ të pandehur. Në lidhje me këto institute të reja procedurale, rezulton se për 91¹¹⁹ çështje për kundërvajtje penale është kërkuar miratimi i urdhrit penal me 92¹²⁰ të pandehur, ku krahasuar me 2023-shin rezulton me ulje 33.09% të çështjeve, për 183¹²¹ çështje me 191¹²² të pandehur është kërkuar miratimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë, ku rezulton rritje me 27.97% të çështjeve të krahasuara me vitin 2023, për 333¹²³ çështje me 333¹²⁴ të pandehur është kërkuar gjyrimi i drejtpërdrejtë, një rritje me 17.67% të çështjeve krahasuar me vitin 2023.

Nga të dhënat statistikore të sipërpërmendura rezulton se për institutet procedurale penale: urdhri penal ka pësuar ulje krahasuar me vitin 2023, ndërsa

¹⁰² Në vitin 2023, pezullimi i ekzekutimit është kërkuar në 240 raste.

¹⁰³ Në vitin 2023, tërheqja e akteve nuk është kërkuar në asnjë rast.

¹⁰⁴ Në vitin 2023, pushimi i akuzës është kërkuar në 1 rast.

¹⁰⁵ Në vitin 2023, për 5 të pandehur është kërkuar pushimi i çështjes.

¹⁰⁶ Në vitin 2023, pafajësia nuk është kërkuar në asnjë rast.

¹⁰⁷ Për vitin 2023, kanë qenë regjistruar 770 procedime me 807 viktima të mitur.

¹⁰⁸ Për vitin 2023, kanë qenë 346 femra dhe 461 meshkuj.

¹⁰⁹ Për vitin 2023, kanë qenë regjistruar 891 procedime penale.

¹¹⁰ Për vitin 2023, kanë qenë regjistruar 746 të mitur.

¹¹¹ Nenet 201–207, nenet 207/“a”, 207/“b”, 207/“c” dhe 207/“ç” të Kodit Penal, përfshirë ndryshimet e reja të vitit 2021.

¹¹² Në vitin 2023, janë regjistruar 343 çështje penale.

¹¹³ Në vitin 2023, janë 73 të pandehur për procedimet penale të regjistruara.

¹¹⁴ Në vitin 2023 janë dërguar për gjykim 60 procedime.

¹¹⁵ Në vitin 2023 janë dërguar për gjykim 69 të pandehur.

¹¹⁶ Referuar shkresave të Prokurorisë së Përgjithshme me nr. 622/51 prot., datë 11.3.2025, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 1522 prot., datë 12.3.2025 dhe shkresën nr. 622/54 prot., datë 17.3.2025, protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. 1021/2 prot., datë 17.3.2025.

¹¹⁷ Për vitin 2023 ka qenë 562 çështje.

¹¹⁸ Për vitin 2023 ka qenë 573 të pandehur.

¹¹⁹ Për vitin 2023 ka qenë 136 çështje.

¹²⁰ Për vitin 2023 ka qenë 139 të pandehur.

¹²¹ Për vitin 2023 ka qenë 143 çështje.

¹²² Për vitin 2023 ka qenë 148 të pandehur.

¹²³ Për vitin 2023 ka qenë 283 çështje.

¹²⁴ Për vitin 2023 ka qenë 286 të pandehur.



marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe gjykimi i drejtpërdrejtë kanë pësuar rritje.

Lidhur me rekomandimin për vijimin e aplikimit të masave alternative të parashikuara nga Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur (shmangies) rezulton se, Prokuroria e Përgjithshme ka vijuar mbikëqyrjen e zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 8, datë 15.11.2021, “*Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive për veprat penale me të mitur në konflikt me ligjin, viktimë dhe/ose dëshmitarë*”, veçanërisht dispozitat që normojnë shmangien e të miturve në konflikt me ligjin nga ndjekja penale dhe nga dënimi përmes masave alternative, si dhe që udhëzojnë që në kërkesat për caktimin e masave të sigurimit dhe/ose për caktimin e dënimit ndaj të miturit, në çdo rast, prokurori vlerëson dhe konsideron parësore interesin më të lartë të fëmijës që është rehabilitimi dhe riintegrimi i tij në shoqëri.

Ndaj të miturve në konflikt me ligjin janë vendosur 27¹²⁵ masa sigurimi personal arrest në burg ose për rreth 3.75% të të miturve të pandehur ose persona nën hetim, tregues në ulje krahasuar me 4.83% që përbënte ky raport për vitin 2023. Lidhur me vendimmarrjen e prokurorit për çështjet ku përfshihen të miturit në konflikt me ligjin evidentohet se: i. është vendosur mosfillimi i procedimit për 624¹²⁶ referime/kallëzime penale ndaj të miturve ose me rritje prej 3,48 % krahasuar me vitin 2023; ii. janë pushuar 401 çështje me 411¹²⁷ të pandehur të mitur ose me rritje 13,59 % të çështjeve të pushuara krahasuar me vitin 2023 dhe janë dërguar për gjykim 207 çështje me 246¹²⁸ të pandehur të mitur në konflikt me ligjin ose me rritje 16,29 % të çështjeve të dërguara për gjykim krahasuar me vitin 2023.

Lidhur me aplikimin e masave alternative të shmangies rezulton se në kuadrin e procedimeve të mosfilluara në 52¹²⁹ raste është aplikuar shmangia, nga të cilat: në 4 raste është vendosur paralajmërim me gojë, në 44¹³⁰ raste është vendosur paralajmërim me shkrim dhe në 4 raste është vendosur këshillim.

Ndërkohë për çështjet e pushuara në 360¹³¹ raste është aplikuar shmangia ndër të cilat në 80 raste është vendosur këshillim, në 21 raste është vendosur paralajmërim me gojë, në 259 raste është vendosur paralajmërim me shkrim¹³².

Referuar të dhënave statistikore rezulton se janë regjistruar 722 procedime/çështje me 747¹³³ viktima të mitura, prej të cilëve 370 femra dhe 377¹³⁴ meshkuj, ulje me 6.23% e çështjeve krahasuar me vitin 2023.

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe për hetimin e ndjekjen penale të krimeve kundër të miturve janë realizuar aktivitete me koordinatorët e viktimave, prokurorë dhe oficerë organizuar nga UNICEF, Organizata Ndërkombëtare e Policisë (IPO), shoqata *Terre des Hommes*, Qendra për Parandalimin e Krimit të të Miturve dhe të Rinjve. Gjithashtu, është përgatitur dhe një draft protokoll për punën e koordinatorit të viktimave.

Nga Shkolla e Magjistraturës janë organizuar trajnime në këtë fushë me pjesëmarrjen në total të 33 prokurorëve dhe 21 oficerëve të policisë gjyqësore.

Është vijuar zbatimi i udhëzimit të përgjithshëm nr. 5/2024 dhe udhëzimit të përgjithshëm nr. 9, datë 21.12.2021, “*Për marrëveshjen mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe për caktimin e dënimit*”, me qëllim rritjen e zbatimit të instituteve të ndryshme procedurale penale dhe problematikat e praktikat e mira të zbatimit të tyre.

Nga të dhënat statistikore të sipërpërmendura rezulton se tendenca e zbatimit të instituteve procedurale penale është e tillë ku marrëveshja për pranimin e fajësisë ka pësuar rritje krahasuar me vitin 2023 dhe urdhri penal ka pësuar ulje krahasuar me vitin 2023. Ndërsa kërkesat për gjykim të drejtpërdrejtë kanë vijuar të ruajnë tendencën e rritjes dhe krahasuar me vitin 2023 kanë pësuar një rritje me 50 kërkesa më tepër.

¹²⁵ Për vitin 2023 kanë qenë vendosur 16 masa sigurimi personal.

¹²⁶ Për vitin 2023 është vendosur mosfillimi i procedimit për 603 raste.

¹²⁷ Për vitin 2023 kanë qenë pushuar 353 çështje me 353 të pandehur të mitur.

¹²⁸ Për vitin 2023 kanë qenë dërguar për gjykim 178 çështje me 195 të pandehur të mitur.

¹²⁹ Për vitin 2023 është aplikuar shmangia në 87 raste.

¹³⁰ Për vitin 2023 në 8 raste është vendosur paralajmërim me gojë dhe në 79 raste paralajmërim me shkrim.

¹³¹ Për vitin 2023 për çështjet e pushuara është aplikuar shmangia për 326 raste.

¹³² Për vitin 2023 është vendosur në 2 raste këshillim, në 39 raste paralajmërim me gojë, në 282 raste paralajmërim me shkrim dhe në 3 raste masë detyruese.

¹³³ Për vitin 2023 kanë qenë regjistruar 770 procedime me 807 viktima të mitur.

¹³⁴ Për vitin 2023 kanë qenë 346 femra dhe 461 meshkuj.



Prokurorët janë udhëzuar në ashpërsimin e kërkesave për caktimin e masave të sigurimit personal dhe për caktimin e llojit dhe masës së dënimit për veprat penale me bazë gjinore, krimet seksuale, diskriminuese, të keqtrajtimit / abuzimit / shfrytëzimit të trafikimit të fëmijëve dhe/ose vepra penale të tjera të përfshira në rekomandim, me synim rritjen e efektivitetit në luftën kundër këtyre krimeve dhe parandalimin e posaçëm dhe të përgjithshëm të kriminalitetit ndaj të miturit, dhunës në familje, dhunës gjinore, dhunës me bazë urrejtjeje, abuzimit të të miturve dhe krimeve seksuale. Është nxjerrë qarkorja nr. 1398/1 prot., datë 4.12.2024, në zbatim të udhëzimeve të përgjithshme nr. 17/2020 dhe nr. 5/2018, përmes së cilës kërkohet marrja e masave për të garantuar të drejtën e viktimës për informacion për gjendjen e procedimit, disponimin mbi kërkesat e palëve dhe garantimin e plotshmërisë së hetimeve dhe respektimit të afateve procedurale, si dhe me rekomandimet për përmbushjen e rolit të prokurorit në lidhje me të drejtat e viktimave dhe dëshmitarëve në procesin penal.

Në lidhje me veprën penale “Krimet seksuale”, për vitin 2024 vërehet se janë regjistruar 161¹³⁵ procedime penale, me rritje 29,83 % të procedimeve dhe me 87¹³⁶ të pandehur ose me rritje 26,09% të numrit të të pandehurve të regjistruar, krahasuar me vitin 2023. Gjithashtu, janë dërguar për gjykim 81¹³⁷ procedime me 85¹³⁸ të pandehur, ku rezulton me rritje 52,83% të procedimeve dhe rritje 46,55 % të të pandehurve të dërguar për gjykim, në krahasim me vitin 2023.

Lidhur me masat e sigurimit personal për veprën penale “Krimet seksuale”, rezulton ashpërsim i masave, ku të gjitha kërkesat janë për masa sigurimi me arrest. E njëjta politikë vërehet edhe në lidhje me kërkesat për caktimin e dënimit për të pandehurit e akuzuar për këto krime, kështu 85,94% e kërkesave janë për caktimin e dënimit me burg dhe vetëm 14,06% për caktimin e alternativave të dënimit me

burg. Pra, rezulton një ulje e lehtë e kërkesave për caktimin e dënimit me burgim me 1.36%¹³⁹ dhe një rritje e lehtë e kërkesave të caktimit të alternativave të dënimit me burg me 1.36%¹⁴⁰.

Në lidhje me veprën penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/“a” i Kodit Penal, për vitin 2024 janë regjistruar 1759¹⁴¹ çështje penale, me 1264¹⁴² të pandehur ose me rritje 46,55% të procedimeve dhe rritje 13,67% të të pandehurve të regjistruar krahasuar me vitin 2023. Janë dërguar për gjykim 1156 procedime me 1228 të pandehur ose me rritje prej 11,79 % të procedimeve dhe rritje 12,76% e të pandehurve të dërguar për gjykim, në krahasim me vitin 2023. Çështjet e dërguara në gjyq janë në përqindje më të lartë se ato të pushuara, përkatësisht 79,45%¹⁴³ dërguar gjyqit dhe 20,55%¹⁴⁴ të pushuara. Pra, rezulton se efektiviteti i ndjekjes penale është i lartë në kryerjen e hetimeve dhe ndjekjen për veprën penale të dhunës në familje në vitin 2024, ku evidentohet se kemi një rritje prej 11.79% e procedimeve të dërguara për gjykim krahasuar me vitin 2023.

Lidhur me ashpërsimin e politikës penale të dënimit për veprën penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/“a” i Kodit Penal, Prokuroria e Përgjithshme është shprehur se kërkesat e prokurorit, lidhur me masat e sigurimit për personat që kanë kryer këtë vepër penale janë të ashpra, ku 88,86% janë kërkesa për masa sigurimi me arrest, që përbën rritje në krahasim me vitin 2023 ku kërkesat për arrest ishin më masën 87,35%. Kërkesat për caktimin e dënimit për të pandehurit e akuzuar për këtë vepër penale rezultojnë se 64,56%¹⁴⁵ e kërkesave janë për caktimin e dënimit me burg dhe 34,44%¹⁴⁶ e kërkesave janë për caktimin e alternativave të dënimit me burg, shifra në rritje krahasuar me vitin 2023.

Ndërkohë, një sfidë që kërkon, gjithashtu, reagim multidimensional është ajo e disa formave të dhunës ndaj këtyre subjekteve e kryer nëpërmjet mjeteve të teknologjisë dhe informacionit, që sjell një dëm më

¹³⁵ Në vitin 2023 janë regjistruar 124 procedime penale.

¹³⁶ Në vitin 2023 kanë qenë 69 të pandehur të regjistruar.

¹³⁷ Në vitin 2023 janë dërguar për gjykim 53 procedime.

¹³⁸ Në vitin 2023 kanë qenë 58 të pandehur të dërguar për gjykim.

¹³⁹ Në vitin 2023 ka qenë 87.3% kërkesa për caktimit e dënimit me burg.

¹⁴⁰ Në vitin 2023 ka qenë 12.7% kërkesa për caktimit e alternativave të dënimit me burg.

¹⁴¹ Për vitin 2023 ka qenë 1396 çështje penale.

¹⁴² Për vitin 2023 kanë qenë të pandehur dhe persona nën hetim 1078 persona.

¹⁴³ Për vitin 2023 çështjet e dërguara në gjyq janë 71.35% e numrit total të çështjeve të regjistruara.

¹⁴⁴ Për vitin 2023 çështjet e pushuara janë 21.35% e numrit total të çështjeve të regjistruara.

¹⁴⁵ Për vitin 2023 ka qenë 61.82 % kërkesat për caktimin e dënimit me burg.

¹⁴⁶ Për vitin 2023 ka qenë 38.18 % kërkesave për dënim alternativ.



të rëndë ndaj integritetit psikologjik të viktimës për shkak edhe të përhapjes/masivitetit. Në këtë kuadër, në maj 2024, Bashkimi Evropian ka miratuar direktivën (EU) nr. 2024/1385 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, “*Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunën në familje*”, e cila u kërkon shteteve plotësimin dhe harmonizimin e legjislacionit penal me forma të dhunës *online* ose kibernetike (dhuna lidhet thelbësisht me përdorimin e mjeteve të teknologjisë dhe informacionit), të penalizojnë me masa dënimi efektive, propocionale dhe frenuese dhunën kibernetike dhe të sigurojnë mbrojtje efektive të viktimave.

Për sa më sipër, Prokuroria e Përgjithshme vlerëson se është e nevojshme ndërhyrja legjislative që akte si përndjekja kibernetike, ngacmimi kibernetik, shpërndarja pa pëlqim e materialeve/imazheve intime, etj., të kualifikohen si vepra penale të posaçme dhe të marrin përgjigjen e duhur sipas rëndësisë dhe pasojës që kanë.

Në vijim të masave institucionale të ndërmarra për luftën kundër kriminalitetit, lidhur me veprat penale me natyrë diskriminuese, Prokurori i Përgjithshëm nxori qarkoren nr. 645/1 prot., datë 30.7.2024, përmes së cilës janë përcjellë për zbatim në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm rekomandimet e Komitetit të OKB-së për Eliminimin e Diskriminimit Racor, duke kërkuar vëmendje të posaçme për veprat penale me natyrë diskriminuese, mbajtja e të dhënave statistikore dhe forcimin e kapaciteteve në këtë drejtim.

Lidhur me kategorinë e veprave penale dhe/ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, personave vulnerabël dhe personave me probleme shëndetësore, të cilët mund të jenë autorë të drejtpërdrejtë të veprës/ave penale dhe/ose bashkëpunëtorë apo bashkautorë të përfshirë me persona të tjerë në kryerjen e veprës penale, në trajtimin e tyre sipas specifikave dhe kërkesat për caktimin e dënimit ndaj tyre, në udhëzimin e përgjithshëm nr. 5/2024, prokurorët janë udhëzuar për të ndjekur një politikë penale eficiente dhe efektive, duke analizuar, vlerësuar dhe arsyetuar në aktet/kërkesat/konkluzionet përkatëse, si referuar në rrethanat e faktit të bazuara në prova, ashtu dhe në kushtet/kriteret ligjore, për zbutjen e dënimit apo aplikimin e dënimeve alternative, sipas cilësive të veçanta të subjekteve përkatëse, për t’u konsideruar si rrethana lehtësuese në kuptim dhe zbatim të nenit 49 të Kodit Penal. Mungesa e një sistemi elektronik

për mbledhjen e të dhënave/statistikave në prokurori, nuk mundëson analizën e të dhënave për secilën nga këto kategori subjektsh.

Në përmbushje dhe të rekomandimeve të Këshillit të Evropës për uljen e mbipopullimit në sistemin e paraburgimit, si dhe në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (çështja Hysa kundër Shqipërisë, etj.), Prokurori i Përgjithshëm miratoi udhëzimin e përgjithshëm nr. 7/2024, “*Për masat e sigurimit*”. për nxitjen e zbatimit uniform të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, në përputhje me të drejtën dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që lidhen me caktimin dhe zbatimin e masave të sigurimit.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar trajtimit të kërkesës për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, duke udhëzuar kerkimin e saj si masë e fundit, nëse ajo është e vetmja masë që garanton vijimin normal të procesit apo sigurinë publike, si dhe hetimi me përparësi i çështjeve me të paraburgosur dhe mbrojtja nga dhuna në paraburgim.

Lidhur me rekomandimin për rritjen e vëmendjes ndaj veprave penale në fushën e mjedisit, Prokuroria e Përgjithshme ka qenë përfituese në kuadrin e Projektit të OSBE-së për “*Rritjen e sigurisë dhe qeverisjes mjedisore në Shqipëri*”, projekt i cili ka synuar të ndihmojë forcimin e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, lidhur me hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e veprave penale kundër mjedisit, dhe organizimin e trajnimeve të përbashkëta me aktorët e përfshirë në luftën kundër veprave penale në fushën e mjedisit. Konkretisht në aktivitetet e organizuara nga OSBE-ja, KIE dhe projekti Eu4LEA kanë marrë pjesë në total 13 prokurorë.

Lidhur me rritjen e kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve për veprat penale me bazë gjinore, seksuale dhe përfshirjen e të miturve, krimin kibernetik dhe veprat penale mjedisore, ka vijuar bashkëpunimi i Prokurorisë së Përgjithshme me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare dhe me mbështetjen e Ambasadës të Mbretërisë së Holandës, në kuadër të projektit “*Angazhim proaktiv për mbrojtjen dhe zbatimin e ligjit kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje*”. Në kuadër të këtij projekti janë zhvilluar sesione trajnuese për prokurorët, koordinatorët në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm dhe oficerët e policisë gjyqësore, ku



kanë marrë pjesë 20 prokurorë, 20 koordinatorë dhe 7 oficerë të policisë gjyqësore.

- Forcimi i Bashkëpunimit Ndërinstitucional

- Nga Prokuroria e Përgjithshme rezulton se:

Lidhur me rekomandimin forcimi i luftës kundër informalitetit, duke rritur numrin e çështjeve të regjistruara e të dërguara për gjykim për grupveprat penale në fushën e taksave dhe tatimeve, Prokuroria e Përgjithshme sërish përmend zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm nr. 5/2024, të memorandumit të bashkëpunimit “Për rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimet financiare dhe sekuestrimin e konfiskimin e aseteve kriminale, në funksion të përmbushjes së rekomandimeve të KSA-së e FATF-së dhe planit të veprimit ICRG/FATF” dhe udhëzimit të përgjithshëm nr. 10/2020, “Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave e krimeve financiare dhe financimin e terrorizmit, dhe në hetimet pasurore në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”.

Gjatë vitit 2024, për grupveprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet¹⁴⁷ rezulton se janë regjistruar 199 procedime penale me 22 të pandehur për këto vepra penale¹⁴⁸, me një rritje të lehtë prej 6.4% të numrit të procedimeve të regjistruara krahasuar me vitin 2023. Janë dërguar për gjykim 49¹⁴⁹ çështje penale me ulje prej 22.2% të numrit të procedimeve krahasuar me vitin 2023, si dhe me 66¹⁵⁰ të pandehur të dërguar për gjykim, ku krahasuar me vitin 2023 ka një ulje prej 57.7% të numrit të të pandehurve të dërguar për gjykim.

Krahasuar me vitin 2023¹⁵¹, konstatohet se kemi një rritje të referimeve nga Policia e Shtetit me 1998 raste më shumë, rritje të referimeve nga policia elektrike me 6 raste më shumë, rritje nga policitë e tjera me 120 raste më shumë, rritje për policinë financiare me 50 raste më shumë të referuara, si dhe ulje për policinë pyjore me 2 raste më pak të referuara dhe ulje për policinë e ndërtimit me 3 raste më pak të referuara krahasuar me vitin 2023.

Referuar të dhënave statistikore për grupveprat penale, në lidhje me krimet në fushën e doganave, në vitin 2024, evidentohet se janë regjistruar 338 procedime penale me 218 të pandehur¹⁵² ose me rritje prej 39.7% e numrit të procedimeve dhe rritje prej 3.32% të numrit të të pandehurve krahasuar me vitin 2023. Gjithashtu, për këtë grupveprash penale janë dërguar për gjykim 181 procedime penale me 242¹⁵³ të pandehur ose me rritje 10.37% të numrit të procedimeve dhe rritje 11.52% të të pandehurve të dërguar për gjykim për këtë grupveprash krahasuar me vitin 2023.

Në drejtim të forcimit të kapaciteteve në përmirësimin e veprimtarisë hetimore, lidhur me këto vepra, janë zhvilluar një sërë trajnimesh me pjesëmarrjen e 13 prokurorëve dhe 18 oficerëve të policisë gjyqësore.

Lidhur me rekomandimin për rritjen e vëmendjes, në lidhje me veprat penale të krimit kibernetik, në kushtet kur veprimtaria kriminale ndërmjet teknologjisë dhe drejtuar asaj, është gjithmonë e më tepër në rritje, për të rritur kapacitetet profesionale në hetimin e këtyre veprave penale, konsolidimi i kapaciteteve, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ai ndërinstitucional është shumë i rëndësishëm. Në drejtim të forcimit të kapaciteteve dhe udhëzimit nr. 5/2024, janë inkurajuar trajnimet në këtë fushë organizuar nga OSBE-ja dhe Shkolla e Magjistraturës.

Në vijim të aktiviteteve, Prokurori i Përgjithshëm ka zhvilluar një takim me ambasadorin e OSBE-së në Tiranë ku u diskutua për bashkëpunimin e deritanishëm dhe asistencën e dhënë nga OSBE-ja për sistemin e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm në organizimin e trajnimeve për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore me fokus tek provat elektronike dhe krimi kibernetik, në kuadër edhe të manualit përkatës, hartimi i të cilit u realizua nga OSBE-ja.

Prokuroria e Përgjithshme ka nxjerrë qarkoren nr. 1009 prot., datë 26.7.2024, lidhur me bashkëpunimin me Njësinë e Koordinimit 24/7 në

¹⁴⁷ Referuar neneve 180–182/“a” të Kodit Penal.

¹⁴⁸ Për vitin 2023 janë regjistruar 187 procedime penale me 55 të pandehur për veprat penale, në lidhje me taksat dhe tatimet.

¹⁴⁹ Për vitin 2023 janë dërguar për gjykim 63 çështje penale.

¹⁵⁰ Për vitin 2023 janë 156 të pandehur të dërguar për gjykim.

¹⁵¹ Të dhënat për vitin 2023 kanë qenë: 31925 referime nga policia e shtetit; 9 referime nga policia financiare; 10

referime nga policia e ndërtimit; 6 referime nga policia pyjore; nga policia elektrike janë referuar 1 raste dhe 467 referime nga policitë e tjera.

¹⁵² Për vitin 2023 kanë qenë regjistruar 242 procedime penale me 211 të pandehur.

¹⁵³ Për vitin 2023 kanë qenë dërguar për gjykim 164 procedime penale me 217 të pandehur.



Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pjesë e Drejtorisë së Hetimit të Krimit Kibernetik, për të siguruar ndihmë teknike, lidhur me krimin kibernetik, informacion nga pika kontakti të shteteve të tjera për marrjen e provave, informacion për vendndodhjen e personave të dyshuar, si dhe çdo informacion tjetër të domosdoshëm për hetimin e veprave penale në këtë fushë.

Lidhur me të dhënat statistikore për grupveprat penale të krimit kibernetik, gjatë vitit 2024 rezultojnë një rritje prej 4,96% e numrit të procedimeve të regjistruara, nga 363 në 381 procedime penale, si dhe një rritje prej 14,29% e të pandehurve të regjistruar nga 21 në 24, krahasuar me vitin 2023. Numri i procedimeve të dërguara për gjykim rezultojnë me rritje, nga 12 procedime në 23 procedime penale ose një rritje prej 91,67%, ndërkohë që dhe numri i të pandehurve të dërguar për gjykim është rritur në 65 të pandehur ose 3,6 herë krahasuar me vitin 2023.¹⁵⁴

Kështu: i. Lidhur me veprën penale “*Pornografia*”, parashikuar nga neni 117 i Kodit Penal, vërehet rritje 52,94% e numrit të procedimeve të regjistruara për vitin 2024, krahasuar me vitin 2023, nga 51 në 78. Po ashtu rezultojnë rritje e numrit të të pandehurve të regjistruar nga 1 në 8 të pandehur. Sa i përket numrit të procedimeve dërguar për gjykim krahasuar me vitin 2023, rezultojnë rritje nga 2 në 4 procedime penale dhe rritje nga 2 të pandehur në 6 të pandehur të dërguar për gjykim;

ii. Lidhur me veprën penale “*Mashtrimi kompjuterik*”, parashikuar nga neni 143/“b” i Kodit Penal, gjatë vitit 2024 vërehet se janë regjistruar 89 procedime ose ulje 19,09% ndaj 110 procedimeve penale të regjistruara për vitin 2023, ndërkohë që procedimet e dërguara për gjykim janë rritur nga 5 në vitin 2023 në 7 në vitin 2024. Ndërkohë që kemi një rritje domethënëse të të pandehurve të dërguar gjyqit, nga 11 të pandehur në vitin 2023 në 46 të pandehur në vitin 2024;

iii. Lidhur me veprën penale “*Falsifikimi kompjuterik*”, parashikuar nga neni 186/“a” i Kodit Penal, gjatë vitit 2024 vërehet rritje 10,53 % e procedimeve penale të regjistruara, e konkretisht nga 95 në 105 dhe rritje të procedimeve të dërguara për

gjykim nga 4 në 9 procedime penale, si dhe rritje nga 4 në 10 të të pandehurve të dërguar për gjykim;

iii. Lidhur me veprën penale “*Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike*”, parashikuar nga neni 293/“b” i Kodit Penal, gjatë vitit 2024 vërehet rritje 2,44% e procedimeve penale të regjistruara, konkretisht nga 82 në 84 procedime penale;

iv. Lidhur me veprën penale “*Ndërhyrja në sistemet kompjuterike*”, parashikuar nga neni 293/“c” i Kodit Penal, gjatë vitit 2024 vërehet rritje e konsiderueshme e procedimeve penale të regjistruara, konkretisht nga 3 në 12 procedime, ndërkohë 1 procedim është dërguar për gjykim.

Ndihma e ndërsjellë juridike me autoritetet e huaja është shumë e rëndësishme në hetimin dhe përfundimin e suksesshëm të hetimit të krimit kibernetik dhe nga të dhënat për vitin 2024 rezultojnë 97 kërkesa për ndihmë juridike, 85 prej të cilave janë letërporosi për jashtë. Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, vlen për t’u theksuar mbështetja nga ana e Prokurorisë së Posaçme, e cila ka vënë në dispozicion ekspertizën e saj teknologjike për hetimin e çështjeve të rëndësishme në prokurori të juridiksionit të përgjithshëm.

Prokuroria e Përgjithshme, për rritjen e cilësisë dhe eficiencës në hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale dhe prioriteteve në luftën kundër kriminalitetit, i ka kushtuar një vëmendje të veçantë bashkëpunimit dinamik në nivel vendor në punën e përditshme të drejtuesve, prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore. Bashkëpunimi në nivel qendror dhe vendor ka vijuar edhe në kuadër të realizimit të detyrimeve të marra përsipër në marrëveshje të përbashkëta të Prokurorisë së Përgjithshme, me Prokurorinë e Posaçme, me Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, etj.

¹⁵⁴ Rezultojnë disa pasaktësi në raportin e Prokurorisë së Përgjithshme për këtë vit, pasi në raportin e vjetshëm ka raportuar të tjera shifra për vitin 2023 e konkretisht: Lidhur me të dhënat statistikore për grupveprat penale të krimit kibernetik gjatë vitit 2023 rezultojnë një rritje prej 22,35% e numrit të procedimeve

të regjistruara, nga 255 në 312 procedime penale. Numri i procedimeve të dërguara për gjykim rezultojnë me rritje, nga 7 procedime në 10 procedime penale, ndërkohë që dhe numri i të pandehurve dërguar për gjykim është rritur nga 13 në 16.



Në korrik, në vijim të bashkërendimit të punës për përcaktimin e rregullave të unifikuara, lidhur me përkthimin e akteve në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale, ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, është miratuar udhëzimi i përbashkët nr. 6, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për formën e kërkesës, procedurën dhe përkthimin e akteve në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”. Vlen të përmendet, gjithashtu, bashkëpunimi me zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm Evropian, e cila në vitin 2024 ka dërguar pranë Prokurorisë së Përgjithshme në rrugë elektronike kërkesën për ndihmë juridike së Zyrës së Prokurorit Publik Evropian në Romë/Itali, në kuadër të çështjes penale për veprat penale “*Mashtrim i rëndë për marrjen e fondeve publike, mashtrim i rëndë për marrjen e fondeve publike evropiane, dhe krime të tjera në fushën e taksave*”.

Për t'u theksuar është edhe marrëveshja për krijimin e një skuadre të përbashkët hetimore, në qershor 2024, ndërmjet njëres nga prokuroritë shqiptare të juridiksionit të përgjithshëm dhe prokurorisë kompetente kosovare, pasi pas hetimeve të kryera rezultoi se shtetas shqiptarë dhe kosovarë janë përfshirë në aktivitetin kriminal të trafikimit dhe mbajtjes pa leje të armëve dhe municioneve luftarake. Aktiviteti hetimor, në kuadër të kësaj skuadre, mbështetet financiarisht nga institucionet respektive, si dhe nëse do të lind nevoja nga ana e projektit të menaxhuar nga Eurojust, WB CRIM JUST – Rritja e bashkëpunimit ndërkufitar në drejtësinë penale në Ballkanin Perëndimor. Kjo është skuadra e parë e përbashkët hetimore e krijuar në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm.

Prokurori i Përgjithshëm, në kuadrin e kërkesave të Rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimeve të Këshillit të Ministrave, si dhe në kuadrin e implementimit të reformës ligjore në sistemin e prokurorisë, me synim për të normuar veprimtarinë administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, gjatë vitit 2024, ka vlerësuar detyrimet dhe nevojat për nxjerrjen e akteve të reja normative dhe/ose ndryshime/plotësime të atyre në fuqi, si dhe marrëveshjeve të përbashkëta ndër të cilët mund të veçojmë, si vijojnë:

Udhëzimet e përgjithshme të miratuara nga Prokurori Përgjithshëm, janë:

- “Për përdorimin e platformës elektronike për raportimin e të dhënave për korrupsionin dhe krimin e organizuar” nr. 3, datë 25.4.2024;

- “Për zbatimin e ligjit nr. 33/2024, ‘Për dhënie amnistie’”, nr. 4, datë 24.4.2024;

- “Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2024, në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, nr. 5, datë 12.5.2023;

- “Për hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër trafikimit të personave”, nr. 6, datë 3.7.2024;

- “Për masat e sigurimit”, nr. 7, datë 23.7.2024;

- “Efektiviteti i shërbimit të gatishmërisë”, nr. 8, datë 23.7.2024.

Udhëzimet e prokurorit të përgjithshëm janë:

- “Për ngritjen e grupit të ekspertëve mbështetës për sistemin e qendëruar të çështjeve në prokurori”, nr. 4, datë 3.1.2024;

- “Për caktimin e strukturës faktike në Prokurorinë e Përgjithshme”, nr. 18, datë 30.1.2024;

- “Për caktimin e strukturave të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë dhe apelit të juridiksionit të përgjithshëm”, nr. 19, datë 30.1.2024;

- “Për inspektimin tematik për saktësinë e veprimtarisë së oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve të policisë gjyqësore në prokuroritë Durrës, Lezhë dhe Fier”, nr. 35, datë 4.4.2024;

- “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2024”, nr. 53, datë 16.5.2024;

- “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit, datë 25.7.2024, ‘Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2023’”, nr. 79, datë 30.7.2024;

- “Për miratimin e rregullores ‘Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Prokurorinë e Përgjithshme’”, nr. 96, datë 22.10.2024;

- “Për miratimin e rregullores ‘Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Prokurorinë e Përgjithshme’”, nr. 97, datë 22.10.2024;

- “Për miratimin e ‘Rregullores për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorëve të komanduar në Prokurorinë e Përgjithshme’”, nr. 105, datë 12.12.2024.

Marrëveshjet e bashkëpunimit për vitin 2024, janë:

- Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Brendshme “Për ekspertimin e farërave dhe



fidanëve të rinj të bimëve narkotike të sekuestruara” nr. 339 prot., i Prokurorisë së Përgjithshme, datë 1.3.2024;

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme, Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për formën e kërkesës, procedurën dhe përkthimin e akteve në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, nr. 6, datë 22.7.2024;

- Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Azerbajxhanit, nr. 1106/5 prot., datë 1.10.2024;

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë dhe Prokurorisë Federale të Belgjikës, nr. 1386/1 prot., datë 7.11.2024.

Qarkore të prokurorit të përgjithshëm janë:

- Qarkore nr. 1355 prot., datë 22.10.2024, përmes së cilës udhëzon trajtimin nga prokurorët të sulmeve ndaj gazetarëve dhe mediave si prioritet, duke rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e mbrojtjes së lirisë së medias. Është caktuar pika e kontaktit në prokurori për raportimin dhe publikimin e çështjeve të sulmeve ndaj gazetarëve dhe po krijohet *track record*-i i këtyre rasteve;

- Qarkoret nr. 207, datë 7.2.2024 dhe nr. 122/1, datë 26.7.2024, ku trajtohen problematikat e konstatuara në vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe udhëzohen prokurorët për marrjen e masave për sigurimin e standardeve procedurale për procesin e rregullt ligjor;

- Qarkoren nr. 862/1 prot., datë 18.7.2024, përmes së cilës është kërkuar hetim i plotë e i gjithanshëm i aksidenteve rrugore dhe atyre të lidhura me rrjetin elektrik, dhe janë dhënë orientime për mjetet e kërkimit të provës, të nevojshme për ushtrimin efektiv të ndjekjes penale por edhe interesave/përgjegjësi të tjera që lindin nga këto çështje për viktimën, palët apo organin shtetëror të përfshirë;

- Qarkore nr. 645/1 prot., datë 30.7.2024, përmes së cilës janë përcjellë për zbatim në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm

rekomandimet e Komitetit të OKB-së për eliminimin e diskriminimit racor dhe ju është kërkuar marrja e masave për: mbajtjen dhe raportimin e statistikave të sakta e të plota për veprat penale të shtyra nga motive që bazohen në racë, ngjyrë ose etninë e personit; trajtimin me kujdes të materialeve referuese në këtë fushë; sigurimin e të drejtave të viktimave, sipas legjislacionit procedural penal, udhëzimeve nr. 5/2018 dhe nr. 7/2020, të Prokurorit të Përgjithshëm; forcimin e kapaciteteve; bashkëpunimin ndërinstitucional, etj.

- Qarkore nr. 622/1 prot., datë 12.12.2024, “Mbi vonesat në ushtrimin e ndjekjes penale”, drejtuesit, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të angazhohen, në organizimin eficient të punës, për rritjen e dilijencës në hetim, me qëllim kryerjen e hetimeve të plota, sigurimin e kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit dhe shmangien e vonesave që rrezikojnë të çojnë në parashkrimin e ndjekjes penale.

- Nga Prokuroria e Posaçme rezulton se:

Në kuadër të përdorimit dhe rritjes së metodave proaktive për ndjekjen e hetimeve penale, bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë si metodë hetimi nëpërmjet krijimit të skuadrave të përbashkëta hetimore është intensifikuar.

Gjatë vitit 2024, nga Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, janë trajtuar 70 kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike të transmetuara nga autoritetet gjyqësore të huaja, ku krahasuar me vitin 2023¹⁵⁵ rezulton rritje prej 22 kërkesash më shumë ose me një rritje prej 45.8%.

Ndarja sipas objektit të këtyre 70 kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike të transmetuara nga autoritetet gjyqësore të huaja, është si vijon: 60 kërkesa me objekt kryerjen e veprimeve të ndryshme hetimore; 7 kërkesa me objekt kontroll ambientesh; 3 kërkesa me objekt sekuestrimin e pasurive. Nga totali i kërkesave të transmetuara nga autoritetet e huaja janë ekzekutuar 56 kërkesa për ndihmë juridike. Ndërkohë 14 kërkesa për ndihmë juridike, të cilat janë administruar në fund të vitit 2024, janë mbartur në vitin 2025 dhe janë në fazë ekzekutimi.

Për nevoja të hetimeve në kuadër të forcimit të luftës kundër krimit të organizuar, trafikimit dhe

¹⁵⁵ Për vitin 2023 janë trajtuar 48 kërkesa për ndihmë juridike të ardhura nga jashtë vendit.



krimeve të tjera të rënda, për vitin 2024, nga ana e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar janë përpiluar 163 kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike drejtuar autoriteteve të huaja, me një rritje prej 42 kërkesa më tepër se vjet ose me një rritje prej 34,7%¹⁵⁶.

Për sa i përket skuadrave të përbashkëta hetimore me autoritetet e huaja, gjatë vitit 2024 janë ngritur 10 skuadra të reja, ndërkohë që vijojnë hetimet edhe në kuadër të 27 skuadrave të përbashkëta hetimore të ngritura në periudhën paraardhëse¹⁵⁷.

Në lidhje me ekzekutimin e vendimeve penale për vitin 2024 janë ekzekutuar 2046 vendime gjyqate, e cila shënon një rritje në masën rreth 22.6%, në krahasim me 1669 vendime për vitin 2023.

Prokuroria e Posaçme ka vijuar bashkëpunimin ndërinstitucional me Prokurorinë e Përgjithshme, prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, policinë gjyqësore, policinë e shtetit dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit. Ky bashkëpunim ka qenë i vazhdueshëm dhe pa pengesa, në funksion të zbatimit të ligjit për luftën kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar, parandalimit dhe ndëshkimit të autoreve të veprave të tilla penale.

Gjatë vitit 2024, numri i hetimeve të filluara nga Prokuroria e Posaçme për shkak të kallëzimeve nga institucionet publike ka shkuar në 24, duke pësuar një rritje me rreth 66,6% krahasuar me vitin 2023 ku numri ishte 12, ndërkohë që hetimet e filluara për shkak të kallëzimeve nga Policia e Shtetit kanë pësuar një rënie në masën rreth 70,8%. Për vitin 2024, pranë Prokurorisë së Posaçme janë depozituar në total 300 kallëzime penale, prej të cilave rreth 8,3% e rasteve nuk kanë qenë në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme. Në funksion të ndjekjes penale dhe në respektim të dispozitave ligjore të ndarjes së kompetencës lëndore për veprat penale, gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme pasi ka kryer hetimet e plota, ka transferuar pranë prokurorive të rretheve gjyqësore 87 procedime penale me 114

persona të hetuar, numër i njëjtë procedimesh të transferuara me atë të vitit 2023.

Me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar, në vitin 2024, Prokuroria e Posaçme ka nënshkruar 3 marrëveshjeve të reja bashkëpunimi me prokuroritë e shteteve të ndryshme të Bashkimit Evropian dhe Rajonit, e konkretisht:

1. Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare kundër Krimit të Mbretërisë së Bashkuar të Mbretërisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut (NCA) dhe Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nënshkruar më datë 22.2.2024;

2. Memorandumi i mirëkuptimit mbi bashkëpunimin ndërmjet Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të Republikës së Shqipërisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Mbretërisë së Spanjës, nënshkruar më datë 11.4.2024;

3. Memorandumi i mirëkuptimit mbi bashkëpunimin ndërmjet Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të Republikës së Shqipërisë dhe Prokurorisë Speciale të Malit të Zi, nënshkruar më datë 17.12.2024.

Gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme ka vijuar bashkëpunimin ndërkombëtar me autoritetet e huaja bazuar në Konventat e Këshillit të Evropës dhe Konventat e Kombeve të Bashkuara, si dhe në marrëveshje dypalëshe ku Republika e Shqipërisë është palë.

Nga vlerësimi i rekomandimeve të propozuara nga ministrinë e linjës, që kanë në përgjegjësi agjencitë ligjzbatuese që ushtrojnë funksione të policisë gjyqësore, evidentohet progres i arritur dhe forcim i bashkëpunimit me organin e prokurorisë. Me qëllim përmirësimit e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi, nga këto institucione janë propozuar si vijon:

Ministria e Brendshme¹⁵⁸ bazuar në memorandumun e bashkëpunimit ndërinstitucional nr. 5270, datë 16.7.2020, *“Për rritjen e efektivitetit në*

¹⁵⁶ Për vitin 2023 janë 121 kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike drejtuar autoriteteve gjyqësore të huaja nga Prokuroria e Posaçme.

¹⁵⁷ Në raportin vjetor të SPAK-ut për vitin 2023 cilësohej se për vitet 2020–2023 ishin krijuar 32 skuadra. Ndërsa në materialin e përcjellë nga SPAK-u për vitin 2024 konstatohet pasaktësi, pasi njëherë shprehet se bashkë me

vitin 2024 janë 27 skuadra hetimore dhe më pas shprehet se krahas 10 skuadrave të reja janë edhe 27 skuadra paraardhëse.

¹⁵⁸ Kërkuar informacion me shkresën nr. 536 prot., datë 28.1.2025, ardhur përgjigje me shkresën e tyre nr. 1083/4 prot., datë 20.2.2025, protokolluar me nr. 536/4 prot., datë 21.2.2025.



hetimet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimet financiare, sekuestrimin dhe konfiskimin e asetëve kriminale në funksion të përmbushjes së rekomandimeve të KSA-së dhe planit të veprimit të ICRG/FATF”, ka paraqitur sugjerimet me qëllim: i. rritjen e efektivitetit në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit në të gjitha format e tij; ii. parandalimin dhe goditjen e aktiviteteve të krimit të organizuar, financimit të terrorizmit, krimeve ekonomike e financiare dhe dobësimin e financave të rrjeteve të krimit të organizuar; iii. forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me Prokurorinë.

Konkretisht Ministria e Brendshme sugjeron:

- Të zbatohet në mënyrë sistematike paralelisht me hetimin penal për çdo veprë penale që trajtohet nga ligji nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, veçanërisht hetimet e grupeve të strukturuar kriminale dhe subjektet e shpallura në kërkim ndërkombëtar;

- Të kërkohet që në fazat fillestare sekuestrimi i pasurisë, për të cilat dyshohen se rrjedhin nga aktiviteti kriminal për subjektet e ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar;

- Të synohet rritje e numrit të hetimeve të përbashkëta me partnerët ndërkombëtarë, në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar dhe aktivitetit të grupeve kriminale brenda dhe jashtë vendit;

- Të përmirësohet bashkëpunimi për realizimin e takimeve ndërinstytucionale mujore, në nivel qendror dhe lokal, me qëllim evidentimin, adresimin, zgjidhjen e problematikave dhe zhvillimin e analizave të përbashkëta prokurori-polici;

- Të implementohet në mënyrë prioritare shkëmbimi i të dhënave midis dy aplikacioneve të Menaxhimit Policor të Çështjes së Policisë së Shtetit dhe Menaxhimit të Çështjes së Prokurorisë, sa i përket gjurmimit të një çështjeje në faza të ndryshme

të procedimit penal dhe një nga rekomandimet e vazhdueshme të partnerëve ndërkombëtarë;

- Të merren masa për asgjësimin e provave materiale të sekuestruara para përfundimit të procesit gjyqësor ose për të cilat ka një vendim gjyqësor dhe të cilat paraqesin vështirësi dhe rrezikshmëri në magazinimin e tyre;

- Prioritizimin e kërkesave për trajtimin e provave biologjike për ADN-në, vetëm ngjarjeve të rënda, për shkak të kostove financiare që kanë reagentët, duke sjell pamundësinë e përgjigjes së të gjitha kërkesave të adresuara.

Ministria e Brendshme dhe konkretisht Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit¹⁵⁹ rekomandon: forcimin e bashkëveprimit midis institucioneve ligjzbatuese dhe hetimore gjatë veprimtarisë së tyre.

Ministria e Financave dhe konkretisht Agjencia e Inteligjencës Financiare¹⁶⁰, në kuadër të MONEYVAL-it dhe rekomandimet e dhëna nga grupi i ekspertëve të ICRG/FATF, për vitin 2025 rekomandon:

- Përcaktimin e kriterëve për prioritarizimin e hetimeve për veprën penale të parashikuar në nenin 287 të Kodit Penal dhe për hetimet pasurore;

- Rritjen e numrit të masave ndaj pasurisë kriminale, përfshirë edhe sekuestrimin e pasurive ekuivalente apo të pasurive të palëve të treta;

- Rritjen e efikasitetit të hetimeve, duke rritur numrin e çështjeve të dërguara për gjykim, përfshirë për palët e treta, bashkëpunimin me institucionet referuese, përmirësimin e statistikave dhe forcimin e kapaciteteve në luftën kundër pastrimit të parave.

Ministria e Financave dhe konkretisht Drejtoria e Përgjithshme e Doganave¹⁶¹ shpreh se, ka pasur një bashkëpunim të vazhdueshëm me Prokurorinë e Përgjithshme, Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si dhe prokuroritë e rretheve.

Nisur nga ky bashkëpunim, për arsye administrative në funksion të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë (*vendosja e gjohave administrative të cilat gjenerojnë të ardhura në buxhetin e shtetit*), si dhe nisur nga specializimi i oficerëve të

¹⁵⁹ Kërkuar informacion me shkresën nr. 536 prot., datë 28.1.2025, ardhur përgjigje me shkresën e tyre nr. 981/1 prot., datë 10.2.2025, protokolluar me nr. 536/1 prot., datë 11.2.2025.

¹⁶⁰ Kërkuar informacion me shkresën nr. 536 prot., datë 28.1.2025, ardhur përgjigje me shkresën e tyre nr. 2202/1 Faqe | 8028

prot., datë 28.2.2025, protokolluar me nr. 536/6 prot., datë 4.3.2025.

¹⁶¹ Kërkuar informacion me shkresën nr. 536 prot., datë 28.1.2025, ardhur përgjigje me shkresën e tyre nr. 2202/1 prot., datë 28.2.2025, protokolluar me nr. 536/6 prot., datë 4.3.2025.



policisë gjyqësore pranë këtij institucioni, sugjerohet që çdo vepër penale në fushën e kontrabandës të ndiqet nga oficerët e policisë gjyqësore të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Kjo pasi një ndër problematikat e ndeshura për produktet që kapen në flagrancë nga shërbimet e policisë gjyqësore të Policisë së Shtetit është se nuk zbatohen detyrimet që rrjedhin nga Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, në plotësimin e dokumentacionit në momentin e kapjes, bllokimit, sekuestrimit dhe ruajtjes së mallrave me qëllime tregtare, të cilat iu nënshtrohen detyrimeve doganore të importit, të cilat lidhen me detyrimet doganore apo ato për mbrojtjen e pronësisë intelektuale. Ky dokumentacion është i rëndësishëm pasi detyron strukturat doganore që të fillojnë menjëherë hetimin administrativ, përveç atij penal të iniciuar nga strukturat hetimore të institucioneve të tjera hetimore. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka një aktmarrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit me nr. 7231, date 14.4.2022, mbi të cilin është hartuar *“Rregullorja për bashkëpunimin për kryerjen e procedurave të përbashkëta të autoriteteve të policisë dhe autoritetit doganor”*.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit¹⁶² për vitin 2025 rekomandon që një rëndësi të veçantë duhet t'i kushtohet bashkëpunimit të institucioneve të varësisë së ministrisë me strukturat e prokurorisë për sa i përket:

- Rritjes së efektivitetit të bashkëpunimit ndërinstytucional me anë të: i. formalizimit të mekanizmave të bashkëpunimit; ii. krijimit të pikave të kontaktit në të dyja institucionet për të lehtësuar komunikimin e shpejtë dhe efikas; iii. organizimit të trajnimeve të përbashkëta për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore;

- Përmirësimit të shkëmbimit të informacionit nëpërmjet: i. zhvillimit të sistemeve të integruara të shkëmbimit të të dhënave për të lehtësuar qasjen e shpejtë në informacionin e nevojshëm për kontrollin dhe monitorimin; ii. krijimit të mekanizmave të monitorimit për të vlerësuar efektivitetin e bashkëpunimit midis prokurorisë; iii. kryerja e vlerësimeve periodike të bashkëpunimit për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe për të bërë rekomandime për përmirësime.

Ministria e Mbrojtjes¹⁶³, për vitin 2025, rekomandon:

- Forcimin e bashkëpunimit në luftën kundër krimit kibernetik;

- Rritjen e kapaciteteve të oficerëve të policisë gjyqësore të këtij institucioni;

- Vijimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve ligjzbatuese kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim rritjen e cilësisë dhe eficiencës së hetimit të veprave që lidhen me krimin e organizuar në tërësi;

- Rritjen e numrit të operacioneve të përbashkëta kundër veprimtarive dhe strukturave kriminale, si dhe përdorimit të metodave speciale në hetimet proaktive në luftën kundër krimit të organizuar;

- Shkëmbimin e ndërsjellë të informacioneve mes Prokurorisë së Posaçme dhe strukturave ligjzbatuese, përfshirë dhe agjencitë homologe ndërkombëtare, në lidhje me veprat penale në fushën e terrorizmit.

Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërinstytucional, Prokuroria e Përgjithshme për rritjen e cilësisë dhe eficiencës në hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale dhe prioriteteve në luftën kundër kriminalitetit i ka kushtuar një vëmendje të veçantë bashkëpunimit dinamik në nivel vendor në punën e përditshme të drejtuesve, prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore. Bashkëpunimi në nivel qendror dhe vendor ka vijuar edhe kuadër të realizimit të detyrimeve të marra përsipër në marrëveshje të përbashkëta të Prokurorisë së Përgjithshme, me Prokurorinë e Posaçme, me Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, etj.

Në vijim të bashkërendimit të punës për përcaktimin e rregullave të unifikuara, lidhur me përkthimin e akteve në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale, ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme,

¹⁶² Kërkuar informacion me shkresën nr. 536 prot., datë 28.1.2025, ardhur përgjigje me shkresën e tyre nr. 807/2 prot., datë 18.2.2025, protokolluar me nr. 536/3 prot., datë 20.2.2025.

¹⁶³ Kërkuar informacion me shkresën nr. 536 prot., datë 28.1.2025, ardhur përgjigje me shkresën e tyre nr. 899/1 prot., datë 11.2.2025, protokolluar me nr. 536/2 prot., datë 12.2.2025.



Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, është miratuar udhëzimi i përbashkët nr. 6, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për formën e kërkesës, procedurën dhe përkthimin e akteve në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”. Vlen të përmendet, gjithashtu, bashkëpunimi me zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm Evropian, e cila në vitin 2024 ka dërguar pranë Prokurorisë së Përgjithshme, në rrugë elektronike, kërkesën për ndihmë juridike të Zyrës së Prokurorit Publik Evropian në Romë/Itali, në kuadër të çështjes penale për veprat penale “Mashttrim i rëndë për marrjen e fondeve publike; mashttrim i rëndë për marrjen e fondeve publike evropiane dhe krime të tjera në fushën e taksave”.

Për t’u theksuar është edhe marrëveshja për krijimin e një skuadre të përbashkët hetimore, në qershor 2024, ndërmjet njëres nga prokuroritë shqiptare të juridiksionit të përgjithshëm dhe prokurorisë kompetente kosovare, pasi pas hetimeve të kryera rezulton se shtetas shqiptarë dhe kosovarë janë përfshirë në aktivitetin kriminal të trafikimit dhe mbajtjes pa leje të armëve dhe municioneve luftarake. Aktiviteti hetimor në kuadër të kësaj skuadre mbështetet financiarisht nga institucionet respektive, si dhe nëse do të lind nevoja nga ana e projektit të menaxhuar nga Eurojust, WB CRIM JUST – Rritja e bashkëpunimit ndërkufitar në drejtësinë penale në Ballkanin Perëndimor. Kjo është skuadra e parë e përbashkët hetimore e krijuar në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm.

Prokurori i përgjithshëm, në kuadrin e kërkesave të Rezolutës së Kuvendit dhe rekomandimeve të Këshillit të Ministrave, si dhe në kuadrin e implementimit të reformës ligjore në sistemin e prokurorisë, me synim për të normuar veprimtarinë administrative dhe procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, gjatë vitit 2024, ka nxjerrë akte të reja normative dhe/ose ndryshime/plotësime të atyre në fuqi, si dhe ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh të përbashkëta ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë dhe Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, me Prokurorinë e Përgjithshme të Republikës së Azerbajxhanit dhe Prokurorinë Federale të Belgjikës.

Me qëllim forcimin e luftës kundër informalitetit duke rritur numrin e çështjeve të regjistruara e të dërguara për gjykim për grupveprat penale në fushën e taksave dhe tatimeve, **Prokuroria e Përgjithshme ka hartuar udhëzimin e përgjithshëm nr. 5/2024, të memorandumit të bashkëpunimit “Për rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimet financiare dhe sekuestrimin e konfiskimin e aseteve kriminale, në funksion të përmbushjes së rekomandimeve të KSA-së e FATF-së dhe planit të veprimit ICRG/FATF” dhe udhëzimit të përgjithshëm nr. 10/2020, “Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave e krimeve financiare dhe financimin e terrorizmit, dhe në hetimet pasurore në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”.**

Në kushtet kur veprimtaria kriminale ndërmjet teknologjisë dhe drejtuar asaj, është gjithmonë e më tepër në rritje, janë marrë masa për të rritur kapacitetet profesionale në hetimin e këtyre veprave penale dhe prokurori i përgjithshëm ka zhvilluar një takim me ambasadorin e OSBE-së në Tiranë, ku u diskutua për bashkëpunimin e deritanishëm dhe asistencën e dhënë nga OSBE-ja për sistemin e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm në organizimin e trajnimeve për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore me fokus te provat elektronike dhe krimi kibernetik, në kuadër edhe të manualit përkatës, hartimi i të cilit u realizua nga OSBE-ja.

Prokuroria e përgjithshme ka nxjerrë qarkoren nr. 1009, prot. datë 26.7.2024, lidhur me bashkëpunimin me Njësinë e Koordinimit 24/7 në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pjesë e Drejtorisë së Hetimit të Krimin Kibernetik, për të siguruar ndihmë teknike, lidhur me krimin kibernetik, informacion nga pika kontakti të shteteve të tjera për marrjen e provave, informacion për vendndodhjen e personave të dyshuar, si dhe çdo informacion tjetër të domosdoshëm për hetimin e veprave penale në këtë fushë.

Ndihma e ndërsjellë juridike me autoritetet e huaja, është shumë e rëndësishme në hetimin dhe përfundimin e suksesshëm të hetimit të krimin kibernetik dhe nga të dhënat për vitin 2024 rezultojnë 97 kërkesa për ndihmë juridike, 85 prej të cilave janë letërporosi për jashtë. Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, vlen për t’u theksuar mbështetja nga ana e Prokurorisë së Posaçme, e cila ka vënë në dispozicion ekspertizën e



saj teknologjike për hetimin e çështjeve të rëndësishme në prokurori të juridiksionit të përgjithshëm.

Në kuadër të bashkëpunimit ndër-institucional, nga të dhënat e paraqitura për vitin 2024, rezulton se Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka vijuar bashkëpunimin ndërinstitucional me Prokurorinë e Përgjithshme, prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, policinë gjyqësore, policinë e shtetit dhe agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit. Ky bashkëpunim ka qenë i vazhdueshëm dhe pa pengesa, në funksion të zbatimit të ligjit për luftën kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar, parandalimit dhe ndëshkimit të autoreve të veprave të tilla penale.

Gjatë vitit 2024, numri i hetimeve të filluara nga Prokuroria e Posaçme për shkak të kallëzimeve nga institucionet publike ka shkuar në 24, duke pësuar një rritje me rreth 66,6% krahasuar me vitin 2023 ku numri ishte 12, ndërkohë që hetimet e filluara për shkak të kallëzimeve nga Policia e Shtetit kanë pësuar një rënie në masën rreth 70,8%. Për vitin 2024, pranë Prokurorisë së Posaçme janë depozituar në total 300 kallëzime penale, prej të cilave rreth 8,3% e rasteve nuk kanë qenë në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme. Në funksion të ndjekjes penale dhe në respektim të dispozitave ligjore të ndarjes së kompetencës lëndore për veprat penale, gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme pasi ka kryer hetimet e plota, ka transferuar pranë prokurorive të rretheve gjyqësore 87 procedime penale me 114 persona të hetuar, numër i njëjtë procedimesh të transferuara me atë të vitit 2023.

Me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar, në vitin 2024, Prokuroria e Posaçme ka nënshkruar 3 marrëveshje të reja bashkëpunimi me prokuroritë e shteteve të ndryshme të Bashkimit Evropian dhe Rajonit, e konkretisht:

4. Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare kundër Krimit të Mbretërisë së Bashkuar të Mbretërisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut (NCA) dhe Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nënshkruar më datë 22.2.2024;

5. Memorandumi i mirëkuptimit mbi bashkëpunimin ndërmjet Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të Republikës së Shqipërisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Mbretërisë së Spanjës, nënshkruar më datë 11.04.2024;

6. Memorandumi i Mirëkuptimit mbi Bashkëpunimin ndërmjet Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të Republikës së Shqipërisë dhe Prokurorisë Speciale të Malit të Zi, nënshkruar më datë 17.12.2024.

Gjatë vitit 2024, Prokuroria e Posaçme ka vijuar bashkëpunimin ndërkombëtar me autoritetet e huaja bazuar në Konventat e Këshillit të Evropës dhe Konventat e Kombeve të Bashkuara, si dhe në marrëveshje dypalëshe ku Republika e Shqipërisë është palë.

Në kuadër të përdorimit dhe rritjes së metodave proaktive për ndjekjen e hetimeve penale, bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë si metodë hetimi nëpërmjet krijimit të skuadrave të përbashkëta hetimore është intensifikuar.

Gjatë vitit 2024, nga Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Hetimet e Përbashkëta pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, janë trajtuar 70 kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike të transmetuara nga autoritetet gjyqësore të huaja, ku krahasuar me vitin 2023¹⁶⁴ rezulton rritje prej 22 kërkesash më shumë ose me një rritje prej 45,8%.

Ndarja sipas objektit të këtyre 70 kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike të transmetuara nga autoritetet gjyqësore të huaja, është si vijon: 60 kërkesa me objekt kryerjen e veprimeve të ndryshme hetimore; 7 kërkesa me objekt kontroll ambientesh; 3 kërkesa me objekt sekuestrimin e pasurive. Nga totali i kërkesave të transmetuara nga autoritetet e huaja janë ekzekutuar 56 kërkesa për ndihmë juridike. Ndërkohë 14 kërkesa për ndihmë juridike të cilat janë administruar në fund të vitit 2024, janë mbartur në vitin 2025 dhe janë në fazë ekzekutimi.

Për nevoja të hetimeve në kuadër të forcimit të luftës kundër krimit të organizuar, trafikimit dhe krimeve të tjera të rënda, për vitin 2024, nga ana e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar janë përpiluar 163 kërkesa për

¹⁶⁴ Për vitin 2023 janë trajtuar 48 kërkesa për ndihmë juridike të ardhur nga jashtë vendit.



ndihmë të ndërsjellë juridike drejtuar autoriteteve të huaja, me një rritje prej 42 kërkesa më tepër se vjet ose me një rritje prej 34,7%¹⁶⁵.

Për sa i përket skuadrave të përbashkëta hetimore me autoritetet e huaja, gjatë vitit 2024 janë ngritur 10 skuadra të reja, ndërkohë që vijojnë hetimet edhe në kuadër të 27 skuadrave të përbashkëta hetimore të ngritura në periudhën paraardhëse¹⁶⁶.

Në lidhje me ekzekutimin e vendimeve penale për vitin 2024 janë ekzekutuar 2046 vendime gjyqate, e cila shënon një rritje në masën rreth 22.6%, në krahasim me 1669 vendime për vitin 2023.

UDHËZIM **Nr. 1, datë 17.4.2025**

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 4, DATË 31.12.2020, “MBI KRITERET DHE PROCEDURËN PËR CERTIFIKIMIN E OPERATORËVE TË TURIZMIT DETAR”, I NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe pikës 3, të nenit 5, të ligjit nr. 43, datë 27.4.2020, “Për aktivitetet e turizmit detar”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 4, datë 31.12.2020, të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, “Mbi kriteret dhe procedurën për certifikimin e operatorëve të turizmit detar”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Shkronja “a”, e pikës 1, të kreut II, shfuqizohet.

2. Në kreun III, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) në shkronjën “b”, të pikës 1, fjalët “numrin e licencës” shfuqizohen.

b) në shkronjën “b”, të pikës 2, fjalët “fotokopje të licencës XIII.1.B dhe..” shfuqizohen.

3. Shkronja “b”, e pikës 2, të kreut V, shfuqizohet.

¹⁶⁵ Për vitin 2023 janë 121 kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike drejtuar autoriteteve gjyqësore të huaja nga Prokuroria e Posaçme.

¹⁶⁶ Në raportin vjetor të SPAK për vitin 2023 cilësohej se për vitet 2020–2023 ishin krijuar 32 skuadra. Ndërsa në Faqe| 8032

4. Te kërkesa për pajisjen me certifikatë “operator i turizmit detar”, bashkëlidhur udhëzimit bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) në seksionin “A”, fjalët “numri i licencës”, shfuqizohen;

b) në shkronjën “a”, të seksionit “C”, fjalët “fotokopje të licencës XIII.1.B dhe..” shfuqizohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE POROSI
ZËVENDËSMINISTËR I TURIZMIT
DHE MJEDISIT
Sofjan Jaupaj

UDHËZIM I PËRBASHKËT **Nr. 69, datë 10.4.2025**

PËR PËRCAKTIMIN E DOKUMENTACIONIT TË NEVOJSHËM PËR FITIMIN, HEQJEN DORË DHE RIFITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE, FORMËN DHE MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË KËRKESËS, TË PROCEDURËS PËR KRYERJEN E VERIFIKIMEVE PRANË INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE, SI DHE TË DOKUMENTACIONIT PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR KRYERJEN E BETIMIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar,

UDHËZOJMË:

I. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR FITIMIN E SHTETËSISË ME ORIGJINË

1. Shtetësia shqiptare fitohet nga i huaji, të paralindurit e të cilët kanë origjinë shqiptare, me kusht që të provohet lidhja familjare në vijë të drejtë, deri në tri shkallë, e kërkuarit me të paralindurit.

1.1 Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim është:

materialin e përcjellë nga SPAK për vitin 2024 konstatohet pasaktësi, pasi njëherë shprehet se, bashkë me vitin 2024 janë 27 skuadra hetimore dhe më pas shprehet se, krahas 10 skuadrave të reja janë edhe 27 skuadra paraardhëse.



a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) certifikatë lindjeje/ekstrakt lindjeje/personale;

c) certifikatë familjare (për vendet që nuk e lëshojnë, të shoqërohet me dokument zyrtar justifikues);

ç) certifikatë apo çdo dokument tjetër mbi bazën e të cilit vërtetohet origjina shqiptare e kërkuarit, në vijë të drejtë, deri në tri shkallë, qoftë edhe nga njëri prind;

d) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit të shtetësisë tjetër të aplikuesit dhe/ose të shtetit të tretë ku kërkuari ka pasur qëndrim të ligjshëm mbi gjashtë muaj.

1.2 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.

II. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR FITIMIN E SHETËSISË SHQIPTARE ME NATYRALIZIM

1. Shtetësia shqiptare fitohet me natyralizim nga i huaji mbi 18 vjeç me qëndrim të rregullt në Republikën e Shqipërisë.

1.1 Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim është:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) certifikatë lindjeje/ekstrakt nga akti i lindjes/personale;

c) dokument i cili vërteton njohuri të gjuhës shqipe në nivelin A2 të vërtetuar nga institucioni përkatës arsimor (bëjnë përjashtim vetëm për shtetasit e huaj në shtetet e të cilëve gjuha shqipe është gjuhë zyrtare);

ç) dokument i cili vërteton se ka kaluar testin e njohurive bazë të historisë së Republikës së Shqipërisë, lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë (bëjnë përjashtim vetëm për shtetasit e huaj në shtetet e të cilëve gjuha shqipe është gjuhë zyrtare);

d) akti i pronësisë së banesës/kontrata e marrjes me qira të banesës/deklaratë noteriale, lidhur me banimin ose çdo dokument tjetër që vërteton akomodimin e shtetasit në Republikën e Shqipërisë (kopje e njëzuar me origjinalin);

dh) dokument që vërteton disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë, si: vërtetime zyrtare të ardhurash/kontratë pune për të punësuarit dhe vërtetim kontributesh/ vërtetim nga

organet tatimore për të vetëpunësuarit (kopje e njëzuar me origjinalin);

e) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit të shtetësisë tjetër të aplikuesit dhe/ose të shtetit të tretë, ku kërkuari ka pasur qëndrim të ligjshëm mbi gjashtë muaj;

ë) leje e përhershme qëndrimi e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kritereve të ligjit për shtetësinë;

f) vërtetim nga autoriteti i kufirit dhe i migracionit që ka qëndruar në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 7 (shtatë) vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

1.2 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) mendimi me shkrim i komisariatit të policisë vendore, ku aplikuesi ka vendbanimin, për sjelljen dhe qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë;

b) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.

2. Personi pa shtetësi mund të aplikojë për fitimin e shtetësisë shqiptare me natyralizim.

2.1 Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim është:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit të vet, të shtetit të tretë ku kërkuari ka pasur qëndrim të ligjshëm mbi gjashtë muaj;

c) leje e përhershme qëndrimi e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kritereve të ligjit për shtetësinë;

ç) vërtetim nga autoriteti i kufirit dhe i migracionit që ka qëndruar në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 7 (shtatë) vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë;

d) mendimi me shkrim i komisariatit të policisë vendore ku aplikuesi ka vendbanimin, për sjelljen dhe për qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë.

2.2 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.

3. I huaji mbi 18 vjeç, i martuar me shtetas shqiptar, mund të aplikojë për fitimin e shtetësisë shqiptare, me natyralizim.



3.1 Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim është:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) certifikatë lindjeje/ekstrakt nga akti i lindjes/personale;

c) certifikatë martese;

ç) akti i pronësisë së banesës/kontrata e marrjes me qira të banesës/deklaratë noteriale lidhur me banimin ose çdo dokument tjetër që vërteton akomodimin e shtetasit në Republikën e Shqipërisë (kopje e njësuar me origjinalin);

d) dokument që vërteton disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë, si: vërtetime zyrtare të ardhurash/depozitë bankare/kontratë pune për të punësuarit dhe vërtetim kontributesh / vërtetim nga organet tatimore për të vetëpunësuarit (kopje e njësuar me origjinalin);

dh) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit të origjinës dhe/ose të një shteti të tretë ku kërkuksi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj;

e) leje qëndrimi e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kriterëve të ligjit për shtetësinë (të paktën për një vit, gjatë të gjithë periudhës së martesës);

ë) vërtetim nga autoriteti i kufirit dhe i migracionit që ka qëndruar në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 1 (një) vit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3.2 Dokumentacioni i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) mendimi me shkrim i komisarit të policisë vendore ku aplikuesi ka vendbanimin, për sjelljen dhe qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë;

b) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.

4. I huaji mbi 18 vjeç, fëmija i të cilit ka shtetësi shqiptare, mund të aplikojë për fitimin e shtetësisë me natyralizim.

4.1 Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim është:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) certifikatë lindjeje/ekstrakt nga akti i lindjes / personale;

c) certifikatë familjare (për vendet që nuk e lëshojnë, të shoqërohet me dokument zyrtar justifikues);

ç) certifikatë lindjeje të fëmijës me shtetësi shqiptare;

d) akti i pronësisë së banesës/kontrata e marrjes me qira të banesës/deklaratë noteriale, lidhur me banimin, ose çdo dokument tjetër që vërteton akomodimin e shtetasit në Republikën e Shqipërisë (kopje e njësuar me origjinalin);

dh) dokument që vërteton disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë, si: vërtetime zyrtare të ardhurash/depozitë bankare/kontratë pune për të punësuarit dhe vërtetim kontributesh/ vërtetim nga organet tatimore për të vetëpunësuarit (kopje e njësuar me origjinalin);

e) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit të origjinës dhe/ose të një shteti të tretë ku kërkuksi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj;

ë)) leje qëndrimi të vlefshme në momentin e aplikimit, e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kriterëve të ligjit “Për shtetësinë”, i ndryshuar;

f) vërtetim nga autoriteti i kufirit dhe i migracionit që ka qëndruar në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 3 (tre) vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

4.2 Dokumentacioni i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) mendimi me shkrim i formuluar nga komisarati i policisë vendore për sjelljen dhe qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë;

b) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.

5. Fëmija i dy prindërve që kanë fituar shtetësinë shqiptare me natyralizim, mund të ftojë shtetësinë me natyralizim, duke dorëzuar dokumentet e mëposhtme:

a) kërkesë drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë nga të dy prindërit ku shprehet dhe pëlqimi i fëmijës kur është në moshën 14–18 vjeç;

b) dokument i cili vërteton njohuri të gjuhës shqipe në nivelin A2 të vërtetuar nga institucioni përkatës arsimor, për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;

c) dokument i cili vërteton se ka kaluar testin e njohurive bazë të historisë së Republikës së Shqipërisë, për fëmijët në moshën 14–18 vjeç, lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë;



c) certifikatë lindjeje/ekstrakt nga akti i lindjes/personale;

d) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit të origjinës dhe/ose të një shteti të tretë ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj, vetëm për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;

dh) deklaratë noteriale, ku shprehet pëlqimi i prindërve/kujdestarit ligjor lidhur me fitimin e shtetësisë shqiptare për fëmijën;

e) dokument zyrtar i lëshuar nga institucionet shqiptare, ku të evidentohet shtetësia shqiptare e fituar nga të dy prindërit;

ë) leje qëndrimi të vlefshme, e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë.

5.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë, vetëm për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;

b) mendimi me shkrim i komisarit të policisë vendore ku aplikuesi ka vendbanimin, për sjelljen dhe qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë, për fëmijët në moshën 14–18 vjeç.

6. Fëmija i një prindi që ka fituar shtetësinë shqiptare me natyralizim, mund të fitojë shtetësinë me natyralizim, duke dorëzuar dokumentet e mëposhtme:

a) kërkesë drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë nga të dy prindërit ose nga njëri prej prindërve (në këtë rast, prindi tjetër duhet të japë pëlqimin me shkrim) dhe pëlqimi i fëmijës, kur është në moshën 14–18 vjeç;

b) dokument i cili vërteton njohuri të gjuhës shqipe në nivelin A2 të vërtetuar nga institucioni përkatës arsimor, për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;

c) dokument i cili vërteton se ka kaluar testin e njohurive bazë të historisë së Republikës së Shqipërisë, për fëmijët në moshën 14–18 vjeç, lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë;

c) certifikatë lindjeje/ekstrakt nga akti i lindjes / personale;

d) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit të origjinës dhe/ose të një shteti të tretë ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj, vetëm për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;

dh) deklaratë noteriale, ku shprehet pëlqimi i prindërve/kujdestarit ligjor lidhur me fitimin e shtetësisë shqiptare për fëmijën;

e) dokument zyrtar i lëshuar nga institucionet shqiptare, ku të evidentohet shtetësia shqiptare e fituar nga njëri prind;

ë) leje qëndrimi të vlefshme në momentin e aplikimit, e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë;

6.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë, vetëm për fëmijët në moshën 14–18 vjeç;

b) mendimi me shkrim i komisarit të policisë vendore ku aplikuesi ka vendbanimin, për sjelljen dhe qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë, për fëmijët në moshën 14–18 vjeç.

III. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR FITIMIN E SHTETËSISË ME BIRËSIM

1. Në rast birësimi nga dy bashkëshortë me shtetësi shqiptare të një fëmije me shtetësi tjetër ose pa shtetësi, fëmija fiton shtetësinë shqiptare. Fëmija i birësuar e fiton shtetësinë shqiptare edhe kur vetëm njëri prej bashkëshortëve është shtetas shqiptar, si dhe në çdo rast tjetër kur fëmija rrezikon të mbetet pa shtetësi si rezultat i birësimit.

1.1 Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim është:

a) kërkesë e bashkëshortëve drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) akti i lindjes së fëmijës/certifikatë nga akti i lindjes;

c) dokumenti, akti administrativ, mbi bazën e të cilit është vendosur për birësimin e fëmijës;

c) deklaratë noteriale, ku shprehet pëlqimi i prindërve/kujdestarit ligjor lidhur me fitimin e shtetësisë shqiptare për fëmijën e mitur;

IV. DOKUMENTET QË KËRKOHEN PËR FITIMIN E SHTETËSISË NGA REFUGJATËT APO PERSONA NË MBROJTJE PLOTËSUESE

1. Shtetësia shqiptare fitohet nga refugjati, apo personi në mbrojtje plotësuese mbi 18 vjeç, që ka paraqitur kërkesë, duke plotësuar dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) dokument i cili vërteton se zotëron njohuri të gjuhës shqipe, të folur dhe të shkruar, njohuritë bazë të historisë e të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të vërtetuar nga institucioni përkatës arsimor;



c) akti i pronësisë së banesës/kontrata e marrjes me qira të banesës/deklaratë noteriale, lidhur me banimin, ose çdo dokument tjetër që vërteton akomodimin e shtetasit në Republikën e Shqipërisë (kopje e njëzuar me origjinalin);

ç) dokument që vërteton disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë, si: vërtetime zyrtare të ardhurash/depozitë bankare/kontratë pune për të punësuarit dhe vërtetim kontributesh/vërtetim nga organet tatimore për të vetëpunësuarit (kopje e njëzuar me origjinalin);

d) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga autoritetet kompetente të vendit të tretë ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj;

dh) Vendimi për njohjen e statusit (lëshuar nga autoriteti përgjegjës për Azilin, kopje e njëzuar me origjinalin);

e) leje qëndrimi e lëshuar nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë, sipas kriterëve të ligjit për shtetësinë;

ë) vërtetim nga autoriteti i kufirit dhe i migracionit që ka qëndruar në mënyrë të ligjshme dhe ka banuar për një periudhë të vazhdueshme për jo më pak se 7 (shtatë) vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë nga data e marrjes së statusit.

1.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) vërtetim i gjendjes gjyqësore lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë;

b) mendimi me shkrim i komisarit të policisë vendore ku aplikuesi ka vendbanimin, për sjelljen dhe qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë.

V. DOKUMENTE QË KËRKOHEN PËR HEQJEN DORË NGA SHTETËSIA SHQIPTARE

1. Për shtetasit mbi moshën 18 vjeç, të cilët kërkojnë heqjen e shtetësisë shqiptare, kërkojnë këto dokumente:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) premtime nga autoriteti kompetent i vendit të shtetësisë tjetër ose dokument, ku konfirmohet shtetësia e një vendi tjetër;

c) certifikatë lindjeje ose personale e aplikuesit;

ç) vërtetim i lëshuar nga gjykata e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm;

d) vërtetim i lëshuar nga Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm;

dh) vërtetim i lëshuar nga zyra e përmbarimit, nëse ka detyrime ndaj personave fizikë dhe juridikë, privatë apo shtetërorë;

e) vërtetim i lëshuar nga zyra e përmbarimit, nëse ka likuiduar të gjitha detyrimet financiare për bashkëshortin/bashkëshorten/fëmijën apo personat nën kujdestari;

ë) dokument që vërteton rezidencën, vendbanimin e tij në shtetin nga i cili i është premtuar shtetësia tjetër ose në vendin e shtetësisë tjetër.

1.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) vërtetim i gjendjes gjyqësore lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë;

b) mendimi me shkrim i formuluar nga komisarati i policisë vendore ku aplikuesi ka vendbanimin, për sjelljen dhe qëndrimin e aplikuesit në Republikën e Shqipërisë.

2. Për fëmijët e moshës 0–14 vjeç të paraqitet:

a) kërkesë e prindërve/kujdestarit ligjor, drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) certifikatë lindjeje/personale e fëmijës me shtetësi shqiptare;

c) deklarata noteriale e të dy prindërve / kujdestarit ligjor (ose vetëm e njërit prej prindërve, sipas përcaktimeve në nenin 14, të ligjit nr. 113/2020, ku shprehet pëlqimi për lënie të shtetësisë shqiptare të fëmijës së tyre).

3. Për fëmijët e moshës 14–18 vjeç, kërkojnë këto dokumente:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) dokumentacioni sipas përcaktimeve të pikës 1, të kreut V, të këtij udhëzimi;

c) deklarata noteriale e të dy prindërve (ose vetëm e njërit prej prindërve apo kujdestarit ligjor sipas përcaktimeve në nenin 14, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar), ku shprehet pëlqimi për lënie të shtetësisë shqiptare i fëmijës së tyre/tij/saj.

VI. DOKUMENTE QË KËRKOHEN PËR RIFITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE

1. Personi që ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare dhe nuk ka fituar shtetësi tjetër, për rifitim të shtetësisë shqiptare depoziton:



a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) certifikatë lindjeje nga akti/personale;

c) deklaratë noteriale nga çdo aplikant mbi moshën 14 vjeç, për faktin e aplikimit ose jo për të fituar shtetësi tjetër, si dhe nëse aktualisht është person pa shtetësi;

ç) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga organet kompetente të shtetit të tretë dhe/ose të shtetit ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj;

d) dokument i cili vërteton heqjen e shtetësisë shqiptare (dekreti i Presidentit të Republikës së Shqipërisë ose certifikatë personale ku shënohet numri dhe data e dekretit të heqjes dorë nga shtetësia).

1.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) vërtetim i gjendjes gjyqësore, i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.

2. Personi që ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare dhe ka fituar një shtetësi tjetër, për rifitim të shtetësisë shqiptare depoziton:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) certifikatë lindjeje nga akti/personale lëshuar në Republikën e Shqipërisë;

c) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga organet kompetente të shtetit të shtetësisë tjetër që ka aplikanti dhe/ose të shtetit ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj;

ç) dokument i cili vërteton heqjen e shtetësisë shqiptare (dekreti i Presidentit të Republikës së Shqipërisë ose certifikatë personale ku shënohet numri dhe data e dekretit të heqjes dorë nga shtetësia;

d) dokumentin i cili vërteton shtetësinë e huaj (pasaportë, kartë identiteti, certifikatë natyralizimi /personale ose vërtetim nga bashkia/komuna).

2.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.

VII. PËRCAKTIMI I RREGULLAVE TË DETAJUARA PËR DOKUMENTACIONIN E NEVOJSHËM, FORMËN DHE MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË KËRKESËS PËR HEQJEN DORË DHE RIFITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE, PËR PERSONAT QË BANOJNË

JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. Aplikimi për rifitim dhe heqjen dore nga shtetësia shqiptare për shtetasit shqiptar me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, bëhet pranë misionit diplomatik apo postit konsullor të Republikës së Shqipërisë, ku ka vendbanim aplikuesi, ose në përfaqësinë diplomatike, e cila mbulon shtetin ku ka vendbanim aplikuesi, në rastet kur nuk ka përfaqësi diplomatike ose konsullore të Republikës së Shqipërisë, të hapur aty.

VIII. DOKUMENTET QË KËRKOHEN PËR HEQJE DORË TË SHTETËSISË SHQIPTARE

1. Për shtetasit mbi moshën 18 vjeç, të cilët kërkojnë heqjen e shtetësisë shqiptare, kërkohen këto dokumente:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) premtimi nga autoriteti kompetent i vendit të shtetësisë tjetër ose dokument origjinal, ku konfirmohet shtetësia e një vendi tjetër. Në rast se personi ka fituar shtetësi tjetër, duhet të paraqesë kopje të njësuar të mjetit të identifikimit, që e vërteton atë;

c) certifikatë lindjeje ose personale e aplikuesit;

ç) vërtetim i lëshuar nga gjykata e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm;

d) vërtetim i lëshuar nga Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm;

dh) vërtetim i lëshuar nga zyra e përmbarimit, nëse ka detyrime ndaj personave fizikë dhe juridikë, privatë apo shtetërorë;

e) vërtetim i lëshuar nga zyra e përmbarimit, nëse ka likuiduar të gjitha detyrimet financiare për bashkëshortin/bashkëshorten/fëmijën apo personat nën kujdestari;

ë) dokument që vërteton rezidencën, vendbanimin e tij në shtetin nga i cili i është premtuar shtetësia tjetër ose në vendin e shtetësisë tjetër.

1.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) vërtetim i gjendjes gjyqësore lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.

2. Për fëmijët 0–14 vjeç kërkohen këto dokumente:

a) kërkesa e prindërve ose kujdestarit/eve ligjorë për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;



b) certifikatë lindjeje ose personale e fëmijës me shtetësi shqiptare;

c) deklaratë noteriale e të dy prindërve (ose vetëm njërit prej prindërve, sipas përcaktimeve në nenin 14, të ligjit nr. 113/2020, ku shprehet pëlqimi për lënie të shtetësisë shqiptare të fëmijës së tyre/tij/saj).

3. Për fëmijët 14–18 vjeç kërkohen këto dokumente:

a) kërkesë individuale për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) dokumentacioni sipas përcaktimeve të pikës 1, të kreut VIII, të këtij udhëzimi, për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare;

c) deklaratë noteriale e të dy prindërve (ose vetëm njëri prej prindërve, sipas përcaktimeve në nenin 14, të ligjit nr. 113/2020, ku shprehet pëlqimi për lënie të shtetësisë shqiptare të fëmijës së tyre/tij/saj).

IX. DOKUMENTET QË KËRKOHEN PËR RIFITIMIN E SHTETËSISË SHQIPTARE

1. Personi që ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare dhe nuk ka fituar shtetësi tjetër, për rifitim të shtetësisë shqiptare depoziton:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) certifikatë lindjeje nga akti/personale;

c) deklaratë noteriale nga çdo aplikant, për faktin e aplikimit ose jo për të fituar shtetësi tjetër, si dhe nëse aktualisht është person pa shtetësi;

ç) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga organet kompetente të shtetit të tretë dhe/ose të shtetit ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj;

d) dokument i cili vërteton heqjen e shtetësisë shqiptare (dekreti i Presidentit të Republikës së Shqipërisë ose certifikatë personale ku shënohet numri dhe data e dekretit të heqjes dorë nga shtetësia).

1.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) vërtetim i gjendjes gjyqësore, i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.

2. Personi që ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare dhe ka fituar një shtetësi tjetër, për rifitim të shtetësisë shqiptare depoziton:

a) kërkesë individuale drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë;

b) certifikatë lindjeje nga akti/personale lëshuar në Republikën e Shqipërisë;

c) vërtetim të gjendjes gjyqësore të lëshuar nga organet kompetente të shtetit të shtetësisë tjetër që ka aplikanti dhe/ose të shtetit ku kërkuesi ka pasur qëndrim të ligjshëm më shumë se gjashtë muaj;

ç) dokumentin i cili vërteton heqjen dorë nga shtetësia shqiptare (dekreti i Presidentit të Republikës së Shqipërisë ose certifikatë aktuale personale ku shënohet numri dhe data e dekretit të heqjes dorë nga shtetësia);

d) dokumentin i cili vërteton shtetësinë e huaj (pasaportë, kartë identiteti, certifikatë natyralizimi/personale ose vërtetim nga bashkia/komuna);

2.1 Dokumentacion i cili sigurohet nga nëpunësi i administratës:

a) vërtetim i gjendjes gjyqësore i lëshuar nga organet kompetente në Republikën e Shqipërisë.

X. FORMA DHE MËNYRA E PLOTËSIMIT TË KËRKESËS

1. Aplikimi për fitimin, rifitimin dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare bëhet përmes sistemit elektronik të sigurt *online*, duke plotësuar të dhënat e kërkuara dhe duke ngarkuar *online* kërkesën individuale.

2. Aplikimi për heqje dorë nga shtetësia shqiptare në përfaqësitë diplomatike dhe postet konsullore mund të kryhet nga vetë aplikuesi, nga prindi për fëmijën deri në moshën 18 vjeç, ndërsa për aplikimet brenda Republikës së Shqipërisë edhe nga përfaqësuesi me prokurë të posaçme.

3. Kërkesa individuale për fitimin e shtetësisë shqiptare për shtetasit mbi moshën 18 vjeç, duhet të përmbajë: emër, mbiemër, datëlindje, vendlindje, adresën e përhershme, periudhën e ardhjes në Shqipëri, profesionin e ushtruar në shtetin e huaj dhe në Shqipëri. Kërkesa nënshkruhet me emër, mbiemër, firmë.

4. Kërkesa individuale për rifitimin e shtetësisë shqiptare për shtetasit mbi moshën 18 vjeç, duhet të përmbajë: emër, mbiemër, datëlindje, vendlindje, adresën e përhershme, si dhe numrin dhe datën e dekretit me të cilin ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare. Gjithashtu, në kërkesë duhet të bëhet e qartë nëse kërkuesi ka fituar apo jo një shtetësi tjetër. Kërkesa nënshkruhet me emër, mbiemër, firmë.

5. Kërkesa individuale për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare për shtetasit mbi moshën 18 vjeç, duhet të përmbajë: emër, mbiemër, datëlindje, vendlindje, adresën e përhershme. Kërkesa nënshkruhet me emër, mbiemër, firmë.



6. Aplikimi për fitimin e shtetësisë shqiptare nga shtetas të huaj, bëhet nga vetë kërkuesi (për rastet e fitimit të shtetësisë shqiptare nuk aplikohet nga përfaqësuesi i tij me prokurë të posaçme). Aplikimi për shtetësinë shqiptare është individual, përveç të miturve nën moshën 14 vjeç, për të cilët shprehen prindërit apo kujdestari ligjor i tyre.

7. Dokumentet për shtetësinë shqiptare pranohen kur janë në harmoni të plotë me njëritjetrin, pa gabime e pa korrigjime në përmbajtjen e tyre. Dokumentet e lëshuara nga shteti shqiptar, duhet të mos kapërcejnë gjashtë muajt e fundit nga data e lëshimit të tyre. Dokumentet pranohen në formën e tyre origjinale, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të gjitha dokumentet e lëshuara në Republikën e Shqipërisë, pranohen kur janë nënshkruar nga titullari i institucionit që i lëshon ato. Këto dokumente nuk kanë nevojë për vulë apostile apo legalizim nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme.

8. Në rastet e ndryshimit të gjeneraliteteve për personat që kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare dhe kanë fituar një shtetësi të huaj, të paraqitet dokument zyrtar i cili vërteton ndryshimin e gjeneraliteteve në shtetin e shtetësisë së huaj, i legalizuar/apostiluar, përkthyer dhe noterizuar.

9. Dokumentet të cilat gjenerohen nga sistemi *e-Albania*, paraqiten të printuara dhe pranohen me vulë digjitale. Në rastet e aplikimit për heqje dorë dhe rifitim të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pranohen të printuara dhe të firmosura nga konsulli në Misionin Diplomatik dhe Postin Konsullor të Republikës së Shqipërisë, të shoqëruara me procesverbalin e dokumenteve që përmban dosja e aplikuesit.

10. Misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë duhet të depozitojnë procesverbalin dhe dosjen e dokumenteve të aplikimit, brenda 1 (një) muaji nga data e dorëzimit pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, e cila duhet të kalojë praktikën brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve në Ministrinë e Brendshme.

11. Dokumentet e lëshuara nga administrata e shtetit të huaj duhet të jenë të legalizuara/apostiluara sipas regjimit me shtetin përkatës.

a) pranohen direkt dokumentet e përkthyer dhe noterizuar në Republikën e Shqipërisë;

b) kur përkthimi i dokumenteve kryhet në shtetin e huaj, përkthimi vërtetohet në misionin diplomatik apo postin konsullor.

12. Data e lëshimit të tyre të mos kapërcejë gjashtë muajt e fundit, me përjashtim të dokumentit premtimi i shtetësisë dhe vërtetim banimi/qëndrimi, të cilat kanë vlefshmëri 2 vjet. Në rastet kur për dokumentet e ardhura nga jashtë është i pamundur lëshimi i dokumentit origjinal, për shkak të legjislacionit, atëherë pranohen dokumentet e njësuara me akt noterial.

13. Afatet e vlefshmërisë së shqyrtimit të dokumenteve llogariten mbi bazën e datës së pranimit të tyre, nga drejtoria vendore e policisë ose misioni diplomatik apo posti konsullor i Republikës së Shqipërisë i akredituar në shtetin ku ka vendbanimin deri në dekretim (përlllogaritja e afateve të vlefshmërisë së dokumenteve fillon nga data e kryerjes së pagesës nga aplikuesi).

XI. PROCEDURA PËR KRYERJEN E VERIFIKIMEVE PRANË INSTITUCIONEVE PËRGJEGJËSE

1. Pas aplikimit për fitim, rifitim dhe heqje dorë nga shtetësia shqiptare nëpërmjet platformës elektronike *online*, struktura vendore e policisë së shtetit, verifikon saktësinë dhe rregullsinë e dokumentacionit të dorëzuar pranë saj.

2. Nëse dokumentacioni është i plotë dhe i saktë, struktura vendore e policisë së shtetit njofton aplikuesin nëpërmjet adresës elektronike mbi pranimin e aplikimit, si dhe për kryerjen e pagesës së tarifës së shërbimit, brenda 5 (pesë) ditëve pune, të cilën duhet ta dërgojë nëpërmjet shërbimit postar së bashku me ato dokumente origjinale dhe/ose të noterizuara sipas kërkesave të këtij udhëzimi.

3. Në zbatim të këtij udhëzimi, procedurat e pranimit të kërkesave nga strukturat vendore përgjegjëse të Policisë së Shtetit, si dhe dhënien e mendimit nga komisarati i policisë vendore, përcaktohen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

4. Për aplikimet për fitim dhe rifitim të shtetësisë shqiptare, struktura përgjegjëse për shtetësinë në Ministrinë e Brendshme, kur evidenton se dokumentacioni është i plotë dhe konform ligjit, vijon me verifikimin e tyre pranë Shërbimit Informativ të Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

5. Për aplikimet për heqje dorë nga shtetësia shqiptare, struktura përgjegjëse për çështjet e shtetësisë pranë Ministrisë së Brendshme, vijon me verifikimin e tyre, vetëm në rastet kur aplikimet përcillen nga misionet diplomatike apo postet



konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit. Në këto raste, punonjësi përgjegjës, kur evidenton se dokumentacioni është i plotë dhe konform ligjit, harton shkresën për çdo aplikues dhe e përcjell atë pranë drejtorisë vendore të policisë, sektori i rendit dhe i sigurisë publike.

6. Për heqjen e shtetësisë pa kërkesë, në rastet e përcaktuara në nenin 15, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, pas marrjes së informacionit, struktura përgjegjëse për çështjet e shtetësisë pranë Ministrisë së Brendshme, përgatit shkresën së bashku me materialet përkatëse dhe përcjell për verifikime informacionet e marra në organet ligjzbatuese.

XII. PROCEDURA PËR KRYERJEN E BETIMIT

1. Personi që fiton shtetësinë shqiptare, pas botimit të dekretit të Presidentit në Fletoren Zyrtare, brenda gjashtë muajve, kryen betimin për besnikëri ndaj shtetit shqiptar dhe për respektimin e Kushtetutës e të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, para kryetarit të bashkisë, në territorin e së cilës ka vendbanimin ose para punonjësit të autorizuar prej tij.

2. Betimi për fitimin e shtetësisë shqiptare kryhet nga të gjithë personat, të cilëve u është miratuar fitimi i shtetësisë shqiptare, me përjashtim të atyre personave, të cilët janë në kushte të pamundësisë për t’u paraqitur në zyrën e gjendjes civile në bashki/njësinë për arsye të justifikuara shëndetësore.

3. Me marrjen e njoftimit për fitimin e shtetësisë shqiptare nga Institucioni i Presidentit të Republikës, personat që u është miratuar shtetësia shqiptare paraqesin në zyrën e gjendjes civile në bashkinë/njësinë administrative dokumentacionin e nevojshëm, të lëshuar nga vendi i origjinës, siç janë dokumentet: certifikatë personale, certifikatë familjare dhe certifikatë martese, të përkthyer në gjuhën shqipe, me vulën apostile ose të legalizuara.

4. Pas dërgimit të dekretit për fitim të shtetësisë shqiptare, zyrës respektive të gjendjes civile në bashkinë/njësinë administrative, paracaktohet në shpallje të lirë publike, data dhe ora e betimit, e cila i korrespondon çdo dite të hënë.

5. Njoftimi për datën e kryerjes së betimit dërgohet në adresën e personit, të cilit i është dekretuar fitimi i shtetësisë shqiptare.

6. Në rastet e fitimit të shtetësisë, sipas nenit 9, të ligjit nr. 113/2020, betimi mund të kryhet edhe

pranë misionit diplomatik apo postit konsullor të Republikës së Shqipërisë të akredituar në shtetin ku personi ka vendbanimin e fundit.

7. Në përfundim të procedurës së betimit, zyra e gjendjes civile në bashkinë/njësinë administrative kryen procedurat e regjistrimit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të vitit 2010 dhe më pas personi që ka kryer betimin, efektivisht shtetas shqiptar, aplikon për pajisje me dokumentin e identifikimit, letërnjoftim dhe pasaportë.

XIII. PROCEDURA DHE DOKUMENTACIONI PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR KRYERJEN E BETIMIT

1. Në rast të moszbatimit të afatit 6-mujor (gjashtëmujor) për kryerjen e betimit në zyrën e gjendjes civile në bashkinë/njësinë administrative, për shkaqe të justifikuara objektive dhe të arsyeshme, personi, i cili e ka të pamundur të paraqitet për të kryer betimin, duhet të paraqesë kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues në Ministrinë e Brendshme për shtyrjen e afatit për kryerjen e betimit, për aq kohë sa parashikohet se mund të zgjasin shkaqet që kanë diktuar shtyrjen e afatit.

2. Në çdo rast, ky afat duhet t’i korrespondojë një periudhe jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e mbarimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, të nenit 22, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar.

3. Me paraqitjen e këtyre dokumenteve, të cilat shqyrtohen nga struktura për shtetësinë në Ministrinë e Brendshme, lëshohet konfirmimi për pranimin/mospranimin e kërkesës, i cili më pas i përcillet Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila e adreson për ndjekje të mëtejshme në zyrën respektive të gjendjes civile në bashkinë/njësinë administrative, për vijimin e procedurës së betimit për fitimin e shtetësisë shqiptare.

XIV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi struktura përgjegjëse pranë Ministrisë së Brendshme, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe strukturat vendore të Policisë së Shtetit.

2. Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 228, datë 20.11.2024, “Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm për fitimin, heqjen dorë dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare, formën dhe mënyrën e plotësimit të kërkesës, të procedurës për



kryerjen e verifikimeve pranë institucioneve përgjegjëse, si dhe të dokumentacionit për shtyrjen e afatit për kryerjen e betimit”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM

Ervin Hoxha

MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT

E JASHTME

Igli Hasani

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 248, datë 24.2.2025

PËR NGRITJEN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT SEKTORIAL TË ENERGJISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 10 247, datë 4.3.2010, “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, të ndryshuar; të vendimit nr. 426, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit, të funksionimit, si dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të komiteve sektoriale dhe mënyrën e shpërblimit të tyre”, ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional dhe ministri përgjegjës për arsimin

URDHËROJNË:

1. Ngritjen e Komitetit Sektorial të Energjisë.

2. Komiteti Sektorial i Energjisë organizohet në formën e grupit teknik dhe ka në përbërje 10 (dhjetë) anëtarë si më poshtë:

a) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin;

b) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional;

c) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë;

ç) një përfaqësues nga shoqatat e punëdhënësve të sektorit të energjisë, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës;

d) një përfaqësues nga shoqatat e punëmarrësve që mbulojnë sektorin energjisë, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës;

dh) një përfaqësues nga institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional (AFP) të sektorit

të energjisë, me numrin më të madh të nxënësve/kursantëve në sektorin përkatës;

e) një përfaqësues të biznesit me praktika të pasura në zhvillimin e burimeve njerëzore e në sektorin e energjisë;

ë) tre ekspertë të pavarur, me përvojë jo më pak se 5 (pesë) vjet në zhvillimin dhe zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).

3. Kryetari zgjidhet në mbledhjen e parë të komitetit dhe, si rregull, duhet të jetë anëtar me më shumë eksperiencë në çështjet e energjisë dhe në zhvillimin e zbatimin e KSHK-së.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për përzgjedhjen e përfaqësuesve respektivë, sipas germave “a”, “b”, “c” dhe dh”, të pikës 2, të këtij urdhri, në bazë të kriterëve të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 426, datë 26.6.2019, dhe përcjelljen e tyre Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), jo më vonë se 3 (tre) muaj nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

5. Ngarkohet AKAFPK-ja për përzgjedhjen e anëtarëve sipas shkronjave “ç”, “d”, “e” dhe “ë”, të pikës 2, të këtij urdhri, si dhe titullari i saj për ngritjen e sekretariatit teknik, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja e tij në fuqi.

6. Ngarkohen ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, ministria përgjegjëse për arsimin, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe Komiteti Sektorial i Energjisë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS
DHE INOVACIONIT

Blendi Gonxhja

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT

Ogerta Manastirliu



VENDIM
Nr. 13, datë 25.3.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 25.3.2025
mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të
dokumenteve çështjen nr. 18 (D) 2024 të Regjistrit
Themeltar, që u përket:

KËRKUES: DEAR MUÇA

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Drejtorja e Përgjithshme e policisë Së Shtetit,
përfaqësuar nga Ilir Proda, drejtor i përgjithshëm i
Policisë së Shtetit.

Avokatura e Shtetit, përfaqësuar nga avokatet e
shtetit Irma Qosja dhe Valbona Legisi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-
5683, datë 5.12.2023, të Kolegjit Administrativ të
Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën
e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i shkeljes/cenimit të së drejtës për
gjykimin brenda një afati të arsyeshëm dhe
përsheptimitin e procedurave të shqyrtimit të
çështjes me përparësi.

Konstatimi i shkeljes të së drejtës së aksesit dhe
sigurisë juridike në një gjykatë të caktuar me ligj.

Detyrimi i Gjykatës Administrative të Apelit për
shqyrtimin e çështjes me përparësi.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1,
shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 142, pika
1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
(*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të
Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë
10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e
Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,
i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini,
mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit Dear
Muça (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës,
prapësimet e subjekteve të interesuara, Drejtorisë së
Përgjithshme të Policisë së Shtetit (*DPPSH*) dhe
Avokaturës së Shtetit, që kanë kërkuar rrëzimin e
kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Dear Muça ka ushtruar detyrën e
specialistit të marrëdhënieve me publikun dhe
përfaqësimit ligjor në Drejtorinë e Policisë së Qarkut
Dibër. Me urdhrin nr. 91/2, datë 28.1.2003 të
drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit është
larguar nga detyra me motivacionin, “Për shkelje të
rënda në mënyrë të përsëritur të disiplinës në punë”.

I. Procesi parë gjyqësor

2. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit
Gjyqësor Dibër me padi për anulimin e aktit
administrativ nr. 91/2, datë 28.1.2003 të drejtorit të
përgjithshëm të Policisë së Shtetit, rikthimin në
vendimin e mëparshëm të punës dhe pagesën për
kohën e mbetur pa punë padrejtësisht, si dhe
dëmshpërblimin për atë kohë. Me vendimin nr. 22,
datë 20.1.2004, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka
vendosur anulimin e aktit administrativ dhe
detyrimin e palës së paditur, DPPSH-së, për të
dëmshpërblyer kërkuarin me 6 muaj paga, si dhe
rrëzimin e kërimit për kthimin në punë. Vendimi
ka marrë formë të prerë në datën 5.5.2004.

II. Procesi i dytë gjyqësor

3. Kërkuesi ka pretenduar se pas anulimit të aktit
administrativ i ka lindur e drejta për të përfutur dy
paga mujore dhe tre vjet pagesë kalimtare. Për këtë i
është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër
me padi, e cila, me vendimin nr. 26, datë 18.1.2007,
ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në
prova e në ligj. Kjo gjykatë ka arsyetuar se kërkuari
është larguar nga Policia e Shtetit për thyerje
disipline dhe vendimi për të mos përfutur pagesë
kalimtare bazohet në nenin 6 të ligjit nr. 8661, datë
18.9.2000, “Për sigurimin shoqëror suplementar të
punonjësve të Policisë së Shtetit” (*ligji nr.*
8661/2000), ku janë të përcaktuara rastet kur



punonjësi i policisë ndërpret karrierën për disa arsye, mes të cilave për thyerje disiplinore dhe në këtë rast nuk mund të përfitojë pagesë kalimtare.

4. Pas ankimit të kërkesit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 269, datë 7.2.2008, ka vendosur ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe pranimin e padisë, duke detyruar Drejtorinë e Policisë së Qarkut Dibër për të paguar pagesën kalimtare në masën e dy pagave dhe 50 % të pagës bazë nga data 1.2.2003–31.12.2004. Pas rekursit të ushtruar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Dibër dhe kundërekursit të kërkesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2012-1139 (207), datë 26.4.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit me arsyetimin se vendimi i marrë nga ajo gjykatë ishte i drejtë.

III. Procesi i tretë gjyqësor

5. Kërkesi në datën 22.5.2018 i është drejtuar me kërkesë DPPSH-së për njohjen e vjetërsisë në punë për efekt të shërbimit në Policinë e Shtetit, ku përfshihej edhe koha e ndërprerjes së karrierës nga data 1.2.2003 deri në 31.12.2004. Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr. 707/10 prot., datë 20.6.2018, drejtori i Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse në DPPSH ka informuar kërkesin se për përfitimin e pensionit të parakohshëm duhet të plotësohen kushtet e përcaktuara në ligjin nr. 10142/2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 10142/2009), sipas të cilit e drejta për pension të parakohshëm, për meshkujt, përfitohet kur plotësohet vjetërsia në shërbim 15 vjet dhe mosha 47 vjeç.

6. Në datën 6.6.2018 kërkesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me padi për detyrimin e DPPSH-së për të nxjerrë aktin administrativ për njohjen e vjetërsisë në punë (shërbim), ku të përfshihej koha e ndërprerjes së karrierës për shkak të urdhrit të padrejtë të deklaruar me vendim gjykatë, për efekt të shpërblimeve dhe përfitimeve ligjore si punonjës i Policisë së Shtetit.

7. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2945 (80-2018-3008), datë 24.7.2018, ka vendosur rrëzimin e padisë, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Sipas saj, kërkesi nuk

gëzon legjitimitet për t’i kërkuar DPPSH-së që t’i njohë vjetërsinë në punë si punonjës policie, për sa kohë ky kërkim mund t’i drejtohet Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) dhe mund ta përfitojë vetëm me plotësimin e kushteve të tjera për përfitimin e pensionit. Kjo gjykatë ka vijuar në arsyetim se kërkesi nuk e ka mbushur moshën për pension dhe as ka paraqitur kërkesë për të përfituar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi sipas ligjit nr. 10142/2009 (*shih faqet 11-12 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*).

8. Kërkesi në datën 7.8.2018 ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit. Çështja është regjistruar në datën 28.9.2018 dhe vijon të jetë në pritje për t’u gjykuar në atë gjykatë. Sipas informacionit në faqen zyrtare të Gjykatës Administrative të Apelit çështja është me statusin “në përpunim”.

9. Në vijim, pra pas vendimit të gjykatës së shkallës së parë, kërkesi ka paraqitur kërkesë në DRSSH-në, Tiranë për përfitimin e pensionit të parakohshëm. Kërkesa është regjistruar me nr. 3638 regjistrimi, datë 11.11.2019 në njësinë përkatëse të vendbanimit të tij.

10. Kërkesi ka përsëritur kërkesën e tij (*shih paragrafin 5 të vendimit*), duke iu drejtuar DPPSH-së në datën 13.11.2019 dhe Ministrisë së Brendshme në datën 19.10.2021. Për këto kërkesa nuk rezultoi të ketë marrë përgjigje nga institucionet përkatëse.

11. Në kushtet kur çështja ishte ende në proces në Gjykatën Administrative të Apelit, kërkesi në datën 8.11.2023 ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Lartë për shkeljen e afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit, për shkak të kalimit të afatit 1-vjeçar të gjykimit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-5683, datë 5.12.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke arsyetuar se gjyqtari relator i kishte marrë të gjitha masat e nevojshme organizative, duke përcaktuar kritere transparente dhe objektive për marrjen në gjykim të çështjeve, që i ishin ngarkuar atij sipas radhës së vjetërsisë së tyre.

12. Ndërkohë, kërkesi në datën 14.11.2023 i është drejtuar përsëri DPPSH-së me kërkesë me të njëjtin kërkim. Me shkresën nr. 1101-D-1 prot., datë 11.12.2023, DPPSH-ja ka kthyer përgjigje se për të përfituar pensionin e parakohshëm duhet të plotësohen kushtet e moshës dhe vjetërsisë në shërbim të përcaktuara në ligjin nr. 10142/2009.



Kërkuesi e ka kundërshtuar shkresën duke iu drejtuar drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, por nuk rezulton të ketë marrë përgjigje. Në datën 26.3.2024 ka përsëritur kërkimin e tij duke iu ridrejtuar DPPSH-së, e cila, me shkresën nr. 614-2/D, datë 8.5.2024, ka kthyer përgjigje se kërkesa e tij nuk mund të zgjidhet në rrugë administrative, pasi pretendimet e tij janë në proces gjyqësor dhe nuk janë zgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë.

13. Në datën 6.8.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesë për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes së tij të regjistruar në datën 28.9.2018.

14. Në vijim, në datën 21.8.2024 (*data e shërbimit postar*) kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit. Kolegji i Gjykatës në datën 28.10.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

15. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është *cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor* të drejtimit të:

15.1. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, pasi çështja në Gjykatën Administrative të Apelit ka më shumë se 6 vjet që nuk shqyrtohet, kur ajo ka detyrimin që ta shqyrtojë brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit. Procesi është në shkellje të afateve të arsyeshme dhe Gjykata duhet të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese. Thelbi i mosmarrëveshjes që pritet të gjykohet nga Gjykata Administrative e Apelit lidhet me mbrojtjen e së drejtës kushtetuese për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi dhe vonesa në gjykim ka shkaktuar dëm në sigurimin e mjeteve për jetesë. DPPSH-ja nuk i ka njohur kërkuesit të drejtën kushtetuese dhe ligjore të fituar me vendimin nr. 00-2012-1139 (207), datë 26.4.2012 të Gjykatës së Lartë.

15.2. *Së drejtës së aksesit*, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka gjykuar çështjen edhe pas më shumë se 6 vjetësh.

15.3. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm bie ndesh me

jurisprudencën kushtetuese, sipas së cilës procesi i vetëgjyqësorisë dhe mungesa e gjyqtarëve nuk mund të justifikojnë mosshqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm ligjor.

16. **Subjekti i interesuar, DPPSH-ja**, ka prapësuar se pretendimi për shkelljen e afatit të arsyeshëm në Gjykatën Administrative të Apelit është i pabazuar. Për më tepër, pretendimi nuk është ngritur më parë në shkallët më të ulëta të gjyqësorit. Në vlerësim të standardeve të përcaktuara nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), në lidhje me afatin e arsyeshëm, nuk rezulton që çështja objekt gjykimi të jetë pezulluar ose të jetë shtyrë gjykimin për shkak kërkesave apo sjelljes të palëve. Sjellja e Gjykatës Administrative të Apelit ka ardhur si pasojë e volumit të lartë të çështjeve të mbetura pa u gjykuar për një kohë të gjatë në raport me pamjaftueshmërinë e burimeve njerëzore për të përballuar volumin e punës. Një situatë e tillë e vendos organin gjyqësor në kushtet e pamundësisë objektive për procedim. Mosveprimi i gjykatës nuk ka ndodhur për shkak subjektive që lidhen me vlerësimin dhe qëndrimin abuziv të gjyqtarit, por për shkak të pamundësisë objektive dhe pa vullnetin e saj, pra nuk kemi cenim të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm.

17. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, ka prapësuar se:

17.1. *Pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm* nuk është ngritur në nivel kushtetues. Në vlerësimin e kriterëve për përcaktimin e kohëzgjatjes së arsyeshme, mosveprimi i Gjykatës Administrative të Apelit duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave konkrete në të cilat ndodhet sistemi gjyqësor, siç janë zbatimi i reformës në drejtësi dhe ngarkesa individuale e gjyqtarit relator. Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim edhe shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit, për të cilat ka mbajtur qëndrim koherent në raste të së njëjtës natyrë dhe vendimi i saj për rrëzimin e kërkesës është marrë në zbatim të ligjit. Për sjelljen dhe interesin e palëve ndërgjyqëse, nuk konstatohet që të kenë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit. Për sa i përket asaj çfarë rrezikon kërkuesi nga vonesa në gjykatën e apelit, ai nuk ka argumentuar dhe provuar rrezikun për interesat e tij, natyra e rëndësia e të cilave do të justifikonte trajtimin me përparësi të çështjes.



17.2. Pretendimi për konstatimin e shkeljes së të drejtës së aksesit dhe sigurisë juridike nga një gjykatë e caktuar me ligj nuk është parashtruar nga kërkuesi me argumente, por në mënyrë deklarative në pjesën hyrëse të kërkesës, për rrjedhojë nuk duhet të merret në shqyrtim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

18. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

19. Gjykata vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime për gjykimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit tej një afati të arsyeshëm.

20. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata, pas ndryshimeve që iu bënë Kodit të Procedurës Civile (KPC) me ligjin nr. 38/2017, ka mbajtur qëndrimin se legjislacioni i brendshëm parashikon mjete juridike efektive që i ofrojnë individit rezultate

konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese. Në këtë kuptim, individit duhet t’u drejtohet gjykatave të zakonshme në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 60, datë 19.9.2024; nr. 68, datë 7.12.2023; nr. 46, datë 3.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në drejtim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike, Gjykata vëren se subjekti i interesuar, DPPSH-ja, ka parashtruar se kërkuesi pretendimin për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm nuk e ka paraqitur më parë në shkallët më të ulëta të gjyqësorit, duke mos shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

22. Gjykata konstaton se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, sipas parashikimit të nenit 399/6, shkronja “b”, të KPC-së, që parashikon se në rastet kur çështja në të cilën pretendohet të ketë shkelje është duke u gjykuar në gjykatat e apelit, kërkesa shqyrtohet nga kolegji përkatës i Gjykatës së Lartë. Për këtë kërkesë Kolegji Administrativ, me vendimin nr. 00-2023-5683, datë 5.12.2023, ka vendosur rrëzimin e saj. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se i vetmi mjet në dispozicion i kërkuesit për rivendosjen në vend të së drejtës të cenuar është ankimi kushtetues individual, pra kërkuesi i ka shteruar mjetet juridike efektive dhe pretendimi i DPPSH-së në këtë drejtim është i pabazuar.

23. Për legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 5.12.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 21.8.2024. Referuar dokumentacionit të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të shqyrtimit të çështjes, rezulton se vendimi i kundërshtuar i është komunikuar individualisht avokatit të kërkuesit, R.I., në datën 2.7.2024. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, pasi jo vetëm shkelja është vazhduese, por nisur nga data 2.7.2024 ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.



24. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuksi ka parashtruar argumente për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të mosgjykimit të çështjes brenda afatit ligjor në Gjykatën Administrative të Apelit, shkelje që ka sjellë edhe cenimin e së drejtës së aksesit dhe të parimit të sigurisë juridike. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se në thelb argumentet e kërkuksit janë të parashtruara në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, pretendim i cili, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin kushtetues dhe në vijim Gjykata do të analizojë bazueshmërinë e tij.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

25. Kërkuksi ka pretenduar se procesi gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit ka mbi 6 vjet që vijon dhe vonesa ka shkaktuar dëm në të drejtën personale dhe mjetet për jetesë, sikurse është pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi në Policinë e Shtetit.

26. Subjekti i interesuar, DPPSH-ja, ka prapësuar se në vlerësim të standardeve të përcaktuara nga jurisprudenca e GJEDNJ-së nuk rezulton që çështja objekt gjykimi të jetë pezulluar ose të jetë shtyrë gjykimi për shkak kërkesave apo sjelljes të palëve. Mosveprimi i gjykatës administrative ka ardhur si pasojë e volumit të punës në raport me pamjaftueshmërinë e burimeve njerëzore për ta përballuar atë.

27. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se vendimi i Gjykatës së Lartë për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm është marrë duke respektuar kufijtë e objektit të saj dhe dispozitat që e rregullojnë këtë kërkim. Duke vlerësuar të gjitha elementet, si periudha që merret në konsideratë, sjellja e palëve ndërgjyqëse dhe ajo çka rrezikon kërkuksi, pretendimi nuk është i bazuar.

28. Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përfshihen vonesat e

shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja “a”, të KPC-së, afat i arsyeshëm në gjykimin administrativ në shkallë të parë dhe në apel do të konsiderohet përfundimi i gjykimit brenda një viti nga fillimi i tij në secilën shkallë. Në rastin në shqyrtim, gjykimi i çështjes konkrete në Gjykatën Administrative të Apelit është tejzgatur, ndaj për të vlerësuar arsyeshmërinë e kësaj kohëzgjatjeje dhe për të arritur në përfundimin nëse kërkuksit i është cenuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt në këtë aspekt, duhen analizuar rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: i. sjelljen e kërkuksit; ii. kompleksitetin e çështjes; iii. sjelljen e autoriteteve; iv. rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuksi (*shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Për sjelljen e kërkuksit, sipas jurisprudencës kushtetuese vlerësimi i sjelljes së kërkuksit është një element përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve, duke u analizuar rrethanat nëse ai ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të, dhe nëse është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në rastin konkret kërkuksi, pas mosveprimit të DPPSH-së për të shqyrtuar kërkesën e tij për njohjen e kohës së ndërprerjes së karrierës si vjetërsi në punë për efekt të shërbimit në Policinë e Shtetit, në datën 6.6.2018 i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duke nisur një proces gjyqësor ndaj DPPSH-së.

32. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2945 (80-2018-3008), datë 24.7.2018, ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova. Kërkuksi në datën 7.8.2018 ka kundërshtuar vendimin në Gjykatën Administrative të Apelit. Çështja është regjistruar në atë gjykatë në datën 28.9.2018 dhe vijon të jetë në proces.

33. Nga parashtrimet shtesë të depozituara nga kërkuksi në Gjykatë, rezulton se ai ka paraqitur



kërkesë në DRSSH-në, Tiranë për përfitimin e pensionit të parakohshëm, që është regjistruar me nr. 3638 në datën 11.11.2019 në njësinë përkatëse të vendbanimit të tij. Në datën 13.11.2019 ai i është drejtuar DPPSH-së, si dhe në datën 19.10.2021 Ministrisë së Brendshme, por nuk rezulton të ketë marrë përgjigje për kërkesën e tij.

34. Në kushtet kur çështja në Gjykatën Administrative të Apelit ishte ende në proces, në datën 8.11.2023 kërkuesi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Lartë për shkeljen e afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-5683, datë 5.12.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke arsyetuar se gjyqtari relator i kishte marrë të gjitha masat e nevojshme organizative duke përcaktuar kriteret transparente dhe objektive për marrjen në gjykim të çështjeve sipas radhës së vjetërsisë së tyre (*shih faqen 5 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

35. Ndërkohë, kërkuesi në datën 14.11.2023 i është drejtuar përsëri DPPSH-së, e cila me shkresën nr. 1101-D-1 prot., datë 11.12.2023 ka kthyer përgjigje se për të përfituar pensionin e parakohshëm duhet të plotësohen kushtet e përcaktuara në ligjin nr. 10142/2009 lidhur me moshën dhe vjetërsinë në shërbim. Kërkuesi e ka kundërshtuar përgjigjen duke iu drejtuar drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, por nuk rezulton të ketë marrë përgjigje.

36. Në datën 26.3.2024 ka përsëritur kërkimin e tij duke iu drejtuar DPPSH-së, e cila me shkresën nr. 614-2/D, datë 8.5.2024 ka kthyer përgjigje se kërkesa e tij nuk mund të zgjidhet në rrugë administrative, pasi çështja është në proces gjyqësor dhe nuk është zgjidhur me vendim të formës së prerë. Në vijim, në datën 6.8.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesë për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes.

37. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkuesi i ka përdorur të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të tij dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes gjyqësore.

38. *Për kompleksitetin e çështjes*, Gjykata ka theksuar se në vlerësimin e kompleksitetit të çështjes marrin rëndësi të gjitha aspektet e saj, përfshirë objektin, faktet e kundërshtuara, volumin dhe natyrën e provave, llojin dhe ndërthurjen e ligjeve të zbatueshme, si dhe numrin e palëve pjesëmarrëse në

proces. Kohëzgjatja e konsiderueshme e gjykimit mund të justifikohet nga kompleksiteti i çështjes, pasi balancohet nga parimi i administrimit të përshtatshëm të drejtësisë (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se kompleksiteti i çështjes nuk mbartet në të njëjtën mënyrë në çdo shkallë të gjykimit, por varet nga faza në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj dhe shkalla e gjykimit në të cilën kërkohet konstatimi i kohëzgjatjes së paarsyeshme (*shih vendimet nr. 80, datë 21.11.2024; nr. 58, datë 17.9.2024; nr. 46, datë 3.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Gjykata vëren se çështja ka natyrë administrative, me objekt detyrimin e DPPSH-së për të nxjerrë aktin administrativ, për njohjen e vjetërsisë në shërbim në Policinë e Shtetit, për të cilën, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vlerësuar se kërkuesi nuk legjitimohet në kërkimin e tij pa provuar periudhat e shërbimit të njohura nga institucioni përgjegjës, si dhe pa pasur një vendimmarrje nga DRSSH-ja për kërkimin e tij për të përfituar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se kërkuesi nuk e ka mbushur moshën për pension dhe as ka paraqitur kërkesë për të përfituar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi sipas ligjit nr. 10142/2009 dhe në përfundim ka vendosur rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj e në prova (*shih paragrafin 7 të vendimit*). Gjykimi në shkallë të parë ka përfunduar brenda një afati 1 muaj e gjysmë, pasi çështja është regjistruar në datën 5.6.2018 dhe vendimi është i datës 24.7.2018, duke pasur vetëm një palë të paditur, DPPSH-në. Duke iu referuar rrethanave, Gjykata vlerëson se çështja e kërkuesit nuk paraqitet komplekse, e tillë që të justifikojë kohëzgjatjen prej më shumë se 6 vjetësh në Gjykatën Administrative të Apelit.

40. *Për sjelljen e autoriteteve*, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në përmbushje të këtyre detyrimeve, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme (*shih vendimet nr. 9, datë 4.3.2025; nr.*



25, datë 11.5.2023; nr. 6, datë 16.2.2023, të Gjykatës Kushtetuese).

41. Për këtë kriter, Gjykata konstaton se çështja e kërkuarit është në pritje për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit prej më shumë se 6 vjetësh, ndonëse ligjvënësi ka parashikuar afate procedurale konkrete në KPC dhe në ligjin nr. 49/2012. Çështja i është caktuar me short gjashtë gjyqtarëve, konkretisht në datat 28.8.2019, 25.6.2020, 31.3.2021, 25.11.2021, 28.7.2022 dhe së fundmi në 19.9.2023. Pavarësisht kësaj, përveç organizimit të shorteve dhe kalimit të çështjes nga njëri gjyqtar relator tek tjetri, nuk rezulton të jenë kryer veprime të tjera me çështjen. Ndërkohë, Gjykata e Lartë ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e shkeljes dhe përsheptimin e procedurave, duke arsyetuar se mosveprimi i gjykatës së apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit, por për shkak të ngarkesës së lartë dhe nuk mund t'i kërkohej gjykatës që të marrë masa për përsheptim të procedurave, kur konstatohet se ajo ndjek kriteret transparente dhe objektive në përcaktimin e radhës së gjykimit të çështjeve. Përbën një fakt të njohur botërisht se reforma në drejtësi ka shkarkuar/pezulluar një numër të konsiderueshëm gjyqtarësh në Republikën e Shqipërisë (*shih faqet 3–4 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

42. Duke analizuar gjendjen e Gjykatës Administrative të Apelit, Gjykata konstaton se çështja konkrete është regjistruar në atë gjykatë në datën 28.9.2018, në një kohë kur reforma në drejtësi kishte filluar të zbatohej. Aktualisht, ajo gjykatë është me organikë të plotësuar, 13 gjyqtarë dhe po vijon me gjykimet aty ku ishin ndaluar në vitin 2017. Gjyqtarja relatore, së cilës i është caktuar së fundmi çështja e kërkuarit, ka për shqyrtim 2639 çështje gjyqësore, ndërkohë që nuk rezulton që ndonjë nga relatorët të ketë kryer veprime me dosjen.

43. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se vonesa në gjykimin e çështjes së kërkuarit është pasojë e ngarkesës së lartë të gjyqtarës relatore dhe në tërësi të Gjykatës Administrative të Apelit si pasojë edhe e zbatimit të reformës në drejtësi. Në këtë drejtim, Gjykata thekson në mënyrë të përsëritur se pavarësisht rëndësisë dhe përfitimeve që sjellin reformat në sektorin e drejtësisë, ligjvënësi ka për detyrë të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike, me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të

funksionojnë normalisht (*shih vendimet nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykimi përtej afatit të arsyeshëm nuk mund të përligjë cenimin e të drejtave kushtetuese të individëve, në kushtet kur mbingarkesa në gjykata tashmë është një situatë e njohur dhe e zgjatur në kohë, e cila nuk varet nga individët (*shih vendimin nr. 57, datë 17.9.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto rrethana, Gjykata çmon se vonesa prej më shumë se 6 vjetësh në Gjykatën Administrative të Apelit është në shkelje të afatit të arsyeshëm ligjor edhe si pasojë e sjelljes së gjykatës.

44. Për rëndësinë e asaj çfarë rrezikohet, Gjykata vëren se kërkuari ka parashtruar se çështja që është në pritje për t'u shqyrtuar në Gjykatën Administrative të Apelit lidhet me pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi, i cili është një përfitim që jepet duke mbajtur në konsideratë natyrën e punës të ushtarakëve ose punonjësve të Policisë së Shtetit, të cilët pas ndërprerjes së karrierës, me ose pa dëshirën e tyre, e kanë të vështirë të gjejnë një vend pune të një niveli të krahasueshëm me funksionet që ushtronin. Referuar rrethanave të çështjes, Gjykata vlerëson se pavarësisht faktit se në objektin e padisë së ngritur nga kërkuari nuk është shprehur drejtpërdrejt ky kërkim, veprimet që ai ka kryer duke iu drejtuar disa herë me kërkesë DPPSH-së për nxjerrjen e aktit administrativ për të përfshirë në vitet e vjetërsisë në shërbimin në Policinë e Shtetit periudhën e largimit nga detyra, si dhe përgjigja nga DPPSH-ja se kërkesa e tij nuk mund të pranohet, pasi çështja është në proces gjyqësor, në thelb lidhen me të drejtën për pension të parakohshëm.

45. Gjykata ka pohuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përsheptim të posaçëm të gjykimit. Në këto raste duhet të merret parasysh rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuari në procesin gjyqësor, pra rëndësia që ka për të e drejta objekt gjykimi. Kjo do të thotë se disa çështje që lidhen me interesa “*vetjakë e jetësorë*”, duhet të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe verifikimi i kriterit të interesit të kërkuarit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me të drejtën për pension, Gjykata ka pohuar se e drejta për pension është një e mjet i domosdoshëm për jetesën, në të njëjtën linjë sikurse edhe GJEDNJ-ja, e cila ka parashikuar listën e çështjeve të cilat kërkojnë “*kujdes të veçantë*” ose



“kujdes të jashtëzakonshëm”, të tilla, si ato që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin etj. (*shih vendimin nr. 60, datë 19.9.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe vetë Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) në vendimin nr. 78, datë 30.5.2019 i ka vlerësuar çështjet e përfitimit të pensionit me natyrë specifike, të cilat duhet të shqyrtohen shpejt për të shmangur pasojat e rënda për palët në proces dhe për dhënien e drejtësisë (*shih kreun II, pika 3, nënpika 3.1., shkronja “g”, të vendimit nr. 78, datë 30.5.2019 të KLGJ-së, “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”*).

46. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkimi kryesor në ankimin kushtetues individual lidhet me cenimin e së drejtës për pension të parakohshëm dhe që pavarësisht faktit se nuk është pension pleqërie, në thelb janë të ngjashëm, sepse janë përfitime vetjake dhe mjete jetese. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë kohën prej më shumë se 6 vjetësh për shqyrtimin e çështjes në raport me ngarkesën me të cilën përballet sistemi i drejtësisë, vlerëson se kjo çështje rezulton të jetë e tillë që për shkak të natyrës së saj ka përparësi në radhën e shqyrtimit. Për më tepër në kushtet kur kërkuesi i është drejtuar disa herë subjektit të interesuar, DPPSH-së, për të kryer veprimet përkatëse.

47. Për sa më lart, duke vlerësuar së bashku përfundimet e analizës të secilit prej kriterëve kushtetuese, në rrethanat e rastit konkret, tejzgjatja e procedurave gjyqësore prej më shumë se 6 vjetësh për shqyrtimin e një çështjeje të tillë me kompleksitet të ulët paraqet një shkallë të konsiderueshme rreziku për interesin e kërkuesit, si dhe për rëndësinë e së drejtës për pension të parakohshëm, ndaj Gjykata konstaton se kërkuesit i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në aspektin e kohëzgjatjes së paarsyeshme të gjykimit dhe vlerëson se kërkesa duhet të pranohet, si dhe vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit të çështjes së kërkuesit në Gjykatën Administrative të Apelit duhet të shfuqizohet.

48. Po kështu, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, duke mbajtur në konsideratë ngarkesën e punës dhe volumin e çështjeve të

ngjashme, Gjykata në rastin konkret çmon se duhet të urdhërohet shqyrtimi i çështjes së kërkuesit nga Gjykata Administrative e Apelit brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-5683, datë 5.12.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
 3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm.
 4. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit për të gjykuar çështjen e kërkuesit brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi¹⁶⁷.
- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 25.3.2025.

Shpallur më 18.4.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Genti Ibrahim

¹⁶⁷ Gjyqtari Ilir Toska votoi për shqyrtimin e çështjes me përparësi nga Gjykata Administrative e Apelit.



UDHËZIM

Nr. 553, datë 14.4.2025

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË
MONITORIMIT DHE MBIKËQYRJES SË
SJELLJES SË PUNONJËSVE TË
AGJENCISË SHTETËRORE TË
KADASTRËS GJATË PERIUDHËS
ZGJEDHORE NË ZGJEDHJET E
PËRGJITHSHME PËR VITIN 2025**

Në zbatim të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”; nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”; ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”; ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të KQZ-së, “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”; vendimit nr. 122, datë 26.2.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme për vitin 2025”,

UDHËZOJ

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i miratimit të këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave të monitorimit dhe të mbikëqyrjes së sjelljes së punonjësve të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës gjatë periudhës zgjedhore në zgjedhjet e Përgjithshme për vitin 2025 dhe konkretisht:

a) marrja e masave dhe monitorimi i veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2025, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe burimeve publike për qëllime partiake;

b) vendosjen e kontrollit mbi sjelljen e punonjësve në përputhje me ligjin, në këtë situatë specifike në kushtet e zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë;

c) sigurimi i parimit të paanësisë politike, mbi të cilin bazohet administrimi i administratës publike;

d) sigurimi i zbatimit të ligjit, në drejtim të respektimit të të drejtave politike të nëpunësit, e njëkohësisht edhe të kufizimeve të vendosura në dispozitën që përfaqësohet nga neni 37 i ligjit në fjalë, ku ndër të tjera, ndalohet pjesëmarrja e tij në veprimtari politike gjatë orarit zyrtar, si dhe shprehja publikisht e bindjeve apo preferencave politike; si dhe

e) sigurimi i vijueshmërisë normale dhe të pandikuar nga fushata zgjedhore, të veprimtarisë të punonjësve, në shërbim të shtetit dhe qytetarëve, në këtë institucion.

2. Monitorimi dhe mbikëqyrja e sjelljes së punonjësve të ASHK-së gjatë fushatës elektorale, që ka të bëjë me realizimin e detyrave të tyre funksionale në shërbim të shtetit dhe qytetarëve, si dhe me zbatimin e disiplinës formale në punë do të kryhet nga Grupi i Monitorimit.

3. Grupi i Monitorimit do të veprojë në bashkëpunim të ngushtë me drejtorët e drejtorive vendore të ASHK-së, si dhe me njësinë e administrimit të burimeve njerëzore të Drejtorive vendore të ASHK-së, me qëllim që të respektojë diskrecionin ligjor të këtyre subjekteve, në rastet e përcaktuara shprehimisht në ligj.

**II. RREGULLAT E DETYRUESHME PËR
TË ZBATUAR NGA PUNONJËSIT E ASHK-
SË GJATË PERIUDHËS ZGJEDHORE NË
ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME PËR VITIN
2025**

1. Në një regjistër të posaçëm, i cili do të administrohet nga Grupi i Monitorimit, punonjësit duhet të shënojnë çdo ditë hyrje-daljet në institucion, destinacionin, si dhe eprorin që e ka miratuar lejen për të lëvizur nga vendi i punës, duke filluar nga ora 08.00–16.30 nga e hëna në të enjte dhe 08.00–14.00 ditën e premte.

2. Eprorët direkt, duhet të jenë në çdo rast në dijeni të lëvizjes së stafit të tyre, në të kundërt, mospasja dijeni për mungesa të stafit, do të konsiderohet si mospërmbyllje e detyrave funksionale nga ana e tyre.

3. Gjatë orarit zyrtar, punonjësit, brenda mjediseve të institucioneve shtetërore, i ndalohet



çdo lloj pjesëmarrjeje në veprimtari politike apo fushatë zgjedhore të një partie politike ose kandidati në zgjedhje.

4. Punonjësi nuk duhet të bëhet pjesë e diskutimeve politike, brenda ambienteve të institucionit, me kolegët apo qytetarët/të mos përdorë apo të mbajë postera, fletëpalosje dhe objekte me simbole të subjekteve politike në ambientet e institucionit/të mos lejojë përdorimin apo mbajtjen e posterave, fletëpalosjeve dhe të simboleve të subjekteve politike, nga qytetarët që kryejnë shërbime në ambientet e institucionit. Punonjësi të informojë Grupin e Monitorimit, në rastet kur konstaton shkelje të kësaj rregulloreje.

5. Personat e ngarkuar do të organizojnë kontrole në frekuenca të shpeshta gjatë orarit zyrtar, të cilat në rast konstatimit të shkeljes së këtij udhëzimi, do të materializohen në procesverbale, të cilat më pas do të administrohen si pjesë e veprimtarisë së këtij grupi.

6. Të gjitha rastet e konstatuara me shkelje, Grupi i Monitorimit do t'i dërgojë për fillimin e ecurisë disiplinore, pranë titullarit të institucionit.

7. Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë periudhës së procesit zgjedhor, i krijohen kushtet e nevojshme dhe i garantohet moscenimi i të drejtave dhe i lirive themelore, kushtetuese, për të shprehur fjalën e lirë dhe për të marrë pjesë në veprimtari politike, brenda kufizimeve dhe ndalimeve, të përcaktuara me dispozita të veçanta të legjislacionit në fuqi, që rregullojnë dhe janë të vlefshme gjatë këtij procesi zgjedhor.

8. Punonjësi i administratës shtetërore, pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore, ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo zgjedhore të një partie politike ose kandidati në zgjedhje, por pa shprehur publikisht bindjet apo preferencat e tij politike.

9. Punonjësi i administratës shtetërore ka të drejtë të angazhohet si komisioner zgjedhor, në përbërje të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve, pasi të ketë njoftuar paraprakisht me shkrim eprorin direkt dhe njësinë e personelit për këtë veprimtari dhe të ketë marrë lejen me shkrim nga eprori direkt. Angazhimi si komisioner nuk duhet të ndikojë në

përmbushjen e detyrave funksionale si pjesë e administratës publike.

10. Punonjësit të administratës shtetërore i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare a njerëzore, me qëllim favorizimin e një partie politike ose kandidati në zgjedhje.

11. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, automjetet, si dhe karburanti në përdorim të institucionit të administratës shtetërore, ndalohen të përdoren për veprimtari të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore, të regjistruara në zgjedhje.

12. Veprimi në kundërshtim me këtë udhëzim përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor ndaj nëpunësit të administratës shtetërore.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Udhëzimi hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare dhe është i vlefshëm për periudhën zgjedhore në zgjedhjet e përgjithshme për vitin 2025.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Grupi i Monitorimit, të gjithë punonjësit e drejtorive vendore të ASHK-së, si dhe strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Lorena Goxhobelli

VENDIM (i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, me vendimin nr. 82, datë 12.2.2025, vendosi shpalljen të zhdukur më datën 30.3.2018 të shtetasit Ksandros Imeraj, me atësi Leonard dhe me amësi Dhurata, i datëlindjes 9.8.1985, lindur dhe banues në Vlorë, si dhe caktimin e shtetasës Dhurata Imeraj si kujdestare të përkohshme për administrimin e pasurisë së tij.

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 320 lekë